Burimet: Libri i nxënësve, interneti, dokumentarë, filma historikë.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Me temat e mëparshme: Tematika “Qytetërimet botërore	

në Mesjetë” • Me letërsinë: Botime që trajtojnë periudhën në fjalë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
Metodologjia: Punë kërkimore në grupe/udhëtim imagjinar/lojë në role Organizimi i orës së mësim: • Mësuesi/ja ka informuar më parë nxënësit rreth zhvillimit të kësaj veprimtarie praktike duke i dhënë si detyrë të informohen nga burime të ndryshme si: Teksti, interneti, filma artistikë për periudhën e mesjetës. • Nxënësit hulumtojnë mbi: organizimin shoqëror dhe ekonomik në feudalizëm, rolin e kishës në mesjetë, ndërtimin e qyteteve mesjetare, organizimin e jetës në mesjetë. (klasa ndahet në katër grupe për realizimin e detyrave të mësipërme) Ndërtimi i njohurive: • <i>Hapi i parë:</i> Ora e mësimi fillon me një prezantim të secilit prej grupeve. • <i>Hapi i dytë:</i> Shkëmbim idesh. -Mësuesi /ja nxit shkëmbimin e ideve të nxënësve nëpërmjet pyetjeve: - Renditni gjërat që do t’ju pëlqenin ose jo nga jeta në periudhën mesjetare. -Çfarë lloj punësh bënin njerëzit në mesjetë? -A kishte para në mesjetë? Si i blinin njerëzit mallrat? -Cilat ishin mjetet e udhëtimit në mesjetë? -Çfarë lloj ndërtimesh kishte në mesjetë? -Si komunikonin njerëzit me njëri-tjetrin në mesjetë? -Çfarë ushqimi konsumonin njerëzit në mesjetë? -A ishin të arsimuar njerëzit në mesjetë dhe në ç’ nivel? Po kultura? -Si e kalonin kohën e lirë? /A kishte kujdes për higjienën dhe shëndetin në mesjetë? -Cili ishte roli i kishës në mesjetë? • <i>Hapi i tretë:</i> Lojë në role (udhëtim imagjinar) -Në bazë të fakteve të diskutuara në hapat e mëparshëm të orës së mësimi mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të organizojnë në formën e një	

loje në role historinë e një dite nga jeta e një bashkëmoshatare të tyre gjatë periudhës mesjetare. -Me qëllim që nxënësit të evidentojnë dallimin midis shtresave të popullsisë në mesjetë krijohen dy grupe për të realizuar lojën në role. Grupi i parë: Jeta e një bashkëmoshatare nga familje feudale e pasur, Grupi i dytë: Jeta e një bashkëmoshatare nga familje e varfër fshatare. -Mund të krijojnë personazhe si: bashkëmoshatare/ja, familjarët, prifti i dioqezës, familjar i sëmurë, mjeku etj Pyetje për diskutim Situata quhet e realizuar nëse nxënësit: 1) Përkrahjnë zhvillimin e jetës në qytetet mesjetare. 2) Analizon tiparet ekonomike, shoqërore dhe fetare të jetës në mesjetë. 3) Krahason shtresa të ndryshme të shoqërisë mesjetare.	
Vlerësimi: <i>Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënësit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</i>	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shkenca shoqërore	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Përsëritje. - Tematikat 1: Qytetërimi antik grek dhe romak - Tematikat 2: Qytetërimet botërore në mesjetë.		Situata e të nxënësit: -Veçori të qytetërimeve antike greko-romake. -Krijimi i monarkive në Evropën mesjetare. -Veçori të organizimit politik, shoqëror dhe ekonomik në mesjetë.	
Rezultatet e të nxënësit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit		Fjalët kyçe: <i>Qytetërim,</i>	

• Përdor funksionet gjuhësore, fjali të ndërtuara saktë për përshkrimin e ngjarjeve, fjali komplekse për shpjegimin e marrëdhënieve shkak-pasojë. Kompetenca e të nxënës • Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore. Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temave mësimore -Demonstrojnë njohuri, aftësi/shkathitësi, mbi kushtet, etapet dhe tiparet ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore të qytetërimeve antike në Greqi dhe Romë si dhe të qytetërimeve mesjetare. -Analizojnë e krahasojnë zhvillimet e qytetërimeve antike në Greqi dhe Romë duke evidentuar lidhjen midis këtyre qytetërimeve. -Shpjegojnë kalimin nga qytetërimet antike në qytetërimet mesjetare, tregojnë ndryshimet që pësuan këto qytetërimet në mesjetë. Burimet: • Libri i nxënës, interneti, libri i mësuesit, harta, biblioteke e shkollës.	<i>oligarki,</i> <i>demokraci</i> <i>koloni greke,</i> <i>krishterim,</i> <i>kulturë helenistike,</i> <i>mesjetë,,</i> <i>feudalizëm,</i> <i>islam,</i> <i>Karta e Madhe e Lirive,</i> <i>sistem feudal-ushtarak,</i> <i>perandori shumëkombëshe</i>
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: • Me temat e mëparshme:tematika 1-2. • me letërsinë:vepra të antikitetit greko-romak. • me gjeografinë:shtrirja territoriale e shteteve	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: • Me temat e mëparshme:tematika 1-2. • me letërsinë:vepra të antikitetit greko-romak. • me gjeografinë:shtrirja territoriale e shteteve
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Metodologjia: Hap pas hapi/ stuhi mendimi Organizimi i orës së mësim: Mësuesi/ja ndërthur disa teknika mësimore në hapat e ndryshëm gjatë të cilave do të kalojë ora e përsëritjes. Është e rëndësishme që të formulohen pyetje te niveleve të ndryshme me qëllim që të aktivizohen dhe te marrin pjesë në diskutim të gjithë nxënësit. Ndërtimi i njohurive • <i>Hapi i parë: Puna me tekstin</i> Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të punojnë në fletën e përsëritjes në tekst pyetjet 1, 6, 12. Dhe më pas një nga nxënësit lexon përgjigjet e sakta.	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Metodologjia: Hap pas hapi/ stuhi mendimi Organizimi i orës së mësim: Mësuesi/ja ndërthur disa teknika mësimore në hapat e ndryshëm gjatë të cilave do të kalojë ora e përsëritjes. Është e rëndësishme që të formulohen pyetje te niveleve të ndryshme me qëllim që të aktivizohen dhe te marrin pjesë në diskutim të gjithë nxënësit. Ndërtimi i njohurive • <i>Hapi i parë: Puna me tekstin</i> Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të punojnë në fletën e përsëritjes në tekst pyetjet 1, 6, 12. Dhe më pas një nga nxënësit lexon përgjigjet e sakta.

• <i>Hapi i dytë: Identifiko dhe shpjego termat shprehjet dhe figurat historike.</i> P.sh:Identifiko: qytetërim, polis, oligarki, demokraci, republikë, perandori, patricë, plebenj, koloni greke, krishterim, krizë, dyndje e popujve, kulturë helenistike, mesjetë, orthodoxizëm, feudalizëm, islam, Kalifat, Kuran, vasalet, anglo-sankson, Karta e Madhe e Lirive, sistem feudal-ushtarake, perandori shumëkombëshe, Ugo Kapeto, Zhanë D’Ark, Xhoni pa Tokë, Ibn Sina, Meka, korporata, triumvirat, Oktaviani, Jul Cezari, Luftërat Punike, Soloni, Perikliu etj. • <i>Hapi i tretë: Të menduarit logjik</i> Mësuesi/ja drejton pyetje me qëllim që të nxisë të menduarit logjik te nxënësit. P.sh. 1-Arsyetoni mbi ndryshimin ndërmjet monarkisë dhe republikës në Romën e lashtë. 2-Identifikoni periudhën kur Perandoria Bizantine arriti kulmin e shkëlqimit të saj. Renditni shkaqet parësore të këtij shkëlqimi. 3- Analizoni faktorët vendimtarë të rënies së Perandorisë Bizantine. 4-Tregoni cilat qenë disa nga trashëgimitë greko-romake të ruajtura nga Bizanti. Shpjegoni shkaqet e organizimit të fushatave fetaro-ushtarake të quajtura kryqëzata. 5-Identifikoni shtetet e sotme që janë formuar nga ata që dje quheshin frankët perëndimorë dhe frankët lindorë. 6-Evidentoni fazat e pushimit të Ballkanit prej osmanëve dhe drejtimet kryesore të tyre. Identifikoni cili ishte burimi i konfliktit midis baronëve dhe mbretit në Angli. Si u pasqyrua zgjidhja e këtij konflikti në përmbajtjen e Kartës së Madhe të Lirive? 7-Analizoni faktorët që ndihmuan Kapetingët në rrugën e tyre drejt përqendrimit të pushtetit. 8-Argumentoni cili ishte roli i fesë së re islame në krijimin e një uniteti fetar dhe politik, në Gadishullin Arabik. Ilustroni me shembuj konkretë këtë ndikim . • <i>Hapi i katërt: Punë individuale</i> -Mësuesi/ja ndërton në tabelë diagramin e Venit dhe shkruan kërkesën e mëposhtme, pasi nxënësit punojnë në fletore dy nxënës plotësojnë edhe në tabelë diagramin. -Krahasoni elementet e përbashkëta dhe të ndryshme të Perandorisë Romake të Perëndimit me atë të Lindjes (diagramë Veni)		
Perandoria Romake	Të përbashkëta	Perandoria Bizantine
1-Gjuha zyrtare latinishtja. 2-Besimi i krishterë katolik.	❖ Perandoria Bizantine e nisi jetën si vazhdim i perandorisë Romake:	1-Gjuha zyrtare krahas latinishtes u përdor edhe greqishtja.

3-Kreu i kishës katolike Papa gëzonte dhe pushtet politik 4-Organizimi ekonomik në rendin skllavopronar në fazat e shthurjes së tij. 5-Ndaria administrative në provincë. 7- U ruajtën formalisht institucione si senati, komiciet, magjistratat. 8-Jetoi edhe më pak se një shekull deri në vitin 476. 9-Kultura latine.	-në formën e qeverisjes, ligje, -në ndarjen dhe administrimin e territoreve, -në gjuhën e përdorur që ishte latinishtja, -në besim fetar që ishte krishterimi, -në territore ku perandoria Bizantine shtrihej - në territore të Perandorisë Romake ❖ Në vazhdim ndodhën ndryshime të tilla që këto dy perandori nuk do të kishin asgjë të përbashkët.	2-Besimi i krishterë orthodoks. 3-Kreu i kishës orthodokse Patriarku kishte vetëm pushtet fetar. 4-Perandori ishte pronar suprem i tokës dhe shteti kontrollonte veprimtarinë tregtare dhe zejtare(korporatat) 5-Ndaria administrative në prefektura. 6-Krahas senatit vepronte dhe këshilli i shtetit në krye të administratës. 8-Jetoi deri në vitin 1453. 9-Kultura greko-latine.
• <i>Hapi i pestë: Diskutim</i> -Mësuesi/ja nxit diskutimin dhe aktivizon nxënësit të marrin pjesë në të nëpërmjet pyetjeve? -Platoni ka thënë se kolonitë greke dukeshin “si bretkosat rreth pellgut”. Shpjegoni thënieën e filozofit. -Gjykoni rreth votimit me ostrakizëm dhe jepni mendimin tuaj nëse mund të zbatohet sot. -Si mendoni, pse grekët e lashtë mbajnë “kurorën e lavdisë” për zhvillimin e kulturës? Pyetje për diskutim Situata quhet e realizuar nëse nxënësit: -Zotërojnë dhe demonstrojnë njohuri, qëndrime dhe vlera mbi kushtet, etapat dhe tiparet ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore të qytetërimeve antike në Greqi dhe Romë si dhe të shoqërisë dhe qytetërimeve mesjetare. -Analizojnë zhvillimet e qytetërimeve antike në Greqi dhe Romë duke evidentuar lidhjen midis këtyre qytetërimeve. -Shpjegojnë ndryshimet në fusha të ndryshme që kanë ndodhur në qytetërimet mesjetare.		
Vlerësimi: • <i>Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënëtit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</i>		

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shkenca shoqërore	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Humanizmi dhe Rilindja		Situata e të nxënësve: a) Zhvillimi i letërsisë dhe artit në qytet – shtetet italiane. b) Kuptimi i Rilindjes dhe Humanizmit, roli i kishës në to. c) Fundi i Rilindjes	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e të menduarit - Zhvillon të menduarit për realizimin e kërimit historik. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin - Harton hapat që duhet të ndjekë për realizimin e një kërkit historik për një ngjarje të dhënë Kompetenca personale - Kupton nëpërmjet kërimit historik përvojën e njeriut, ndryshimet që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave.		Fjalët kyçe: <i>humanizëm</i> <i>rilindje</i> <i>qytet – shtetet italiane</i> <i>kultura klerikale</i>	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - argumenton arsyet e shndërrimit të qyteteve italiane në djepin e qytetërimit modern evropian; - vlerëson rolin e qyteteve italiane në lindjen e humanizmit dhe rilindjes evropiane; - evidenton rolin e kishës dhe familjeve të mëdha italiane në organizimin e lëvizjes kulturore në Itali; - vlerëson rolin e lëvizjes kulturore italiane në Evropë.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - Me temat e mëparshme: Besimi dhe kultura në Romën dhe Greqinë antike - Me letërsinë dhe artin: Autorë të periudhës së rilindjes.	
Burimet: Libri i nxënësve, interneti.			

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Metodologjia:

Të menduarit logjik/hap pas hapi/punë në grupe

Organizimi i orës së mësimit:

- Mësuesi/ja tërheq vëmendjen e nxënësve duke i futur ata në brendësi të temës.
- Kush nga ju më thotë se cilat ishin disa arritje të antikitetit Greko-Romak?
- A mund të quhet antikiteti si një periudhë e lulëzuar?
- Po mesjeta a njohu të njëjtin zhvillim? Pse?
- Ç'farë roli luante kisha në mesjetë?
- Si shpjgoheshin dukuritë natyrore në mesjetë?
- Ç'farë ju kujtojnë emrat:Leonardo da Vinçi, Mikelanxhelo, Petrarcka etj?

Ndërtimi i njohurive:

Mësuesi/ja ndan klasën në grupe duke caktuar për secilin grup kërkesat që duhet të plotësojë pas leximit të mësimit.


Grupi parë: -Shpjegoni termat rilindje dhe humanizëm.

- Rilindja lëvizje kulturore evropiane që u zhvillua në fund të mesjetës dhe në fillim të epokës moderne.
- Humanizmi një mënyrë të menduarit dhe të vepruarit që bazohet në vlerën dhe dinjitetin njerëzor, në vend të besimit fetar.

Grupi i dytë: -Argumentoni pse qytet shtetet italiane u bënë atdheu i rilindjes evropiane?

- Cilat ishin disa nga familjet më të rëndësishme të rilindjes?
- Si u përhapën idetë e rilindjes nga Italia në pjesë të tjera të Evropës?

-Shkaqet që qytet –shtetet Italiane u bënë atdheu i rilindjes ishin:



4- Mbrojtja që gëzonin artistët italianë nga familjet e fuqishme si	→ Viskonti, Sforca, Ferrara, Este, Mediçi etj.
-Faktorët që ndikuan në përhapjen e ideve në Evropë	1-Pushtimi gad. Apenin nga monarkët evropianë(Francë, Gjermani) 2-Qëndrimi i disa studiuesve dhe mjeshtrave italianë në oborret mbretërore evropiane. 3-Periudha e paqes që mbizotëronte në Evropë lejonte përhapjen e ideve te reja. 4- Huazimi i ideve të Rilindjes nga aristokracia evropiane.
Grupi i tretë : -Renditni disa tipare të kulturës së Rilindjes	
Tipare të kulturës së Rilindjes	-doli përtej kornizave teologjike. - u mbështet në veprat e antikitetit greko-romak. -u përhap shpejt falë shtypshkrimit (J.Gutenberg). -U mbështet financiarisht nga aristokracia.
Grupi i katërt: -Shpjegoni pse kisha u bë mbështetëse e artit dhe kulturës së Rilindjes?	
-Argumentoni arsytet e rënies së Rilindjes Evropiane.	
-Arsyeja që kisha mbështeti kulturën e Rilindjes	→ papati synonte të rifitonte prestigjin e vet të humbur
Rënia e qytet shteteve Italiane (konfliktet mes shtresave, dhe ato midis qyteteve)	Rritja e presionit nga jashtë (Betejat mes Francës dhe Spanjës ne gad. Apenin)
-Shkaqet e rënies së Rilindjes	Përparimi i Osmanëve
	Zhvendosja e fuqisë ekonomike drejt shteteve si Angli, Spanjë, Francë, Holandë
Pyetje për diskutim	
Situata quhet e realizuar nëse nxënësit:	
1) Përkufizojnë termat Rilindje dhe Humanizëm	
2) Shpjegojnë shkaqet e zhvillimit të rilindjes në qytet shtetet italiane.	
3) Argumentojnë arsytet pse kisha e mbështeti rilindjen dhe shkaqet e rënies së Rilindjes.	
Vlerësimi:	
<i>Vlerësimi i nxënësit mbështetet në rezultatet e të nxënëit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</i>	
Detyrat dhe puna e pavarur:	
• Nxënëset u jepet detyrë të krijojnë një album me vepra të artit dhe arkitekturës të Rilindjes evropiane.	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shkenca shoqërore	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Zbulimet e mëdha gjeografike.		Situata e të nxënit: a) Rrethanat historike në të cilat u zhvilluan zbulimet gjeografike. b) Rrugët që ndoqën evropianët drejt “Botës së Re” c) Pasojat e zbulimeve gjeografike.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin Realizon një kërkim historik në planin individual në lidhje me një ngjarje të dhënë. Kompetenca personale Kupton, nëpërmjet kërkimit historik, përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, rëndësinë historike dhe ndryshimet e shoqërisë përgjatë kohërave. Kompetenca dixhitale Zhvillon kompetencën dixhitale për të gjetur, për të analizuar dhe për të komunikuar njohuritë historike.		Fjalët kyçe: <i>Zbulime gjeografike</i> <i>actekë</i> <i>inkas</i> <i>maja</i> <i>perandori koloniale</i>	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - analizon rrethanat që shkaktuan “Zbulimet e mëdha gjeografike”; - përcakton në hartë rrugën që përshkuan udhëtarët evropianë, në kërkim të Amerikës, Afrikës dhe Australisë; - vlerëson kulturën e popujve vendas; - shpjegon pasojat e zbulimeve të mëdha gjeografike.			
Burimet: Libri i nxënësit, interneti, harta.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Me gjeografinë: -Harta e zbulimeve gjeografike.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
Metodologjia: Punë kërkimore/ shkak-pasojë Organizimi i orës së mësimi: - Nxënësve u është ngarkuar që më parë detyrë të sjellin informacion të shkurtër rreth udhëtimit të K.Kolombit, të B.Diaz, Magelanit, Kabralit, A.Vespucit etj. -Nxënësit materialin duhet ta kenë të shoqëruar me harta ku të përshkruhet udhëtimi në fjalë, nëse jo duhet të punohet me hartën “Zbulimet e mëdha gjeografike” (materiali mund të paraqitet edhe në P. Point por duke orientuar që të jetë i sintetizuar) -Pasi nxënësit njihen me disa prej zbulimeve gjeografike mësuesi/ja e ndan klasën në dy grupe të mëdha për të zbuluar lidhjet shkak- pasojë. - Grupi i parë: Përcakton shkaqet e zbulimeve gjeografike (kushtet historike) - Grupi i dytë: Analizon pasojat e ndërsjellta të qytetërimit evropian dhe atij vendas pas zbulimeve gjeografike. Ndërtimi i njohurive: • Secilit prej grupeve u jepet një fletë nxënësit e kalojnë fletën me radhë brenda grupit duke shkruar sipas kërkesës përkatëse, një shkak ose një pasojë. • Mësuesi ndërton ndan tabelën në tre kolona si më poshtë dhe ngre me radhë nxënës të secilit grup deri në plotësimin e plotë të saj (për paraqitur më dukshëm kolonën e mesit e shkruajnë me ngjyrë tjetër).

Shkaqet	Zbulimet gjeografike	Pasoja
I. Ekonomike { 1) Mbyllja e rrugëve në Lindje 2) Kërkesat në rritje për metale çmuara dhe mallra nga Lindja	-B. Diaz-Kepi i Spresës së mirë -V.de.Gama- Kalkuta Indi - K.Kolombi-Amerikë(1492) -Anglezët- në skaji verior të Evropës	1- Rënia e popullatave vendase (inkasit, majat, actekët) 2- Zgjerimi dhe përsosja e njohurive gjeografike, shkencore.
II. Politike { Symimet e monarkive evropiane për të gjetur rrugë të reja për tu pasuruar dhe zgjeruar territoret	-Kabral —në Brazil -A.Vespuçi-Amerikën(1499-1502) -Magelani-rreth globit(1519-1522)	3- Ndryshoi vizioni teologjik i botës me qendër d.Mesdhe. 4- U zhvendos qendra e tregtisë nga d. Mesdhe në oq. Atlantik
III. Psikologjike { 1) Zelli fetar 2) Kureshtja intelektuale. 3) Shpirti i aventurës	-Zh. Kartier-aneksioi Kebekun Zbulimet gjeografike u favorizuan dhe nga arritjet tekniko-shkencore si: -Zbulimi i busullës. -përdorimii astrolabit -zhvillimi i hartografisë -ndërtimi i anijeve karavela.	5- U krijuan perandoritë koloniale evropiane. 6- U zhvillua tregtia e skllëvërve 7- U përhap krishterimi jashtë Evropës. 8- U pasurua borgjezia evropiane. 9- Shkëmbim i kulturave bujqësore.
PYETJE PËR DISKUTIM Situata quhet e realizuar nëse nxënësit: 1) Identifikojnë disa prej zbulimeve më të rëndësishme gjeografike dhe përcaktojnë në hartë rrugën e ndjekur. 2) Shpjegojnë rrethanat historike që nxitën zbulimet gjeografike. 3) Analizojnë pasojat e zbulimeve gjeografike.		
Vlerësimi: <i>Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënëti të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</i>		
Detyrat dhe puna e pavarur: Nxënësve u jepet si detyrë të shkruajnë një ese përshkruese me temë “K. Kolombi zbuluesi i Botës së RE”		

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shkenca shoqërore	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Reforma protestante		Situata e të nxënit: a) kisha dhe roli i saj në mesjetë b) shkaqet e lindjes dhe përhapjes së protestanizmit c) ndryshimi mes protestanizmit në Angli dhe atij në Evropën kontinentale.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e të menduarit - Ndërtton diagram dhe tabela për paraqitjen e të dhënave historike. Kompetenca personale - Përdor aftësitë e komunikimit, punësnë grup etj. për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij; Kompetenca qytetare - Zhvillon mirëkuptimin ndërkulturor, duke vlerësuar kulturat, gjuhët dhe besimet e ndryshme.		Fjalët kyçe: <i>reformacion</i> <i>indulgenca</i> <i>luteranizmi</i> <i>kalvinizmi</i> <i>kisha Anglikane</i>	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - përshkruan se si u zhvillua lëvizja protestante - analizon shkaqet e ndryshimeve fetare në Gjermani; - analizon pasojat e reformës protestante në qytetërimin evropiane; - dallon shkaqet që çuan në krijimin e kishës Anglikane			
Burimet: Libri i nxënësit, interneti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - Me geografinë: Shtrirja e protestanizmit në Evropë. - Me temat e mëparshme: Perandoria e Shenjtë Romake - Besimi dhe kultura në Greqinë dhe Romën antike	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Metodologjia:


Pyetje çelës/ kubimi.

Organizimi i orës së mësimit:

- Mësuesi/ja i drejton nxënësit drejt gjetjes së temës së re duke drejtuar pyetje të shkurtra (çelës). P.sh Si lindi krishterimi?
- Cilat ishin arsyet që krishterimi u përhap shpejt?/Ç’ndodhi me pozitën e kishës pas kryqëzatatave?
- Cili ishte roli i kishës në monarkitë evropiane të mesjetës?/Si ka ndryshuar shtrirja gjeografike e katolicizmit sot?Pse?
- Cila është feja më e përhapur sot në Gjermani? Po në Angli?

Ndërtimi i njohurive:

- Metoda e kubimit që do të përdoret gjatë kësaj ore mësimi është interesante sepse ndërthur brenda saj disa veprimtari si p.sh lexim, mendim kritik, të shkruarit dhe aftësi praktike.
- Për ta organizuar me këndshëm mësuesi ka përgatitur një kuti ne formë kubi (me përmasa të tilla që pas përfundimit të veprimtarisë materiali i shkruar në të, të lexohet qartë nga nxënësi), tabak letre të prera sipas përmasave të faqeve të kubit, ngjitës, lapustila me ngjyra të ndryshme. Kjo metodë realizohet sipas figurës së mëposhtme.



Klasa ndahet në pesë grupe për t'i realizuar me shpejtë kërkesat e mësipërme, kërkesa e fundit do të realizohet nga të gjitha grupet nëpërmjet plotësimit të tabakëve të letërës sipas kërkesave që mësuesi ka shkruar në to dhe plotësimit të hartës skicë e cila mund të jepet si detyrë në shtëpi. Secila fletë plotësohet si më poshtë nga nxënësit dhe ngjitet në kub pastaj lexohet dhe shpjegohet nga grupet përkatëse. Mësuesi/ja kalon te secili grup duke dhënë orientime.

Fleta 1- Përshkruaj situatën në Evropë në prag të reformacionit.

-mbretërit e Evropës po kërkonin të largoheshin nga influenca e kishës.

-kisha ishte larguar nga besimtarët dhe synonte përfitime ekonomike (taksat, indulgjencat)

-kisha gëzonte autoritet politik dhe ndërhynte në çështjet shtetërore

<i>Fleta II</i>-Argumento faktorët që nxiten Luterin të kundërshtonte kishën dhe shpjego përmbajtjen dhe përhapjen e luteranizmit. -Jeta luksoze në selinë papnore/studimi i thellë i biblës -Përmbajtja e luteranizmit -Arsyet e përhapjes së luteranizmit <i>Fleta III</i>:Analizo shkaqet që çuan në krijimin e kishës Anglikane. -konflikti kishë mbret në dy kontekste -shkaktari Henri VIII (Konflikti me papën për divorcin) -ligjet që çuan ë krijimin e kishës Anglikane <i>Fleta IV</i>: Cili besim fetar është krijuar përveç protestanizmit si rrjedhim i shkëputjes nga kisha katolike?Gjeni ngjashmëritë. -Ortodoksizmi si dhe protestanizmi u mbështetën në doktrinën e krishterë. <i>Fleta V</i>:Krahaso luteranët me kalvinistët dhe anglikanët, nxirr të përbashkëtat. (mund të ndërtohet Diagrami i Venit) 1-ishin kundër katolicizmit 2 kundër korrupsionit, abuzimit të kishës 3-ishin për një kishë të thjeshtë 4-gjetën përkrahje në shtresat e ndryshme të shoqërisë. PYETJE PËR DISKUTIM Situata quhet e realizuar nëse nxënësit: 1) Identifikojnë disa prej zbulimeve më të rëndësishme gjeografike dhe përcaktojnë në hartë rrugën e ndjekur. 2) Shpjegojnë rrethanat historike që nxitën zbulimet gjeografike. 3) Analizojnë pasojat e zbulimeve gjeografike. Vlerësimi: <i>Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</i> Detyrat dhe puna e pavarur: Nxënësve u jepet si detyrë të plotësojnë në hartën skicë shtrirjen e feve protestante në Evropë.	Individualizmi fetar (vetëm zoti e shpëton njeriun). Parimi i shpëtimit (njeriu shpëton nëpërmjet besimit) Parimi i shqyrtimit të lirë (besimi duhej të bazohej në leximin e biblës) Arsyet politike (konflikti princër-perandor, fshatarë –fisnikë) Arsyet fetare (kundërshtitë me kishën-përfitimet ekonomike) Arsyet e pakënaqësisë me korrupsionin e kishës Sundimin nga Roma e largët. Paqja e Augsburgut (1555) (liria e besimit) Ligji i 1533 i cili mohonte autoritetin e papës Ligji i 1534 i cili nënkuptonte betimin e besnikërisë ndaj mbretit Ligjet e 1559 u riorganizua dogma teologjike protestante..... etj Diagrami i Venit Luteranët Anglikanë të përbashkëtat kalvinistët
--	---

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shkenca shoqërore	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Reforma katolike ose kundërreformacioni			
Situata e të nxënit: a) pasojat e reformës protestante në kishën katolike. b) roli i urdhrit Jezuit në forcimin e kishës katolike c) trashëgimia e dy reformacioneve në Evropë.			
Fjalët kyçe: <i>kundërreforma</i> <i>jezuitët</i> <i>koncil</i> <i>urdhra fetarë</i>			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Shqyrton, analizon dhe parashtron pyetje, për të argumentuar, informacionin historik, konceptet dhe idetë. Kompetenca e të menduarit - Zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës. Kompetenca e të nxënit - Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: -përcakton pasojat e reformës protestante dhe analizën e papatit për të. -analizon shkaqet e ndryshimeve fetare në shtetin Papal; -rendit disa veçori të urdhrit të jezuitëve -analizon pasojat e reformës katolike dhe protestante.			
Burimet: Libri i nxënësit, interneti.			
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - Me gjeografinë: Shtrirja e protestanizmit në Evropë. - Me temat e mëparshme: Reforma protestante			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			

Metodologjia

Diskutim/pyetjës sërish

Organizimi i orës së mësimi:

-Mësuesi/ja drejton pyetje për të hapur diskutim në klasë duke nxitur të gjithë nxënësit të marrin pjesë në të.
 -Nxënësit rikujtojnë njohuri mbi temën e mëparshme.

Ku i ka fillesat protestantizmi?

Cilat ishin shkaqet që lindi protestantizmi?

Cilat ishin parimet e luteranizmit? Po kalvinizmi?

Si lindi kisha anglikane?

Si mendoni ju a pati pasoja mbi kishën katolike dhe papatin përhapja e protestantizmit në Evropë?

Ndërtimi i njohurive:

- Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë mësimin.
- Për secilën prej pjesëve të mësimi cakton dy nxënës. Një nxënës përgatit pyetjet që do ja drejtojë shokut kurse tjetri përgatitet për të zbërthyer pjesën. P.sh:

-*Pjesa e parë:*

1 - Ku u shtri protestantizmi?

Përgjigjen e kësaj pyetje nxënësi mund ta ilustrojë më hartën që ka plotësuar si detyrë nga ora e kaluar në shtëpi.

2 - Si u përgjigj kisha katolike ndarjes brenda krishterimit?

Përgjigja e nxënësit: $\sum$ Duke përmirësuar organizimin e brendshëm të saj.

Duke forcuar autoritetin e papës.

Përdori inkuizicionin për të shkatërruar protestantizmin në Itali.

Pasi nxënësi i përgjigjet pyetjeve atëherë mësuesi/ja drejtohet nga klasë nëse kanë ata pyetje për shokun dhe kalon në pjesën tjetër pasi ka kuptuar se pjesa e parë është realizuar.

-*Pjesa e dytë:* Mësuesi bën kujdes që pyetjet e drejtuara të zbërthejnë kuptimin e pjesës nëse jo ndërhyn për të orientuar.

1 - Çfarë ishin jezuitët? Nga kush u themelua ky urdhër fetar?

2 - Cilat ishin disa veçori të urdhrit të jezuitëve?

Nxiti riorganizimin e kishës.

Ishte për rreptësi të doktrinës fetare dhe disiplinë të saj.

Nxënësi rendit veçori të Jezuitëve -Pjesa e tretë: 1-Kur dhe pse u thirr Koncili i Trentos? 2-Cilat ishin vendimet e tij?	Luajtën rol të rëndësishëm në zhvillimin e arsimit Ndihmoi kishën katolike të rifitonte terren në disa zona në Evropë, Azi, Amerikën e Veriut dhe Latine. Nxënësi duhet të rendisë Vendumet Hodhi poshtë doktrinën reformatore Konfirmoi sërish si autoritetin më të lartë të kishës Papën. U kundërvu martesës së priftërinjve (celibati) Krijimin e seminarëve në secilën dioqezë.
Pjesa e katërt: 1-Cila ishte trashëgimia e dy reformacioneve: Nxënësi rendit: trashëgimitë	Më shumë se gjysma e Evropës mbeti katolike.(shpjegon shtetet me radhë) Paqja e Ausburgut përforcoi copëtimin politik në Gjermani. Kisha humbi ndikimin mbi pushtetin politik mbi dhe në shtetet që vazhdoi të ruante influencën saj Në Gjermani dhe gad. Skandinav luteranizmi u njoh si kishë shtetërore, anglikanizmi si fe shtetërore Si reformacioni dhe kundërreformacioni ndikuan në përhapjen e arsimit. Reformacioni solli forcimin e shtresës së mesme.
PYETJE PËR DISKUTIM Situata quhet e realizuar nëse nxënësit: 1) Shpjegojnë ndikimin që pati reforma protestante tek Papati. 2) Rendisin veçoritë e urdhrit të jezuitëve 3) Analizojnë trashëgiminë e reformacionit dhe kundërreformacionit në Evropë	Vlerësimi: <i>Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënëtit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</i> Detyrat dhe puna e pavarur: Nxënësvue u jepet si detyrë pyetja e fundit në rubrikën “Verifikoni njohuritë” pas mësimit.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shkenca shoqërore	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Veprimtari praktike: Jeta në Evropë në shek. XVI-XVII		Situata e të nxënësve: a) Jeta e evropianëve në fillim të epokës moderne. b) Ndërtimi i qyteteve në shek. XVI-XVII c) Zhvillimi i kulturës dhe letërsisë në epokën moderne	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurisë - Shqyrton, ndërton analizën dhe parashtron pyetje, për të argumentuar, informacionin historik, konceptet dhe idetë. Kompetenca e të nxënësve - Parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumente dhe burime. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin - Zhvillon një kërkim individual ose në grup për kryerjen e një veprimtarie në histori. Kompetenca digjitale - Akceson një sërë burimesh digjitale të informacionit dhe analizon në mënyrë kritike këto burime.		Fjalët kyçe <i>Iluminizëm,</i> <i>Humanizëm,</i> <i>Rilindje,</i> <i>Shthurja e feudalizmit</i> <i>Seminaret jezuite,</i>	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore - Diskutojnë për tiparet e jetës qytetare në Evropë gjatë shek. XVI-XVII; - Diskutojnë për tiparet e artit, kulturës shkencës dhe arsimit në Evropë gjatë shek. XVI-XVII.			
Burimet: Libri i nxënësve, interneti, video, foto, literaturë historike dhe artistike.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - Me temat e mëparshme: Matematika 3 - Me letërsinë: Vepra të autorëve humanistë dhe rilindas.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
Metodologjia:	Diskutim /punë në grupe Organizimi i orës së mësimit: • Sugjerohet që kjo orë mësimi të zhvillohet në kabinetin e informatikës ku nxënësve tu jepet mundësia të përdorin kompjuterin, internetin për të kërkuar dhe hulumtuar informacion rreth temës së dhënë. • Ora e veprimtarisë praktike do të zhvillohet në dy faza Ndërtimi i njohurive: • <i>Faza e parë: Diskutim.</i> Mësuesi/ja organizon nxënësit të marrin pjesë në diskutim nëpërmjet pyetjeve: ➤ Si ndryshon jeta e evropianëve në fillimet e epokës moderne? - Ku jetojnë? - Si e sigurojnë jetesën? - Çfarë ushqimesh konsumojnë? - A arsimohen dhe si? - Si është higjiena e tyre personale? - A kanë kohë të lirë dhe si e kalojnë atë? ➤ Cilat ishin ndryshimet në qytetet e kësaj periudhe? • Numri i popullsisë. • Organizimi urban. • Qytetet si qendra konsumi dhe tregtie. • Qyteti dhe borgjezia, një binom i pandashëm. • A ka risi në kuadrin e organizimit shoqëror, ekonomik? ➤ Cilat janë zhvillimet në kulturë? • Veprat dhe përfaqësuesit kryesorë në letërsi. • Krymat në art dhe arkitekturë, si dhe përfaqësuesit kryesorë të tyre. • <i>Faza e dytë: Punë në grupe.</i> -Mësuesi/ja e ndan klasën në dy grupe dhe cakton detyrat për secilin grup si më poshtë:

Grupi i parë:- Grumbulloni të dhëna për jetën e një familjeje fisnike. -Evidentoni rëndësinë e përkatësisë klasore në aspekte të ndryshme të mënyrës së jetesës. -Ndërtoni një paraqitje skematike dhe prezantojeni atë në klasë. Grupi i dytë:-Grumbulloni të dhëna për jetën e një familjeje fshatare. -Evidentoni rëndësinë e përkatësisë klasore në aspekte të ndryshme të mënyrës së jetesës -Ndërtoni një paraqitje skematike dhe prezantojeni atë në klasë. Pyetje për diskutim Situata quhet e realizuar nëse nxënësit: 1) Identifikojnë tipare te jetës dhe shoqërisë në shek. XVI-XVII. 2) Krahasojnë pozitën e shtresave të ndryshme shoqërore. 3) Evidentojnë arritjet në art, letërsi, arkitekturë dhe përfaqësuesit kryesorë të tyre. Vlerësimi: <i>Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</i>	
---	--

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shkenca shoqërore	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore:Perandoria Osmane në dhe Ballkani (shek XV-XVI)			
Situata e të nxënit: a) Marrëdhëniet e Perandorisë osmane me shtetet evropiane. b) Organizimi Osman në Ballkan c) Veçori të trashëgimisë osmane sot në Ballkan.			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e të nxënit		Fjalët kyçe:	


- Shfrytëzon të dhënat për të kuptuar konceptet historike dhe shoqërore, prezanton në forma të ndryshme materialin Kompetenca personale Përdor komunikimin për të argumentuar idetë e tij. Kompetenca qytetare - Shqyrton në mënyrë kritike sjelljet, motivet dhe veprimet e njerëzve në të shkuarën.	<i>saxhak</i> <i>sistemi i deroishmesë</i> <i>kapitulacione</i> <i>bogomilizmi</i> <i>sistemi i timarit</i> <i>"Lidhja e Shenjtë"</i>
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Përcakton në hartë zgjerimin e Perandorisë Osmane - Analizon tiparet e politikës osmane në Ballkan; - Vlerëson trashëgiminë osmane në art, kulturë, shkencë, ekonomi dhe në jetën e përditshme.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - Me gjeografinë: Shtrirja e Perandorisë Osmane - Me temat e mëparshme: Perandoria osmane (1300-1492)
Burimet: Libri i nxënësit, interneti.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	

Metodologjia:

Stuhi mendimesh/ditari dypjesësh

Organizimi i orës së mësimt:

-Mësuesi/ja shkruan në tabelë "Perandoria Osmane" dhe kërkon nga të gjithë nxënësit të rikujtojnë dhe të thonë një fakt lidhur me të.



Ndërtimi i njohurive:

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë mësimin dhe ndërkohë ndërton në dërrasë një tabelë në formën e një ditari dypjesësh të cilën e plotëson duke drejtuar pyetje nxënësve.

Koncepti	Komenti
I) Luftërat me Austrinë: 1-Lufta e parë (1501-1541) 2-Lufta e dytë (1606)	Beteja Mohaçit (disfata e Hungarezëve) Rrethimi i parë i Vjenës në 1529 (disfata e osmanëve) Pushtimi i Hungarisë (sanxhaku i Budinit) Përfundoi me paqen e Sitvatorit (u ruajt gjendja e paralufës)
Marrëdhëniet e Perandorisë Osmane me Shtetet e Evropës	Rrethimi i dytë i Vjenës (disfata e osmanëve) 3-Lufta e tretë (1683) Krijimi i "Lidhjes së Shenjtë". Marrja e Budës dhe Beogradit Krijimi i një sanxhaku në kufi me Ukrainën II) Pushtimi i Moldavisë

	III) Luftërat me Karlin e V, Papatin, Venedikun → Fitorja e osmanëve (në vitet “40) IV) Sistemi i kapitulacioneve → { Do të mbretëronte paqja dhe miqësia. Lejohej qarkullimi i lirë i shtetasve Lejohej tregtia e lirë Sigurohej paprekshmëria e francezëve në shtetin osman
Politika osmane Ne Ballkan	Principatat vasale të krishtera (Moldavi, Villahi, Transilvani) Ndarja e territoreve → Zonat ku u zbatua sistemi feudal-ushtarak (pashallëku i Beogradit, Budinit dhe elajeti i Rumelisë)
Trashëgimia osmane	I) Kolonizimi → vendosjes se kolonëve turq në luginat e l. Marica e Vardar dhe në brigjet e D.t Zi. II) Islamizimi → Konvertimi në myslimanë nëpërmjet { Sistemit të Dervishmësë Tregtisë së robve dhe skllëvërve. Lehtësirave për myslimanet Përhapjes së Bogomilizmit III) Veçoritë e Qytetërimit Osman → { Mënyrën e ndërtimit të qyteteve Kalimin nga timari në çifligje dhe ferma bujqësore Gjuhë dhe letërsi
Pyetje për diskutim Situata quhet e realizuar nëse nxënësit: 1) Shpjegojnë marrëdhëniet ndërmjet Perandorisë osmane dhe shteteve evropiane në shek. XV-XVI. 2) Analizojnë politikën osmane në Ballkan. 3) Argumentojnë trashëgiminë osmane sot në Ballkan.	
Vlerësimi: <i>Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënëtit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</i>	
Detyrat dhe puna e pavarur: • Nxënëseve u jepet si detyrë rubrika “Hulumtoni dhe diskutoni pas mësimit.	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shkenca shoqërore	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Monarkia absolute në Francë		Situata e të nxënit: a) Konfliktet fetare në Francë ,ardhja në pushtet e Bourbonëve b) Qeverisja e Luigjit të XIII dhe XIV c) Politika financiare dhe fetare e Luigjit të XIV.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e të menduarit • Ndërton skica dhe tabela për paraqitjen e të dhënave historike Kompetenca e të nxënit • Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet për një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet. Kompetenca qytetare • Shqyrton burimet historike për të kuptuar çështjet shoqërore dhe se si parime të ndryshme kanë ndikuar në çështjet njerëzore.		Fjalët kyçe: <i>Hygenot,</i> <i>"Lufta Tridhjetëvjeçare" ,</i> <i>"Mbreti Diell" ,</i> <i>absolutizëm</i> <i>merkantelizëm</i> <i>edikti i Nantës</i>	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - analizon tiparet e absolutizmit gjatë qeverisjes së Luigjit XIV; - shpjegon strukturën e organizimit të oborrit mbretëror; - krahason mënyrën e jetesës së shoqërisë sipas shtresave . - vlerëson rolin e Luigjit XIV në arkitekturën e kryeqytetit të Francës.			
Burimet: • Libri i nxënësit, interneti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: • Me temat e mëparshme: Monarkia franceze gjatë mesjetës. • Me ekonominë: merkantilizmi.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Metodologjia:

Diskutim/reportazh


Organizimi i orës së mësimit:

- Mësuesi/ja për të nxitur kureshtjen e nxënësve përdor projektorin për të shfaqur pamje nga pallati I Versajës(https://www.youtube.com/watch?v=YR0DqcgI_5I) ose duke klikuar “Le chateau de Versailles”
- Nxënësit diskutojnë rreth fakteve ose rreth kurioziteteve që mund të dinë mbi Versajën ose Luigjin e XIV . Nëse nxënësit nuk sjellin fakte atëherë mësuesi mund të ketë parapërgatitur fakte të ndryshme rreth Versajës. (shih Wikipedia)

Ndërtimi i njohurive:

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit se pasi të jetë lexuar mësimi sipas grupeve të caktuara nga secili grup do të dalin dy përfaqësues ku nxënësi i parë do të bëjë një skemë të temës së dhënë në tabelë kurse tjetri do të prezantoj temën në formën e një reportazhi. Mund të ndërtohet një skemë orientuese nga vetë mësuesi/ja dhe të plotësohet nga nxënësit.

Grupi I: Franca në fund të shek XVI dhe XVII.



Grupi II: Qeverisja e Luigjit të XIV	
Qeverisja e Luigjit të XIV Politika e brendshme U forcua uniteti kombëtar u mbështetën fisnikët e rinj u zhvillua kultura-arkitektura u vendos intoleranca fetare (dekreti Fontenëblo 1685) Financat Ministri KolberMerkantilizmi Bilance tregtare pozitive Zgjerim në koloni Krijimi i industrive të reja Shkaku i problemeve Financiare Shpenzimet mbretërore Luftrat në Evropë Politika e jashtme Katër luftra (1667-1714) Lufta për trashëgimin e fronit Spanjoll.(1701-1713) Paqjae Utrehtit Vendosja e ekuilibrit në Evropë	
Pyetje për diskutim	
Situata quhet e realizuar nëse nxënësit: 1) Përcakton gjendjen në Francë në shek. XVI-XVII. 2)Shpjegon qeverisjen e Luigjit të XIV. 3) Analizojnë shkaqet e problemeve financiare në Francë pas vdekjes së Luigjit të XIV dhe pasojat e tyre.	
Vlerësimi:	
<i>Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</i>	
Detyrat dhe puna e pavarur:	
Nxënësve u jepet si të shkruajnë një ese argumentuese me temë “Shteti jam unë”	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shkenca shoqërore	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Rusia, perandori e fuqishme		Situata e të nxënës: a) Krijimi i shtetit të Rusisë nga Ivani i tmerrshëm, dhe nipi i tij. b) Qeverisja e Pjetrit të madh dhe Katerinës së madhe. c) Ndikimi iluminist në qeverisjen e Pjetrit dhe Katerinës së madhe.	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Përdor funksionet gjuhësore të teksteve historike, fjali komplekse për shpjegimin e marrëdhënieve shkak-pasojë përdorimin e emrave, ndajfoljeve dhe mbiemrave për të përshkruar vendet, njerëzit. Kompetenca e të nxënës • Ndërlidh temën me njohuritë dhe përvojat paraprake Kompetenca personale • Përdor aftësitë e komunikimit për të argumentuar idetë e tij.		Fjalët kyçe: <i>Monarku iluminist,</i> <i>modernizim,</i> <i>evropianizim</i>	
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - përcakton konceptin monarkë iluministë; - shpjegon tiparet e qeverisjes së Pjetrit të Madh dhe të Katerinës II; - analizon ndikimin e iluminizmit në zhvillimin e Rusisë gjatë qeverisjes së Pjetrit të Madh dhe të Katerinës II.			
Burimet: • Libri i nxënësit, interneti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: • Me letërsinë: botimet letrare të kësaj periudhe • Me gjeografinë: zgjerimi territorial i perandorisë Ruse.	


Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Metodologjia:

Stuhi mendimesh/ditari dypjesësh

Organizimi i orës së mësimt:

- Mësuesi/ja shkruan në tabelë "Rusia" dhe kërkon nga nxënësit të shprehin lirshëm se ç'dinë për të.



Ndërtimi i njohurive:

- Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë mësimin dhe ndërkohë ndërton tabelën duke vendosur në të edhe konceptet kryesore mbi të cilat do të ndërtohet mësimi i ri. Duke drejtuar pyetje nxënësve mësuesi/ja plotëson tabelën

Koncepti	Komenti
Fillesat e shtetit unitar Rus	-Qeverisja e Ivanit të madh - Rusia u çlirua nga pushtimi mongol në fund të shek XV -Ivani I forcoi pushtetin qendror, i dha fund vetëqeverisjes së qyteteve -Hoqi privilegjet e shtresës së fisnikëve,dhe këshillit të bojarëve. -Qeverisja e Ivanit të IV -Ivani i IV u quajt me titullin car. -Territoret ruse u zgjeruan në lindje. -Sundoi ne mënyrë autokratike -Dinastia Romanove (1613-1917) -Erdhi në pushtet kur Rusia rrezikohet nga lufta civile dhe pushtimet e Suedisë dhe Polonisë. -Mihail Romanovi u zgjodh nga një asamble e qytetarëve dhe pronarëve të tokave në 1613.
	-Synimet → Modernizimi, evropianizimi i Rusisë → Fuqizimi i Rusisë dalja në det nga perëndimi (filloi Luftën e Madhe të Veriut)

Qeverisja e Pjetrit të madh. ↓ Monark iluminist	(Siguroi daljen në d. Balltik. Zëvendësoi këshillin e bojarëve me zyrtarë të emëruar. Krijoi senatin si mbikëqyrës të administratës. Bëri ndarjen në krahina të Rusisë. Nxiti zhvillimin e industrive të reja me përkrahjen e shtetit. Kisha ruse u vendos nën drejtimin e shtetit, krijoi Sinodin e Shenjtë. Evropianizoi veshjen e fisnikëve. Themeloi shkollat për fëmijët e fisnikëve. Modernizoi kalendarin, thjeshtoi alfabetin. Integroji rolin e gruas në shoqëri. Vendosi si kryeqytet të ri Shën Petërburgun -Arrijtjet dhe reformat
Qeverisja e Katerinës së madhe.	-Çlirroi fisnikët nga shërbimi ushtarak. -U dha më shumë liri tregtarëve dhe qytetarëve. -Mbështeti tregtinë, artin dhe shkencën. -Zgjeroi territoret drejt Polonisë dhe drejt Jugut (luftoi dhe fitoi mbi Turqit në dy luftëra) -Nënshkroi traktatin Kuçuk Kajnarxhit (1774) sipas të cilit Rusia fitoi: a) disa territore dhe kontrollin e bregut verior të Detit të Zi b) privilegjin e mbrojtjes së ortodoksëve në Perandorinë Osmane. c) të drejtën e lundrimit në ujërat e Turqisë.
Pyetje për diskutim Situata quhet e realizuar nëse nxënësit: 1) Përkrahajnë qeverisjen e Ivanit të Madh, Ivanit të IV. 2) Analizojnë reformat e Pjetrit të Madh. 3) Analizojnë karakteristikat e qeverisjes së Katerinës, krahasuar me ato të Pjetrit të Madh..	
Vlerësimi: <i>Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënëtit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</i>	
Detyrat dhe puna e pavarur: Nxënësve u jepet si detyrë të kërkojnë dhe sjellin informacion rreth përfaqësuesve të tjerë të dinastisë Romanove.	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shkenca shoqërore	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Veprimtari praktike: Monarkët e iluminuar në Evropë.		Situata e të nxënës: a) Monarkët e iluminuar të Evropës b) Reformat e ndërrmarra në fusha të ndryshme nga monarkët iluministë. c) Të përbashkëtat dhe të veçantat në reformat e ndërrmarra.	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurisë - Përdor funksionet gjuhësore të teksteve historike, fjali komplekse për shpjegimin e marrëdhënieve shkak-pasojë . Kompetenca e të nxënës - Parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumente dhe burime. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin - Zhvillon një kërkim individual ose në grup për kryerjen e një veprimtari në histori. Kompetenca digjitale Akseson një sërë burimesh digjitale të informacionit dhe analizon në mënyrë kritike këto burime.		Fjalët kyçe <i>Iluminizëm,</i> <i>Monarkët iluministë,</i> <i>Reforma,</i> <i>Të qeverisurit e drejtë.</i>	
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore - Diskutojnë mbi reformat e këtyre monarkëve dhe ndryshimet që rrodhën prej tyre. - Analizojnë ndryshimet në reformat e ndërrmarra ndërmjet monarkëve iluministë në shtete të ndryshme.			
Burimet: Libri i nxënësit, interneti, foto, materiale të përgatitura nga mësuesi etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Me letërsinë; veprat e iluministëve.	

		Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
Metodologjia:		
Punë kërkimore në grupe/diskutim/diagram Veni.		
Organizimi i orës së mësimi:		
• Për organizimin e kësaj veprimtarie praktike mësuesi ka udhëzuar dhe ka ndarë grupet dhe detyrat për secilin prej tyre që më parë. • Klasa ndahet në tre grupe përkatësisht: - Grupi i parë:Hulumton dhe grumbullon informacion mbi jetën dhe veprimtarinë e Frederikut të Prusisë. - Grupi i dytë: Hulumton dhe grumbullon informacion mbi jetën dhe veprimtarinë e Maria Terezës dhe Jozefit të II të Austrisë. - Grupi i tretë: Hulumton dhe grumbullon informacion mbi jetën dhe veprimtarinë e Pjetrit të Madh dhe Katerinës së Madhe të Rusisë.		
Ndërtimi i njohurive:		
• Ora e mësimi fillon me një prezantim dhe diskutim të nxënësve sipas grupeve. - Secili prej grupeve diskuton dhe analizon figurën e monarkut iluminist duke u bazuar në kërkesat e mëposhtme. -Vini në dukje faktorët që shtynë disa prej monarkëve absolutë evropianë, të përshatnin politika të bazuara në idetë iluministe. -Hulumtoni lidhur me raportet direkte mes monarkëve të iluminuar dhe përfaqësuesve të doktrinës iluministe. - Duke hulumtuar burime të ndryshme, identifikoni disa prej veprave të iluministëve që kanë shërbyer si frymëzim për monarkët e iluminuar. -Identifikoni tiparet e sundimit të monarkëve të iluminuar. -Analizoni reformat kryesore të ndërmarra prej monarkëve të iluminuar: a) në fushën e legjislacionit; b) në marrëdhëniet me kishën; c) në fushën sociale; d) në centralizimin e burokracisë; e) në marrëdhëniet ekonomiko-shoqërore (bujkrobëria). -Identifikoni kufizimet e monarkëve të iluminuar (raporti shkak-pasojë mes reformave dhe pushtetit) • Pas prezantimit dhe njohjes së monarkëve Iluministë dhe reformave të tyre mësuesi/ja nxit debatin në klasë duke kërkuar nga nxënësit të realizojnë një analizë krahasimore (diagram Veni) rreth reformave të Frederikut të Prusisë dhe Maria Terezës dhe		

Jozefit të Austrisë. Pyetje për diskutim Situata quhet e realizuar nëse nxënësit: 1) Identifikojnë figurat , veprat kryesore të iluministëve si dhe monarkët që u ndikuan nga idetë e tyre në qeverisje. 2) Analizojnë reformat e monarkëve iluministë në fusha të ndryshme . 3) Krahatojnë reformat e monarkëve iluministë duke nxjerrë të përbashkëtat dhe të veçantat. Vlerësimi: <i>Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënëti të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</i>

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shkenca shoqërore	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Spanja dhe Portugalia shtetet e para koloniale		Situata e të nxënës: a) Shtirja e Perandorisë portugeze. b) Faktorët e dobësimit të pozitës koloniale të Portugalisë. c) Shtirja dhe organizimi i Perandorisë spanjolle, pasojat e kolonizimit mbi popullsinë vendase.	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e të menduarit - Analizon të dhënat për të kuptuar të shkuarën ,shkakun dhe pasojën vazhdimësinë dhe ndryshimin. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin - Diskuton individualisht për rëndësinë që ka e shkuara në kuptimin e të tashmes dhe perspektivat në të ardhmen. Kompetenca personale - Përdor aftësitë e komunikimit, për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij		Fjalët kyçe: <i>Perandori koloniale,</i> <i>Kolonizatorë</i> <i>Inkasit,</i> <i>Actekët ,</i> <i>Spanja e Re,</i> <i>Kastilja e Re</i>	
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - përcakton në hartë shtrirjen e kolonive spanjolle dhe portugeze në Amerikën Qendrore dhe Jugore; - analizon tiparet e ekonomisë së kolonive spanjolle dhe portugeze; - shpjegon marrëdhëniet kolonizatorë dhe vendas; - evidenton pasojat e kolonizimit spanjoll dhe portugez.			
Burimet: Libri i nxënësit, interneti, harta të perandorive koloniale.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - Me temat e mëparshme: Zbulimet e mëdha gjeografike. - Me gjeografinë :Shtirja e perandorive koloniale Spanjolle dhe Portugeze.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Metodologjia:

Parashikim me terma paraprakë/shkrim i lirë(ndërtim ditari)

Organizimi i orës së mësimi:

-Mësuesi/ja vendos në tabelë foto të: Kristofor Kolombit, të flamurit të Portugalisë,të flamurit të Spanjës,Hartë të perandorisë koloniale Spanjolle,hartë të perandorisë koloniale Portugeze.

-Kërkon nga nxënësit të gjejnë se

C''lidhje kanë këto figura njëra me tjetrën?

Nga kush u financua udhëtimi i Kristofor Kolombit? Cilat rajone zbuloi ai?

-Mësuesi/ja nëpërmjet hartës tregon se ku u shtrinë këto dy Perandori koloniale.

Ndërtimi i njohurive:

Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë mësimin dhe për çdo çështje të mbajnë shënime me pikat kyçe.P.sh:

I-Perandoria koloniale portugeze

Shtirja gjeografike →pikat bregdetare ne Afrikë,në Indi,në Cejlon,Sumatra, Java, Celebes, Moluke, Kanton, Japoni,Brazil

-Perandori tregtare e drejtuar drejtpërdrejt nga kurora mbretërore.

-mbeti një perandori e kufizuar enklavash.

-përfytyese e pasurive ishte kurora dhe tregtarët e përkrahur prej saj.

-perandoria koloniale ishte mjaft e gjerë dhe Portugalia një shtet i vogël për ta administruar atë

II-Perandoria koloniale Spanjolle

Shtirja gjeografike →Në Inditë Perëndimore ose në Amerikë.

-K.Kolombi kolonizoi Antilet.

-A.Vespuçi kolonizoi bregdetin Atlantik të Amerikës së Jugut. (1499-1501)

-Balboa kolonizoi bregun e oq. Paqësor (1513)

-H.Kortes pushtoi Meksikën. (1519-1521)

-F.Pizarro pushtoi Perunë (1530-1535)

Mëkëmbësi në Spanjën e Re mbështetej nga Audencia

Administrimi bëhej nga Këshilli i Indive

(në Madrid)


Mëkëmbësi në Kastiljen e Re mbështetej nga Audencia

Ekonomia kontrollohej nga Casa de la contraction	
Pasojat e kolonizimit	{ U shkatërrua kultura vendase U masakrua dhe ra ndjeshëm numri i popullsisë vendase (inkasit, actekët) U morën shumë pasuri prej kolonive. { Në koloni u fut teknologjia, kultura, gjuha, institucionet, dhe besimi fetar i Evropianëve
Pasi nxënësit nxjerrin shënimet mësuesi/ja i nxit në diskutim duke drejtuar pyetje rreth mësimit, dhe duke kërkuar të gjejnë në hartë shtrirjen gjeografike të perandorive koloniale.	
Pyetje për diskutim	
Situata quhet e realizuar nëse nxënësit:	
1) Përcaktojnë në hartë shtrirjen gjeografike të perandorive koloniale. 2) Shpjegojnë veçori të kolonizimit portugez dhe spanjoll 3) Analizojnë pasojat e krijimit të perandorive koloniale.	
Vlerësimi:	
<i>Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënëit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</i>	
Detyrat dhe puna e pavarur:	
Nxënëseve u jepet si detyrë rubrika “Hulumtoni dhe diskutoni”	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shkenca shoqërore	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Anglia në shek XVII		Situata e të nxënësve: a) Qeverisja e Elisabetës së I ardhja në pushtet e Stjuartëve. b) Lufta civile dhe protektorati. c) Revolucioni i Lavdishëm, triumfi i parlamentarizmit.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e të nxënësve • Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin • Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët për realizimin e një veprimtarie të përbashkët Kompetenca qytetare • Shqyrton burimet historike për të kuptuar çështjet shoqërore dhe se si parime të ndryshme kanë ndikuar në çështjet njerëzore		Fjalët kyçe: <i>Puritanët,</i> <i>revolucion,</i> <i>luftë civile,</i> <i>protektorat,</i> <i>restaurim,</i> <i>revolucion i lavdishëm,</i> <i>Mbretëri e bashkuar.</i>	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - përkufizon konceptin revolucion politik; - përcakton dhe shpjegon fazat e revolucionit anglez, duke argumentuar evolucionin politik të tij; - analizon përmbajtjen dhe vlerat e Aktit mbi të Drejtat e Njeriut; - shpjegon tiparet e qeverisjes pas revolucionit në Angli.			
Burimet: • Libri i nxënësit, interneti		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: • Me temat e mëparshme: Monarkia Angleze	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
Metodologjia: Pyetje –përgjigje/strukturë e mendjes	1. Organizimi i orës së mësimit: -Mësuesi/ja rikujton njohuri të nxënësve që kanë lidhje me temën e re. P.sh: Cilat ishin dinastitë kryesore që sunduan Anglinë në mesjetë? Si erdhi në pushtet dinasti e Tudorëve? Kur? Kush e di se cili ishte një ndër mbretërit më të shquar të dinastisë Tudor? Ndërtimi i njohurive: -Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë mësimin duke e ndarë klasën në katër grupe ku secili grup lexon çëshijen përkatëse. -Pasi nxënësit kanë lexuar mësimin mësuesja drejton pyetje dhe plotëson një skemë përmbledhëse të mësimit. <i>Grupi i parë:</i>Elizabeta Tudor dhe ardhja e Stjuartëve në fronin e Anglisë. 1-Kur sundoi dinastia Tudore? 2-Cilat ishin veçoritë e qeverisjes së Elizabetës së parë? 3-Cila ishte tabloja e Anglisë nën qeverisjen e Jakovit të parë Stjuart? <i>Grupi i dytë:</i>Sundimi i Stjuartëve 1-Cili ishte synimi i mbretërve të parë Stjuart? 2-Ç’farë përmbante peticioni mbi të drejtat? 3-Cilat ishin kundërshtarët politikë në Angli? <i>Grupi i tretë:</i>Lufta civile,Republika. Protektorati. Restaurimi i Stjuartëve 1-Pse u thirr’Parlamenti i Gjatë’? 2 Cilat ishin masat që mori ai? 3-Kur u zhvillua lufta civile? 4-Cilat ishin fazat që pasuan rënien e monarkisë? 5- Kur u rikthyen përsëri në pushtet Stjuartët? <i>Grupi i katërt:</i> 1-Ç’farë përfaqëson revolucionin i lavdishëm për Anglinë? 2-Ç’përmbante Akti i Trashëgimit të Fronit dhe Akti i Bashkimit?



PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shkenca shoqërore	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Lufta për pavarësi dhe lufta civile në Amerikën Veriore			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e të nxënit Kupton konceptet historike dhe shoqërore dhe i prezanton nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët për realizimin e një veprimtarie të përbashkët Kompetenca personale Përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj. për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij		Situata e të nxënit: - Mosmarrëveshjet e kolonive amerikane me Britaninë - Lufta për pavarësi dhe organizimi i shtetit të ri amerikan. - Lufta civile në SH.B.A dhe pasojat e saj. Fjalët kyçe: <i>taksa pa përfaqësim,</i> <i>revolucion i amerikan,</i> <i>deklarata e pavarësisë,</i> <i>republikë federale,</i> <i>konfederatë shtetesh.</i>	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - shpjegon shkaqet e luftës për pavarësi të kolonive angleze të Amerikës së Veriut; - vlerëson rëndësinë e Deklaratës së Pavarësisë të kolonive angleze të Amerikës së Veriut; - analizon kushtetutën amerikane dhe argumenton rëndësinë e saj në demokracinë amerikane; - analizon shkaqet e luftës civile, si dhe rrjedhojat e saj.			
Burimet: Libri i nxënësit.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - Me temat e mëparshme: Zbulimet gjeografike - Me gjeografinë: Shtrirja e kolonive Evropiane në Amerikën e Veriut.	


Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Metodologija:

Parashikim nëpërmjet fjalëve kryq/ punë në grupe

Organizimi i orës së mësimi:

- Mesuesi/ja ndan klasën në dy grupe të mëdha dhe për secilin grup shpërndan fleta me fjalë të shkruara si më poshtë.




Pasi nxënësit bashkojnë copat dhe formojnë fjalitë mësuësja i shënon fjalitë në tabelë dhe u shpjegon se mësimi i ri ka të bëjë me këto dy ngjarje të rëndësishme që çuan në krijimin e një prej shteteve më të përparuara dhe më demokratike në botë.

Ndërtimi i njohurive:

- Mësuksi/ja ndan klasën në katër grupe dhe secilit grup i cakton një nga qëshkjet e mësimi për të lexuar si dhe të ndërtojë një përmbledhje për ngjarjen përkatëse. (ose mësuksi mund të ndërtojë një skemë orientuese që plotësohet nga grupet)

Grupi I: Amerika Veriore në fillim të shek. XVII



Grupi II: Revolucioni dhe pavarësia e kolonive

- Vendosja e taksave të reja nga Britania mbi kolonitë
- Bojkoti i importit të çajit, kundërshtimi i taksës.
- Thirrja e Kongresit Kontinental në Filadelfia.
- Ngjarja e 16 dhjetorit 1773 në Boston
- Fillimi i luftës ndërmjet Britanisë dhe kolonive 1775.(beteja në Lexington)

Hapat që çuan në shpalljen e pavarësisë

<i>Grupi III: Revolucionari politik</i> -Thirrja e Kongresi të II Kontinental që vendosi → Prejken e një monedhe të re → Krijimin e arkës shtetërore → Krijimin e ushtrisë → Kongresi në rolin e qeverisë -“Deklarata e pavarësisë” 4 korrik 1776 -Aleanca me francezët, fitoret mbi ushtrinë britanike -Traktati i paqes në Paris(1783)njohta nga Britania e pavarësisë së kolonive	<i>Grupi IV: Lufta civile në SH.B.A.</i> Kushtetuta amerikane -U miratua në 17 shtator 1787(kushtetuta me demokratike e kohës) -forma shtetërore → Republikë Federale/Forma qeverisëse → Republikë Presidenciale -Sanksiononte ndarjen e pushteteve → Ekzekutivi (Presidenti,qeveria federale) → Legjislativi (parlamenti që përbëhet nga dy dhoma) → Gjyqësori (Gjykata e Lartë) Lufta civile (1861-1865) -Shkaku ishte konflikti Veri-Jug për → Çështjen e taksave doganore për mallrat Britanikë. → Mbrojtjen e të drejtave federale për heqjen e skllavërisë. -Konflikti politik u shndërrua në luftë kur në postin e presidentit erdhi A.Linkoln. -Shtetet e Jugut u shpëputën nga SH.B.A dhe krijuan “Konfederatën e Shteteve të Amerikës. -Dekreti i 22 shtatorit 1862 shfuqizoi skllavërinë.(Ligji i emancipimit) -Humbja e ushtrisë së Jugut në 9 Prill 1865 shënoi fundin e luftës. -Amendamenti 14 i kushtetutës sanksionoi se SH.B.A ishin një shtet kombëtar i përbërë prej një populli.
Pyetje për diskutim Situata quhet e realizuar nëse nxënësit: 1) Identifikojnë disa veçori të organizimit të kolonive angleze 2) Shpjegojnë hapat që çuan në pavarësinë e kolonive angleze në Amerikën e Veriut 3) Analizojnë shkaqet dhe pasojat e luftës civile në SH.B.A.	Vlerësimi: <i>Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</i> Detyrat dhe pavarur: • Nxënëset u jepet si detyrë rubrika “Hulumtoni dhe diskutoni”

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shkenca shoqërore	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Revolucionit Francez i shek XVIII.		Situata e të nxënit: a) Shkaqet e revolucionit Francez b) Fazat e zhvillimit të revolucionit në Francë. c) Ndikimi i revolucionit francez në qytetërimin botëror	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e të menduarit - Zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet,për të analizuar të shkuarën nëpërmjet informacionit. Kompetenca qytetare - Shqyrton burimet historike për të kuptuar se si çështjet shoqërore dhe parime të ndryshme kanë ndikuar në çështjet njëreëzore. Kompetenca digjitale - Akseson një sërë burimesh digjitale të informacionit dhe analizon në mënyrë kritike këto burim.		Fjalët kyçe: <i>revolucion,</i> <i>Përfaqësitë e përgjithshme,</i> <i>Deklarata e të Drejtave të Njeriut dhe Qytetarit</i> <i>Asambleja Kombëtare</i> <i>jakobinët</i> <i>zhirondinët</i>	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Analizon shkaqet e shpërthimit të Revolucionit në Francë; - Përcakton dhe shpjegon fazat e Revolucionit Francez; - Argumenton vlerat e Deklaratës mbi të "Drejtat e Njeriut dhe Qytetarit"; - Analizon idetë e reja të revolucionit francez dhe ndikimin e tyre në qytetërimin botëror;			
Burimet: Libri i nxënësit, interneti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - Me temat e mëparshme: -Monarkia franceze në mesjetë. -Monarkia absolute në Francë.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
Metodologjia:	
Punë kërkimore/diskutim/të menduarit kritik përmes leximit.	
Organizimi i orës së mësimit:	
- Mësuesi /ja u ka caktuar nxënësve që më parë duke i ndarë në grupe të krijojnë një ekspozitë me pamje nga revolucioni francez, foto të Robespierit, Dantonit, Maria Antuanetës, Luigjit të XVI, Deklaratës së të drejtave të Njeriut. (Shih https://www.google.al/search?q=revolucioni+francez) - Pasi nxënësit shohin fotot mësuesi/ja drejton pyetjet për të rikujtuar njohuri dhe për të nxitur diskutimin rreth fotove. - Cila dinasti sundonte në Francë? - C’formë qeverisje ishte konsoliduar në Francë? - C’kuptoni ju me absolutizëm? Cili mbret sundoi në mënyrë të absolute në Francë? - C’ishin Përfaqësitë e përgjithshme? - Duke u nisur nga fotot si mund ta përshkruani revolucionin francez? (nxënës të ndryshëm shfaqin mendimet e tyre.)	
Ndërtimi i njohurive:	
Hapi I-Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë pjesën e parë të mësimit dhe evidentojnë se cilat ishin shkaqet e revolucionit .	
-Pasi pyet disa nxënës mësuesja shënon në dërrasë të zezë:	1-Përhapja e ideve iluministe (mësuesi/ja pyet: Cilat ishin këto ide?) 2-Problemet ekonomike (mësuesi/ja pyet cilat ishin shkaqet e krizës ekonomike) Nxënësit duke menduar në mënyrë kritike mund të rendisin: Shkaqet →Jeta luksoze e oborrit mbretëror →Shpenzimet për të ndihmuar luftën për pavarësi në Amerikë etj. 3-Pabarazia ekonomike dhe politike ndërmjet shtresave të shoqërisë franceze. (Mësuesi/ja pyet cilat ishin shtresat dhe çfarë të drejtash ekonomike dhe politike kishin)
Hapi II -Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë pjesën e dytë të mësimit dhe drejton pyetjen?	
-Si filloi revolucioni në Francë? (Përgjigjet e nxënësve i paraqet në dërrasë.)	
Fillimi i revolucionit	Mbreti thirrri përfaqësitë e përgjithshme për të vendosur taksa të reja. Shtrësa e tretë u vetëshpall Asamble Kombëtare (veprimi i parë revolucionar) Përpjekjet e mbretit për të shpërndarë Asamblenë dështuan. Marrija e Bastijës 14 Korrik 1789.

Hapi III-Pasi lexohet pjesa e tretë e mësimi mësuësja pyet:Cilat ishin reformat e Asamblesë Kombëtare? Reformat 1-U shfuqizua feudalizmi,u hoqën pronat dhe titujt e fisnikërisë. 2- U miratua Deklarata e të Drejtave të Njeriut dhe Qytetarit (barazi para ligjit, sovraniteti kolektiv i popullit.) 3- U shfuqizuan ligjet normat dhe vendimet e vjetra me karakter qeveritar, ekonomik, juridik dhe administrativ. 4- U miratua kushtetuta civile e klerit.	
Hapi IV - Pasi nxënësit lexojnë pjesën e katërt të mësimi mësuësja/ja drejton pyetjet e mëposhtme dhe shënon në dërrasë. -Si u zhvillua faza e dytë e revolucionit?/Si ishin grupuar forcat revolucionare? -A ishin veprimet e revolucionareve të nxiura nga idetë iluministe apo u kalua në veprime ekstreme nga ana e tyre? Forcat revolucionare ndaheshin në Jakobinë (grupi radikal i Revolucionit) Zhirondinë (përfaqësues të borgjezisë tregtare industriale, të moderuarit) Sankylotë (populli i thjeshtë) Grupi i “Malit (grup radikal që luajti rolin kryesor në përmbysjen e monarkisë) Faza e dytë e Revolucionit Përmbysja e monarkisë në 10 gusht 1792 shpallja e Republikës Monarkitë evropiane kundër revolucionit, i shpallën luftë Francës (Pse?) U krijua Gjyqi i Jashtëzakonshëm, dënimi i mbretit në gjyotinë. Në 31 maj 1793 u pushtua Konventa nga grupi radikal, u dënuan me vdekje zhirondinët. U krijuan si organe drejtuese Komiteti i shpëtimit publik dhe Komiteti i sigurimit të përgjithshëm. Grushti i shtetit 24 korrik 1774 i dha fund terrorit jakobin, periudha deri në 1779 quhet Direktorat.	
Hapi V: Mësuesi/ja nxit të menduarit kritik nëpërmjet pyetjes: Cili ishte ndikimi i Revolucionit në qytetërimin botëror?	
Pyetje për diskutim Situata quhet e realizuar nëse nxënësit: 1) Identifikojnë dhe analizojnë shkaqet e Revolucionit francez. 2) Shpjegojnë fazat e revolucionit francez. 3) Analizojnë idetë e reja të revolucionit Francez dhe ndikimin e tyre në qytetërimin botëror.	
Vlerësimi: <i>Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</i>	
Detyrat dhe puna e pavarur: • Nxënësve u jepet detyrë pyetja e fundit në rubrikën “Verifikoni njohuritë”	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shkenca shoqërore	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Epoka e Napoleonit dhe epoka e restaurimit.		Situata e të nxënësve: a) Ardhja në pushtet e Napoleonit, politika e ndjekur prej tij. b) Vitet e perandorisë dhe synimet për hegjemoni në Evropë. c) Kongresi i Vjenës ndryshimet politike në Evropë.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurisë - Përdor funksionet gjuhësore të teksteve historike, duke përfshirë fjalorin historik, fjali të ndërtuara saktë për përshkrimin e ngjarjeve. Kompetenca e të menduarit - Zhvillon mendimin krijues për të ndërtuar interpretime të reja të cilat shpjegojnë aspekte të së shkuarës. Kompetenca personale - Përdor aftësitë e komunikimit, për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij.		Fjalët kyçe: <i>Konsull,</i> <i>Kodi civil,</i> <i>Legjitimitet,</i> <i>Epoka e restaurimit</i> <i>legjitimitet</i>	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Shpjegon faktorët e ardhjes në pushtet të N. Bonapartit; - Shpjegon karakterin e reformave të Napoleonit, duke analizuar ndikimin e tyre në qytetërimin botëror - Përcakton në hartë fazat e zgjerimit të territorit francez në periudhën e Napoleonit; - Evidenton ndryshimet politike që pësoi Evropa pas rënies së Napoleonit dhe Kongresit të Vjenës.			
Burimet: Libri i nxënësit, interneti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - Me temat e mëparshme: “Revolucioni Francez” - Me gjeografinë: Perandoria e Napoleonit, ndryshimet pas 1815.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
Metodologjia: Diskutim/hartë e mendjes Organizimi i orës së mësim: -Për të ngjallur kureshtjen e nxënësve mësuesi/ja pyet; A e dini ju pse makinat angleze e kanë drejtimin nga e majta? Mësuesi cakton një nxënës të lexojë rubrikën “grimcë historike” në tekst dhe u shpjegon nxënësve si periudha e N.Bonapartit solli dhe ndryshime te tjera në Francë dhe Evropë me të cila do të njiheni në temën e re. Ndërtimi i njohurive: Pasi nxënësit kanë lexuar mësimin mësuesja ndërton në tabelë skemën e cila plotësohet nga nxënësit.	Faza e I:Konsullati (1799-1804) (grushti i shtetit në 10 nëntor 1799) Politika e brendshme -Synonte të vendoste stabilitetin 1-Miratoi kushtetutën në 1800 barazi para ligjit.....etj 2-Reforma në ekonomi: Sistem te ri taksash 3-Reforma në drejtësi Kodi civil, tregtar, penal.....etj 4-Reforma administrative 5-Arritja e Konkordatit me Papën. 6-Reforma në arsim..... 7-Reforma në shëndetësi.....etj Erdhi në pushtet në sajë të: 1-Gjendjes së vështirë që po kalonte Franca 2-Arritjeve dhe fitoreve të tij ushtarake Politika e jashtme -Në fazën e parë të qeverisjes synoi të vendoste paqen: 1-Paqja e Lunvijës me Austrinë në vitin 1801 -Franca morri Belgjikën, Jug.Renit -Venediku mbikqyrej nga Austria -U njohën të pavarura republikat Helvetike, Ligure, Batave, Cisalpine 2-Paqja me Rusinë(1801) 3-Paqja e Amienit me Anglinë -Njohja e republikës Franceze -Rikthimin e kolonive.....etj Faza e II: Perandoria (1804-1814) Politika e brendshme -Sundoi me pushtet absolut -U kurorëzua në katedralen e Parisit në 2 dhjetor 1804 -U burgos në 11 prill 1815 -U rikthye në mars 1815 -U mund në betejën Vaterlos (Qershor 1815) -U internua në Shën Elenë. Politika e jashtme -Synoi vendosjen e hegjemonisë në Evropë -Pushtoi Hollandën, Napolin, Hanoverin. -Pësoi humbje nga Anglezët -Luftoi me Austrinë, Perandorinë Gjermane. -Organizoi Bllokadën kontinentale ndaj Anglisë -Luftoi dhe humbi kundër Rusisë në Borodino. (1814)

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shkenca shoqërore	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Revolucion i industrial dhe ndikimi i tij në shoqërinë Evropiane			
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e të nxënës - Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet për një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet Kompetenca personale - Kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, ndryshimet që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave. Kompetenca qytetare - Kupton perspektivat dhe qëndrimet e njerëzve në të shkuarën e në të tashmen dhe rëndësinë së historisë së tyre dhe të tjerëve; Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Përkufizon konceptin Revolucion Industrial; - Shpjegon arsyet përse Anglia u bë atdheu i Revolucionit të Parë Industrial; - Evidenton arritjet e këtij revolucioni në industri. - Shpjegon ndryshimet sociale që solli ky revolucion; - Argumenton ndikimin e Revolucionit të Dytë industrial me zhvillimin e industrisë dhe urbanizimit;			
Burimet: Libri i nxënësit, interneti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - Me teknologjinë dhe shkencat: - Shpikjet e reja	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Metodologjia: Stuhi mendimesh/INSERT Organizimi i orës së mësimit: Mësuesi shkruan në tabelë “Revolution industrial” dhe kërkon nga nxënësit të thonë se çfarë kuptojnë me të. <pre>graph TD; A([Filloi në Angli]) --> B([Revolution Industrial]); C([Industria tekstile]) --> B; B --> D([Shpikje të reja]); B --> E([Makina me avull]); D --> F([Ndryshime thelbësore në industri]); E --> G([U zëvendësua puna me dorë me makineri]);</pre> Ndërtimi i njohurive: -Mësuesi/ja udhëzon të lexohet mësimi duke plotësuar secili në fletore tabelën që do të ndërtotojë në dërrasë, pas leximit nxënës të ndryshëm marrin pjesë në plotësimin e tabelës të ndërtuar nga mësuesi/ja.			
✓	+	-	?
Informacion i njohur	Informacion i ri	Informacion që dihej ndryshe	Informacion shtesë
1-Revolution 2-Anglia vendi ku filloi Revolutioni 3-U bënë shpikje të reja.	❖ Revolutioni industrial (shek XVIII-XIX) solli: -ndryshime thelbësore në mënyrën e jetesës së njerëzve. -në mënyrën e organizimit të prodhimit. ❖ Arsyet që Revolutioni filloi në Angli 1-Anglia kishte krah të lirë pune (Gardhimi) 2-Kishte pasuri nëntokësore (hekur, qymyr) 3-Zotëronte tregun në koloni dhe kontinent. 4-Kishte një flotë të fuqishme tregtare. 5-Kishte kapitalin e nevojshëm që nevojitej për financim. 6-Rrjeti lumor dhe transporti, ndihmuan në komunikim. ❖ Shpikje të rëndësishme	-Nxënësit mund të mos dinë si u zhvillua gardhimi -Revolutioni Industrial U parapri nga ai bujqësor	-Cilat ishin ndryshimet ne tregun botëror pas revolutionit industrial? -Si e pritën punëtorët përdorimin e makinave? (mësuesi/ja)

	-Faza e I-Në industrinë tekstile: çikriku fluturues Xhon Kej.(1733), Makina Xheni (1764),tezgjahu mekanik, makina për zhveshjen e pambukut etj -Faza II -Në transport: motori, lokomotiva ,anija me avull. ❖ Revolucioni i dytë industrial (fundi i shek XIX-shek XX) -nëkupton kalimin drejt shoqërisë industriale -triumfin e revolucionit shkencor -u zbuluan burime të reja energjie si nafta, gazi natyror, elektriciteti. U zhvilluan degë të industrisë si:industria metalurgjike, kimike , elektrike etj ❖ Pasojat e revolucionit industrial: 1- U zhvillua klasa borgjeze, proletariati i ri qytetar. 2-Rritje të jashtëzakonshme të qyteteve. 3-Ndryshoi struktura e popullsisë, rritje të popullsisë urbane. 4-Ndikimi në rritje i doktrinës së liberalizmit ekonomik. 5-Ndarja e botës në dy hapësira të mëdha: vendet që zotëronin koloni dhe vendet koloniale.	mund të tregojë për Lëvizjen Ludiste)
--	---	---------------------------------------

Pyetje për diskutim

Situata quhet e realizuar nëse nxënësit:

- 1) Përkufizojnë konceptin revolucion industrial.
- 2) Shpjegojnë arsyet pse revolucion i industrial i ka fillimet në Angli.
- 3) Identifikojnë shpikjet e reja dhe degët e industrisë që njohën zhvillim në gjatë dy revolucioneve industriale.
- 4) Analizojnë pasojat e Revolucionit Industrial.

Vlerësimi:


Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.


Detyrat dhe puna e pavarur:

- Nxënëseve u jepet detyrë të ndërtojnë postera ose albume me foto për shpikjet e reja gjatë Revolucionit Industrial.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shkenca shoqërore	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Perandoria Osmane si model i shpërbërjes së perandorive shumëkombëshe.		Situata e të nxënës: a) Situata në Perandorinë osmane në shek .XVI-XX. b) Përpjekjet për rimëkëmbje nga Perandoria Osmane. c) Shpërbërja e perandorisë Osmane.	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e të menduarit - Zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të analizuar të shkuarën nëpërmjet informacionit. Kompetenca e të nxënës - Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet për një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet. Kompetenca digjitale - Akseson një sërë burimesh digjitale të informacionit dhe analizon në mënyrë kritike ato.		Fjalët kyçe: <i>Sistem i timarit,</i> <i>Tanzimat,</i> <i>lëvizje kombëtare,</i> <i>lëvizje separatiste,</i> <i>Kongresi i Berlinit</i>	
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: -shpjegon faktorët e krizës së Perandorisë Osmane; - shpjegon përpjekjet e Perandorisë Osmane për daljen e saj nga kriza dhe faktorët e dështimit të këtyre përpjekjeve; - evidenton ndikimin e lëvizjeve nacionale në Ballkan në shpërbërjen e Perandorisë Osmane; - paraqet skematikisht hartën e re të Ballkanit, duke përcaktuar në të shtetet e reja të krijuara në shek. XIX – XX.			
Burimet: Libri i nxënësit, interneti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - Me temat e mëparshme : -Perandoria osmane dhe Ballkani shek XVI-XVIII. - Me gjeografinë: Perandoria Osmane, Harta e re e Ballkanit.	





Pyetje për diskutim

Situata quhet e realizuar nëse nxënësit:

- 1) Shpjegojnë situatën e krijuar në Perandorinë Osmane.
- 2) Analizojnë përpjekjet që bëri Perandoria Osmane për të dalë nga kriza.
- 3) Përcaktojnë në hartë shtetet e reja që u formuan si rezultat i lëvizjeve për pavarësi të popujve.

Vlerësimi:

Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënëtit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.

Detyrat dhe puna e pavarur:

- Nxënësvet u jepet detyrë të plotësojnë një hartë skicë me shtetet e pavarura të Ballkanit.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shkenca shoqërore	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Bashkimi i Italisë			
Situata e të nxëniet: a) Gjendja e Italisë pas Kongresit të Vjenës b) Rrymat politike dhe idetë e tyre për bashkimin e Italisë. c) Etapat në të cilat kaloi procesi i bashkimit të Italisë.			
Fjalët kyçe: <i>Rilindje,</i> <i>Mbretëria e Sardenjës Piemontit,</i> <i>“Ekspedita e të njëmijëve”,</i> <i>Prirje unitare,</i> <i>Reformizmi liberal,</i> <i>Neoguelfizmi,</i>			
Rezultatet e të nxëniet sipas kompetencave kyçe Kompetenca e të menduarit Zhvillon të menduarit për realizimin e kërkit historik. Kompetenca e të nxëniet Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore. Kompetenca për jetën sipërmarrjen dhe mjedisin Diskuton individualisht ose në grup për rëndësinë që ka e shkuara në kuptimin e të tashmes dhe perspektivën e të ardhmes.			
Rezultatet e të nxëniet të kompetencave të fushës sipas temës mësimore -shpjegon ndikimin e iluminizmit dhe të romantizmit në lindjen e nacionalizmit; - përcakton në hartë fazat e realizimit të bashkimit të Italisë; - shpjegon faktorët e krijimit të shtetit të bashkuar italian; - gjykon mbi shprehjen “ Italinë e bëmë, tani të bëjmë italianët”.			
Burimet: Libri i nxënësit, interneti.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - Me temat e mëparshme : -Epoka e Napoleonit dhe epoka e restaurimit. - Me gjeografinë:Harta e Italisë pas kongresit të Vjenës.		

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Metodologjia:

Shpjegim/të kuptuarit përmes leximit

Organizimi i orës së mësimt:

-Faza e parë e mësimt mund të zhvillohet nëpërmjet një prezantimi që bën mësuësi/ja në projektor(ose edhe duke përdorur hartën) të gjendjes së Italisë pas Kongresit të Vjenës.

- Shih https://it.wikipedia.org/wiki/Storia_d%27Italia#/media/File:Italia_1843.svg

Ndërtimi i njohurive:

- *Hapi i parë: Pasi nxënësit lexojnë pjesën e parë të mësimt mësuësi/ja drejton pyetjet:*

-Cila ishte gjendja në Itali pas Kongresit të Vjenës?/Cilat ide ndikuan në rritjen e ndërgjegjes kombëtare italiane?

Cilat ishin rrymat politike në gjirin e Rilindjes Italiane? (nxënësit identifikojnë dhe figurat kryesore të secilës rrymë)

Italia pas Kongresit të Vjenës { Austria kontrollonte Venetinë, Lombardinë, shtëpia Habsburgase Modenën dhe Toskanën.

Burbonët Mbretërinë e Dy Siçilive.

Papati qeveriste shtetet qendrore.

Shtetet e tjera ishin të ndara në mbretëri, shtete të vogla

Idetë që frymëzuan nacionalizmin italian { Idetë iluministe(nxënësit mund të kujtojnë disa prej tyre)

Rrymat politike { 1-Rryma unitariste, republikane që synonte krijimin e një republike Italiane të pavarur, demokratike, të bashkuar.

në gjirin { 2-Rryma liberale e moderuar , ishte për federatë në marrëveshje me sovranët

e Rilindjes Italiane { e cila u shfaq në tre prije { Prija e I: Shkolla e Moderuar , ishte për federatë në marrëveshje me kryesinë e Papës

{ Prija e II: Neoguelfizmi. ishte për një konfederatë në kryesinë e Papës

{ Prija e III: Liberalizmi demokratik lombard, ishte për republikë federale

- *Hapi i dytë : Pasi nxënësit lexojnë pjesën e dytë të mësimt mësuësi/ja pyet:*

Cilat janë tre etapat në të cilat kaloi lëvizja për bashkimin e Italisë?/Si u zhvillua secila prej tyre?/Cilat ishin problemet e Italisë?

Etapat e parë { -Lidhet me lëvizjen revolucionare te viteve 1848-1849

- Këto lëvizje dështuan, por treguan se revolucioni kërkonte organizim të brendshëm dhe aleatë të jashtëm

-Në këtë fazë krahas figurave të tjera spikati ajo e kontit Kavur kryeministër i mbretërisë së Piemontit

-Kavuri mendonte se Mbretëria a Sardenjë-Piemonti duhet të udhëhiqte bashkimin (ai ngriti ekonominë, forcoi

ushtirinë etj Krijoi aleanca me Britaninë në Francën në 1858 në shkëmbim të Nicës dhe Savojës.

Etapa e dytë	-Filloi në 26 prill 1859 me luftën e Mbretërisë së Sardenjës me aleate Francën kundër Austrisë. -Pas fitores mbretëria e Sardenjës shtri pushtetin në Lombardi, Parmë, Modena, Toskanë dhe Romanjë. -Në 11 maj 1860 në jug nisi “ Ekspedita e të Njëmijëve” me në krye Xh. Garibaldi e cila çliroi Sicilinë. -Territorët e çliuara u bashkuan me Mbretërinë e Sardenjës –Piemontit. -Në nëntor 1860 krahinat papale të Umbrias dhe Marke votuan për bashkimin me Mbretërinë e Sardenjës -Në 17 mars 1861 Viktor Emanueli i dinastisë së Savojës u shpall mbret i Italisë. Etapa e tretë
Problemet me të cilat u përball shteti i ri Italian	{-ndërtimi i shtetit krijimi i identitetit kombëtar -problemet ekonomike (kriza agrare,industrializimi) -përplasjet shoqërore (kriza e vitit1898,vrasja e Umbertoos së I)
Pyetje për diskutim Situata quhet e realizuar nëse nxënësit: 1) Përcaktojnë në hartë gjendjen e Italisë pas Kongresit të Vjenës. 2)Identifikojnë rrymat politike që përgatitën Bashkimin e Italisë dhe idetë e tyre se si do të arrihej ky bashkim. 3)Analizojnë fazat nëpër të cilat kaloi procesi i bashkimit të Italisë në një komb të vetëm. Vlerësimi: <i>Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</i> Detyrat dhe puna e pavarur: • Nxënëseve u jepet si detyrë rubrika “Hulumtoni dhe diskutoni”	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shkenca shoqërore	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Bashkimi Gjermanisë		Situata e të nxënës: a) Gjermania pas kongresit të Vjenës b) Roli i Bismarckut në bashkimin e Gjermanisë c) Organizimi i Gjermanisë së bashkuar dhe lëvizja socialiste.	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit -Zhvillon komunikimin për të kuptuar informacionin dhe ndërtuar njohuritë historike. Kompetenca e të menduarit -Zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të analizuar të shkuarën nëpërmjet informacionit. Kompetenca e të nxënës • Zbaton në mënyrë të pavarur ose në grup udhëzimet për një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.		Fjalët kyçe: <i>Konfederata gjermane,</i> <i>Zollverein,</i> <i>Mbretëria e Prusisë,</i> <i>Rajhu i II,</i> <i>Lëvizja socialiste</i>	
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore - analizon rolin e Bismarckut në bashkimin e Gjermanisë; - evidenton strukturën e organizimit shtetëror në Gjermani; - shpjegon reformat sociale të Bismarckut në Gjermani, si fillimet e shtetit të mirëqenies sociale; - shpjegon tiparet e lëvizjeve punëtoresh në Gjermani duke evidentuar krijimin e grupeve politike punëtoresh.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: • Me temat e mëparshme: Epoka e Napoleonit, epoka e restaurimit. • Me gjeografinë: Shtrirja e konfederatës dhe perandorisë Gjermane.	
Burimet: • Libri i nxënësit, interneti.			

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
Metodologjia: Pyetje –përgjigje/punë në grupe/ të menduarit kritik. Organizimi i orës së mësimit: Mësuesi/ja e fillon mësimin duke rikujtuar njohuri te nxënësve nëpërmjet pyetjeve: 1-Ju kujtohet se cilat ishin dy mbretëritë që lindën nga shpërbërja e perandorisë Karoline në traktatin e Verdunit të vitit 843? 2- Kur u shpërbë Perandoria e Shenjtë Gjermane? (Kujto fitoren e N.Bonaparti, paqen e Presburgut dhe shpërbërjen në 1806) 3-Cilat ishin vendimet e Kongresit të Vjenës lidhur me shtetet Gjermane? 4-Nga kush udhëhiqej Konfederata Gjermane? (këtu mësuesi/ja mund të ndërhyjë duke shpjeguar si funksiononte kjo konfederatë.) Ndërtimi i njohurive: - Për zhvillimin e kësaj ore mësimi nevojitet punë përgatitore nga mësuesi/ja ,ku ai/ajo ndan mësimin në katër pjesë kryesore dhe përgatit po aq fleta të bardha ku të jetë shkruar pyetja ose çështja që do të trajtojë secili grup. -Pasi ndan klasën në katër grupe mësuesi/ja kërkon të lexohet mësimi dhe secili grup të shkruajë në fletë përgjigjen e kërkesës përkatëse dhe të përgatiten për ta prezantuar përpara klasës. <i>Grupi I:Rendimi dhe shpjegoni hapat që u ndoqën për të krijuar Gjermaninë e bashkuar.</i> Mësuesi /ja bën kujdes që nxënësit të radhisin në fletën e dhënë paraprakisht hapat dhe më pas aktivizon gjithë nxënësit e grupit për të shpjeguar secilin prej tyre. Bashkimi i Gjermanisë u realizua nëpërmjet:	1-Bashkimi ekonomik, Zollverein në vitin 1834. 2- Revolucioni i vitit 1848 i cili dështoi në përpjekjet për të arritur bashkimin e vendit. 3-Krijimi i organizatës “Bashkimi Gjerman” e cila përkrahte rolin e Prusisë si drejtuese të procesit të bashkimit të Gjermanisë. 4-Lufta me Danimarkën e vitit 1864 ku pas fitores Prusia dhe Austria nuk arritën në marrëveshje për ndarjen e territoreve. 5-Lufta shtatë javore e vitit 1866 me Austrinë e cila përfundoi me fitoren e Prusisë. 6-Krijimi i Konfederatës së Gjermanisë veriore në të cilën nuk u përfshi Austria dhe shtetet katolike të Gjermanisë Jugore. 7-Lufta Franko-Prusiane (15 korrik-2 shtator 1870)shtetet e jugut mbështetën Prusinë. 8-Përfshirja e shteteve të Jugut në Konfederatë ,kurorëzimi më 18 janar 1871 i Vilhelmit I Perandor i Rajhut të II.

<i>Grupi II: Shpjegoni tiparet e perandorisë së re Gjermane.</i>	
Tiparet e perandorisë Gjermane	-Në 14 prill 1871 u miratua kushtetuta. -Pusheteti legjislativ ushtrohej nga Rajshtagu. -U krijua një qeveri perandorake pa pushtet. -Perandoria Gjermane ishte një shtet federal, federalizmi i së cilës pengohej nga pozicioni i veçantë që kishte Prusia në të. -Perandori ishte sovran i shtetit. -Qeveritë e shteteve administronin, arsimin, rendin, gjykatat, çështjet fiskale etj. -Njohu zhvillim të shpejtë të industrisë dhe urbanizimit. (Faktorët që ndihmuan zhvillimin)
<i>Grupi i III: Shpjegoni tipare të lëvizjes socialiste në Gjermani.</i>	
Lëvizja socialiste	{ -U përfaqësua nga partia Social-Demokrate, filloi me aktivitetin e F. Lasalit. -Dy drejtimet kryesore ishin 1-Pasuesit e Lasalit 2-Marksistët me Libkneht dhe Bebel } U bashkuan në programin e Gotes. -Arriti te siguronte 12 vende në Rajshtag në 1877.
<i>Grupi IV :Shpjegoni si e mposhti Bismarku lëvizjen socialiste .</i>	
1-Nëpërmjet vendosjes së një legjislacioni antisocialist mjaft të rreptë detyroi socialistët të kalonin në ilegalitet. 2-Duke zgjeruar legjislacionin social, ligjin për sigurimet, pension, të sëmurët etj.	
Pyetje për diskutim Situata quhet e realizuar nëse nxënësit: 1) Rëndisin dhe shpjegojnë hapat që u ndoqën për bashkimin e Gjermanisë. 2) Analizojnë tiparet e Perandorisë Gjermane. 3) Shpjegojnë disa tipare të lëvizjes socialiste dhe identifikojnë përfaqësuesit e tyre.	
Vlerësimi: <i>Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënëtit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</i>	
Detyrat dhe puna e pavarur: Nxënësitve u jepet si detyrë të hulumtojnë rreth rolit të Oto Fon Bismark në bashkimin dhe forcimin e Gjermanisë.	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shkenca shoqërore	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Britania e Madhe nga konservatorizmi drejt liberalizmit		Situata e të nxënës: a) Reforma elektorale në Angli. b) Organizimi politik dhe social në Angli. c) Lëvizja punëtore dhe feministe në Angli	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit -Përdor funksionet gjuhësore, fjali komplekse për shpjegimin e marrëdhënieve shkak-pasojë. Kompetenca e të nxënës -Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme, i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën. Kompetenca personale -Kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave. Kompetenca digjitale • Komunikon, prezanton dhe parashtron njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet.		Fjalët kyçe: <i>Vigët,</i> <i>Torët,</i> <i>Lëvizja Çartiste,</i> <i>Epoka Viktoriane,</i> <i>Lëvizja feministe,</i> <i>Laburistët.</i>	
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore - Shpjegon përpjekjet e shoqërisë angleze për reformimin e sistemit elektorale; - Analizon tiparet e lëvizjeve politike dhe sociale në Angli; - Evidenton kërkesat e lëvizjes feministe në Angli.			
Burimet: • Libri i nxënësit, interneti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: • Me temat e mëparshme :Anglia në shek XVII.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
Metodologjia: Punë kërkimore /ditar dypjesësh Organizimi i orës së mësimi: -Mësuesi/ja ka udhëzuar që më parë nxënësit të hulumtojnë dhe grumbullojnë fakte,informacion rreth: Lëvizjes Çartiste, Epokës Viktoriane dhe Lëvizjes Feministe (materiali mund të prezantohet në Powerpoint nga nxënësit) - Nxënësit mund të referohen në adresat e shënuara ose burime të tjera: https://en.Wikipedia.org/Wiki/Chartism#People.27s_Charter_of_1838 -Pas paraqitjes se punës së përgatitur nga nxënësit mësuesja udhëzon të lexohet mësimi Ndërtimi i njohurive -Mësuesi/ja ndërton një tabelë në formën e ditarit dypjesësh dhe udhëzon nxënësit ta plotësojnë në fletore. -Pas përfundimit të punës nga nxënësit mësuesja drejton pyetje dhe plotëson tabelën.	
Koncepti	Komenti
Forcat politike në fillim të shek të XIX	1-Torët ose konservatorët 2-Vigët ose liberalët
Reforma parlamentare	-U miratua në vitin 1832. -Njohu ndryshimet që solli Revolucioni Industrial. -Mundësoi triumfin e liberalizmit ekonomik. -Dhoma e komunave mori tiparet e një parlamenti të zgjedhur.
Lëvizja Çartiste	-Kërkonte  -Në pranverë të 1839 thirri një Konventë Kombëtare dhe i drejtoi parlamentit një petition gjigand. -Kërkesat e saj u plotësuan në harkun kohor 1858-1918
Reformat elektorale	-Vendosën  -Nuk u arrit deri në votimin e përgjithshëm ,dhe të drejtën për të votuar të grave.


Epoka Viktoriane (1837-1901)	-Epokë e pasur dhe e zhvilluar për Anglinë. -Triumfoi ekonomia dhe tregtia e lirë,për rrjedhojë Anglia u bë qendra tregtare dhe financiare e botës. -Sistem të hapur qeverisjeje ndaj reformave demokratike,alternim te liberalëve dhe konservatorëve. -Zhvillim të vrullshëm të qyteteve, industrisë, sistemit bankar dhe transportit etj.
Jeta politike në fundin e shek të XIX	-Dy ishin partitë në qeverisje:  Konservatorët drejtuar nga Dizraeli Liberalët drejtuar nga Gledstoun. -Reformat gjatë qeverisjes se Gledstoun: Reforma e shërbimit civil (caktimi i nëpunësve mbi bazën e konkurimit dhe të përgatitjes profesionale) Ligji për arsimin(u ngritën shkolla vendore me përkrahjen e qeverisë,subvencionoi shkollat private) - Vetëqeverisja e Irlandës nëpërmjet parlamentit Irlandez dhe qeverisë së Dublinit.(ligji i1914) -Mospranimi i vetëqeverisjes nga Irlandezët ,kryengritja e Pashkëve e vitit 1916 në Dublin.
Partia Laburiste	-Përfaqësonte masat popullore,lindi prej shoqërisë fabiane, partisë së pavarur laburiste dhe sindikatave. -E vunë theksin në riorganizimin e shoqërisë Angleze si:  një demokraci e pakufizuar në politike socializimin në sferën ekonomike
Demokracia e 1914	-Fabianët ishin gadualistë jo revolucionarë. -U zgjerua e drejta e votës,u dobësuan kompetencat e Dhomës së Lordëve. -U zgjeruan shërbimet sociale ,kujdesi mjekësor dhe arsimi publik. -Tensionet në qeverisjen e Xhorxhit të V, skandali Markoni, lëvizja punëtore, feministe (kërkesat) -Tronditje e besimit te ligji,arsyeja,kompromisi.
Pyetje për diskutim	
Situata quhet e realizuar nëse nxënësit: 1) Identifikojnë forcat kryesore politike në Britani ,kërkesat dhe programin e tyre. 2) Shpjegojnë reformat e ndërmarra në planin politik,social dhe ekonomik në Britaninë e shek XIX dhe fillimit të shek .XX. 3) Analizojnë kërkesat e Lëvizjes Çartiste, feministe, punëtore.	
Vlerësimi:	
<i>Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxëniet të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</i>	
Detyrat dhe puna e pavarur:	
• Nxënëseve u jepet detyrë kërkojnë dhe hulumtojnë rreth çështjes Irlandeze dhe zgjidhjes së saj.	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shkenca shoqërore	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Përsëritje. Tematika 3: Humanizmi dhe Rilindja Tematika 4: Koha e ndryshimeve thelbësore			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Përdor funksionet gjuhësore të teksteve historike, fjali komplekse për shpjegimin e marrëdhënieve shkak-pasojë. Kompetenca qytetare - Kupton perspektivat, besimet dhe qëndrimet e njerëzve në të shkuarën e në të tashmen dhe rëndësinë së historisë së tyre dhe të tjerëve; Rezultatet e të nxënit të kompetencave të sipas tematikave mësimore - Demonstron njohuri, aftësi/shkathësi, mbi kthesën e madhe që morën qytetërimet botërore pas Rilindjes Evropiane, ndryshimet rrënjësore, që shkaktuan revolucionet politike, industriale. - Shpjegon lindjen e nacionalizmit i cili çoi në krijimin e shteteve nacionale ne Evropën Qendrore dhe Ballkan. - Analizon fillimet e liberalizmit në jetën politike dhe ekonomike që i siguroi qytetarit të drejtat sociale dhe politike			
Burimet: Libri i nxënësit, interneti, harta, libri i mësuesit, skeda përgatitura nga mësuesi		Situata e të nxënit: - Ndryshimet që ndodhen në fusha të ndryshme pas Rilindjes Evropiane - Krijimi i shteteve kombëtare në Evropën qendrore dhe Ballkan. - Liberalizmi në jetën ekonomike dhe politike, të drejtat sociale. <i>iluminizëm,</i> <i>humanizëm,</i> <i>Rilindje Evropiane,</i> <i>absolutizëm,</i> <i>merkantilizëm,</i> <i>revolucion,</i> <i>protektorat,</i> <i>federatë konfederatë,</i> <i>Revolucion Politik,</i> <i>Revolucion Industrial,</i>	
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - Me temat e mëparshme: tematika 3-4 - me letërsinë: vepra të iluministëve dhe rilindjes.			

		• me gjeografinë: territore të shteteve etj
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve		
Metodologjia:		
Hap pas hapi /stuhi mendimi		
Organizimi i orës së mësimi:		
Mësuesi/ja ndërthur disa metoda në hapat e ndryshëm gjatë të cilave do të kalojë ora e përsëritjes. Nxënësit nxiten të marrin pjesë nëpërmjet pyetjeve ,diskutimit dhe veprimtarive individuale të zhvilluara në këtë orë përsëritje.		
Ndërtimi i njohurive		
• <i>Hapi i parë: Puna me teksti .</i> Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të punojnë në fletën e përsëritjes në tekst pyetjet 3,5,12,16,18,23, Dhe më pas aktivizohen nxënësit për të dhënë përgjigjet e sakta • <i>Hapi i dytë: Identifikoj dhe shpjego termat shprehjet dhe figurat historike.</i> P.sh:Identifikoj:iluminizëm, humanizëm, Rilindje Evropiane, zbulimet e mëdha gjeografike, absolutizëm, merkantilizëm, koloni,revolucion, luftë civile,protektorat,federatë konfederatë, barazi,Revolucion i Lavdishëm, Revolucion Politik, Revolucion Industrial,nacionalizëm, komb-shtet,lëvizje feministe, e drejta elektorale ,protestante,reforma katolike, konti Kavur, Bismarku etj • <i>Hapi i tretë:Të menduarit logjik</i> Mësuesi/ja drejton pyetje me qëllim që të nxisë të menduarit logjik te nxënësit. P.sh. 1-Evidentoni dhe analizoni faktorët që ndikuan në zhvillimin e Rilindjes Italiane. 2- Identifikoni shkaqet që ndikuan në realizimin e zbulimeve të mëdha gjeografike. 3-Shpjegoni rrethanat historike në të cilat lindi Reformacioni dhe ilustroni me shembuj përhapjen e tij . 4-Krahasoni pozitën e Kishës Katolike në Evropë para dhe pas Reformacionit, duke e ilustruar me shembuj konkretë. 5-Analizoni dhe jepni shembuj të dallimeve të politikës osmane në vende të ndryshme të Ballkanit. Renditni reformat e Kolbertit për nxitjen e ekonomisë së Francës dhe analizoni thelbin e tyre. 6-Argumentoni përse Franca, një vend katolik, në Luftën 30-vjeçare, u rendit në krahun e vendeve protestante. 7-Vlerësoni arritjet dhe pasojat e Luftës Civile në Angli. 8-Renditni disa prej pikave të përmbajtjes së Aktit të Lirive dhe të Drejtave të vitit 1689, në Angli. 9-Analizoni tri parimet mbi të cilat u bazua rregullimi gjeopolitik i Evropës pas periudhës së Napoleon Bonapartit. 10-Analizoni përbërjen dhe pikëpamjet respektive të Jakobinëve dhe Zhirondinëve lidhur me dinamikën e Revolucionit Francez. 11-Shpjegoni përse Revolucion i Industrial u krye pikërisht në Angli dhe jo në një shtet tjetër dhe sillni fakte konkrete për ilustrim. • <i>Hapi i katërt:Punë individuale</i>		

- Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të punojnë në fletore pyetjet 9 dhe 20 të fletës për përsëritje në tekst.
- Aktivizohen nxënësit në plotësimin e tabelave, diagrameve në dërrasë të zezë P.sh.
- Rendimi pikat kryesoret të Dekretit të Nantës përballë atij të Fontenëbllosë.



-Krahasoni procesin e bashkimit të Italisë me atë të Gjermanisë dhe vini në dukje të përbashkëtat dhe veçoritë e tyre.

Bashkimi i Italisë	Tiparet e përbashkëta	Bashkimi i Gjermanisë
- Bashkimi i Italisë lindi fillimisht si ide dhe program politik dhe më vonë si bashkim ekonomik. -Në Itali procesit të bashkimit i parapriu Lufta për çlirim nga francezët dhe austriakët. -Procesi i bashkimit në Itali u realizua Si një ndërthurje e lëvizjes popullore çlirimtare me atë politiko-diplomatike. - Në Itali u shpall Mbretëria Italiane.	-Në të dy shtetet : -bashkimi u arrit me luftë. -rolin drejtues në bashkim e morën shtete të fuqishme si Prusia dhe Mbretëria e Sardenjë –Piemontit dhe kyeministrat përkatës të tyre. -lufta për bashkim u ndërthur me veprimtarinë diplomatike dhe krijimin e aleancave. -u luftua kundër Francës dhe Austrisë. -Procesi i bashkimit kaloi në disa faza dhe përfundoi në 1871. -U vendos regjim monarkik në qeverisje.	- Bashkimi i Gjermanisë filloi me bashkimin ekonomik “Zollverein” . -Bashkimi në Gjermani u realizua nëpërmjet luftës ku përveç austriakëve dhe francezëve Prusia luftoi dhe me Danimarkën . -Në Gjermani ishte vetëm Prusia që udhëhoqi dhe realizoi bashkimin. -Në Gjermani u shpall Perandoria(shtet federal)

Pyetje për diskutim: Situata quhet e realizuar nëse nxënësit

- 1) Njohin dhe shpjegojnë ndryshimet që ndodhën si rrjedhim ideve iluministe dhe të rilindjes evropiane
- 2) Analizojnë lindjen e nacionalizmit i cili çoi në krijimin e shteteve nacionale në Evropën Qendrore dhe Ballkan.
- 3) Analizojnë fillimet e liberalizmit në jetën politike dhe ekonomike që i siguroi qytetarit të drejtat sociale dhe politike.

Vlerësimi:

- Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënëtit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shkenca shoqërore	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Fillimet e krizave të shek. XX. Lufta e Parë Botërore		Situata e të nxënës: a) Shkaqet e Luftës së Parë Botërore b) Frontet kryesore të luftës. c) Përmasat e luftës dhe përfundimi i saj.	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e të menduarit - Zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të analizuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime. Kompetenca e të nxënës - Parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumente dhe burime Kompetenca personale - Përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj. për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij.		Fjalët kyçe <i>Nacionalizëm,</i> <i>Antanta,</i> <i>Blloku qendror,</i> <i>Front,</i> <i>militarizëm</i>	
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Botërore; - analizon shkaqet që çuan në fillimin e Luftës së Parë Botërore; - përcakton në hartë frontet kryesore në të cilat u zhvillua Lufta e Parë Botërore - analizon faktorët që çuan na fitoren e Antantës në Luftën e Parë Botërore.			
Burimet: Libri i nxënësit, interneti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Me gjeografinë: Frontet e luftës, betejat kryesore.	


Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Metodologjia:

Stuhi mendimesh/reportazh

Organizimi i orës së mësimit:

Mësuesi/ja shkruan në tabelë “Lufta e parë Botërore” dhe kërkon nga nxënësit të rikujtojnë se ç’dinë për të, pra nxitet një diskutim paraprak lidhur me temën e re që do të zhvillohet nëpërmjet njohurive që nxënësit kanë për këtë ngjarje nga klasat e mëparshme



Ndërtimi i njohurive

-Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë mësimin dhe secili të mbajë shënime dhe të përgatitet ta paraqesë mësimin para klasës në mënyrë individuale (me qëllim që nxënësit të lexojnë mësimin mësuesi i cakton pas leximit nxënësit që do paraqesin informacionin në formën e një reportazhi në tabelë)

-Mësuesi/ja drejton pyetjen dhe aktivizon disa nxënës të prezantojnë mësimin duke shkruar në tabelë pikat kyçe të mësimit.

- *Si paraqitej situata në Evropë në prag të Luftës së Parë Botërore? (faktorët që çuan drejt “Luftës së Madhe)*

Nxënësi paraqet në tabelë: Situatën e krijuar dhe faktorët që nxitën konfliktin botëror.

Evropa në fillim të shek XX

- Kritje e nacionalizmit (epërsia etnike e një kombi ushtarakisht dhe ekonomikisht kundrejt kombeve të tjera)
- Shtetet ishin militarizuar dhe ishin futur në një garë armatimesh.
- Kërkesa për zgjerim territorial sidomos në vendet me burime natyrore.
- Kërkesa për tu zgjeruar në koloni (në rajone ku siguronin lëndën e parë dhe tregje shitjeje)
- Shtimi i rivalitetit ndërmjet shteteve dhe krijimi i aleancave dhe blloqeve ushtarake

- *Si filloi dhe si u përshkallëzua lufta deri në rang botëror*

Fillimi i luftës	-Vrasja e F.Ferdinantit në 28 qershor 1914 nga një nacionalist serb (preteksti) -28 korrik Austro-Hungaria i shpalli luftë Serbisë, të detyruara nga aleancat u përfshinë në luftë shtetet e tjera. -Në luftë u përfshinë dhe një pjesë e kolonive të shteteve evropiane. -Bloqet kundërshtarë → Bloku qendror (Gjermani, Austro-Hungari, Perandorinë Osmane dhe Bullgarinë) → Antanta (Britani, Francë, Rusi). -Shtetet që u përfshinë më vonë në luftë: SH.B.A e cila u përfshi në luftë në 1917, Italia në 1915, Japonia, Shtetet e Ballkanit, Portugalia.	
	• <i>Cilët ishin frontet kryesore në të cilat u zhvillua lufta? Po betejat kryesore?</i>	-Fronti Perëndimor(nga brigjet belge të Detit të Veriut deri në Alpe,luftonin forcat gjermane dhe franceze) -Fronti lindor (nga D.Balltik deri në D e Zi,luftonin gjermanët dhe austro –hungarezët me rusët) -Fronti Ballkanik (nga I.Vjosa deri në Selanik, forcat Austriake, Bullgare dhe ato italiane, franceze Britanike, greke dhe rumune) -Fronte të tjera ishin ai Italian,i Palestinës,i Kaukazit dhe i Lindjes së Largme -Betejat kryesore ishin e Verdunit, e Marnës, e Somës, e Galipolit etj.
	• <i>Si u zhvillua dhe si përfundoi lufta?</i>	Shtetet orientuan ekonominë drejt luftës propaganda për luftë ishte e fuqishme Arsyet e fitores së Antantës ishin: Largimi i Rusisë(1917), hyrja e SH.B.A –së në luftë) Në 3 nëntor 1918 u nënshkrua armëpushimi me Austro-Hungarinë, Në 9 nëntor 1918 u shpall republika gjermane,në 11 nëntor 1918 u nënshkrua armëpushimi me Gjermaninë
	Pyetje për diskutim	Situata quhet e realizuar nëse nxënësit: 1) Përcaktojnë shkaqet që çuan në fillimin e konfliktit të parë botëror. 2) Tregojnë në hartë shtrirjen e luftës frontet dhe betejat kryesore. 3) Analizojnë faktorët që kushtëzuan fitoren e Antantës në luftë.
	Vlerësimi:	<i>Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënëit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</i>
	Detyrat dhe puna e pavarur:	• Nxënësve u jepet detyrë të kërkojnë dhe sjellin informacion rreth “Traktatit të fshehtë të Londrës”

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shkenca shoqërore	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Bota pas Luftës së Parë Botërore		Situata e të nxënët: a) Katëmbëdhjetë pikat e presidentit Uillson, kërkesat e shteteve. b) Vendimet për Gjermaninë në Konferencën e Paqes. c) Vendimet e tjera të Konferencës së Versajës.	
Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Shqyrton, ndërton analizën dhe parashtron pyetje, për të argumentuar informacionin historik, konceptet dhe idetë. Kompetenca e të nxënët Vlerëson pikëpamjet e ndryshme si dhe menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e burimeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre në histori Kompetenca qytetare Kupton perspektivat, besimet dhe qëndrimet e njerëzve në të shkuarën e në të tashmen .		Fjalët kyçe <i>Traktatet e Versajës</i> <i>14 pikat e U. Willson</i> <i>“katër të mëdhenjtë”</i> <i>Lidhja e Kombeve</i>	
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore - Analizon konceptin e planit të SHBA-së për paqen në botë - Gjykon mbi vendimet e Konferencës së Paqes. - Pasqyron hartën politike të Evropës pas Luftës . - Gjykon pasojat politike, ekonomike, sociale dhe psikologjike të Luftës së Parë Botërore dhe të traktateve në përfundim të saj			
Burimet: Libri i nxënësit, interneti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - Me gjeografinë: harta e re e Evropës - Me temat e tjera: Fillimet e krizave të shek. XX. Lufta e Parë Botërore	

Vendimet e Konferencës të Paqes		
Ndaj Gjermanisë -Gjermania humbi 10 % të popullsisë dhe sipërfaqes -Alsasë –Lorenën e mori Franca, -Sara, Reni, Danzingut kontrolllohej nga ndërkombëtarët. -U ndanë kolonitë gjermane. -U kufizua ushtria në 1000 trupa. -U kufizua flota në 6 luftanije,nuk duhej të kishte artileri, aeroplanë etj. -Do të paguante dëmshpërblime në shumën 33 miliardë dollar.	Për ndryshimin e hartës politike -U shpërbënë perandoria Austro-Hungareze, ruse dhe osmane. -U krijuan shtete si Çekoslovakia, Mbretëria SKS, Polonia, Hungaria. -Italia mori Triesten dhe Tirolin e jugut. -Hungaria, Austria, Bullgaria, P.Osmane humbën territore në dobi të Greqisë Jugosllavisë dhe Rumanisë. (tregohen në hartë) -Armenia u shpall e pavarur. -Rajonet në Lindjen e Mesme u vunë në administrimin e Francës dhe Anglisë. (Siria, Iraku, Palestina, Jordania)	Për krijimin e “Lidhjes së Kombeve -Qëllimi ruajtja e Paqes -bashkëpunimi i shteteve bashkëpunimi i shteteve -Selia në Gjenevë. -Institucionet Asambleja Këshilli Sekretariati -Nuk bënte pjesë SH.B.A Rusia
Pyetje për diskutim Situata quhet e realizuar nëse nxënësit: 1) Evidentojnë qëndrimin e Fuqive të Mëdha në Konferencën e Paqes. 2) Analizojnë vendimet e Konferencës Paqes për Gjermaninë. 3) Shpjegojnë ndryshimet territoriale pas Luftës së Parë Botërore.		
Vlerësimi: <i>Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxëniti të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</i>		
Detyrat dhe puna e pavarur: • Nxënëshve u jepet si detyrë të mendojnë në mënyrë kritike dhe të gjykojnë mbi pasojat politike, ekonomike, sociale dhe psikologjike të Luftës së Parë Botërore		

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shkenca shoqërore	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Bashkimi Sovjetik		Situata e të nxënësve: a) Revolucioni Bolshevik i vitit 1917. b) Tiparet e regjimeve totalitare ,qeverisja e Leninit. c) Qeverisja e Stalinit.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit -Shqyrton,ndërtton analizën dhe parashtron pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar informacionin historik. Kompetenca e të nxënësve - Parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumente dhe burime. Kompetenca qytetare • Shqyrton burimet historike për të kuptuar çështjet shoqërore dhe se si parime të ndryshme kanë ndikuar në çështjet njerëzore.		Fjalët kyçe <i>Totalitarizëm,</i> <i>Bolshevik,</i> <i>Sovjetët,</i> <i>kulti i udhëheqësit,</i> <i>kollektivizim.</i>	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore -shpjegon shkaqet dhe rrjedhojat e revolucionit të 1917. - analizon tiparet e sistemit politik në BRSS; - analizojë politikën e Stalinit si pika kulmore e zbatimit të diktaturës së proletariatit dhe të luftës së klasave; - gjykon mbi tiparet ekonomike dhe të jetës social-kulturore në në BRSS;			
Burimet: Libri i nxënësit, interneti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Me temat e tjera:Fillimet e krizave të shek. XX. Lufta e Parë Botërore.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Metodologjia:


Diskutim/pyet sërish

Organizimi i orës së mësimit:

- Mësuesi/ja drejton pyetjet për të hapur diskutim në klasë duke nxitur të gjithë nxënësit të marrin pjesë në të.
- Kush më thotë se çfarë regjimi ishte vendosur në vendin tonë nga viti 1945-1990?
- Cili ishte modeli ku u mbështet regjimi komunist në Shqipëri?
- Cili nga ju mund të rendisë disa tipare të regjimit komunist?
- Në cilin shtet u vendos për herë të parë ky regjim?
- Cila ishte ideologjia ku u mbështet ky regjim? Cilët ishin udhëheqësit kryesorë të këtij regjimi në B.S?

Ndërtimi i njohurive:

- Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë mësimin.
- Për secilin prej pjesëve të mësimit cakton dy nxënës .Një nxënës përgatit pyetjet që do ja drejtojë shokut kurse tjetri përgatitet për të zbërthyer pjesën. pasi mësuesi/ja kupton se është kuptuar pjesa kërkon nga nxënësit e tjerë të bëjnë pyetje P.sh :
- *Pjesa e parë:*
- Cilat ishin pakënaqësitë që po kalonte popullsia Ruse në fillim të shek.XX?
- Cilat ishin tiparet e qeverisjes demokratike në Rusi?
- Cilat ishin tiparet e bolshevikëve?
- Mësuesja ndërhyr për të drejtuar nxënësit drejt përgjigjes së saktë ,dhe përmbledh në tabelë përgjigjen p.sh.




- Bazoheshin në ideologjinë Marksiste. Udhëheqësit kryesorë ishin Lenini, L.Trocki.
- Kërkohet daljen e Rusisë nga lufta./shpërndarjen e tokës fshatarësisë./pushteti i kalonte sovjetëve.
- Erdhën në pushtet me dhunë /duke përdorur demagogjinë dhe ideologjinë komuniste.(7 nëntor 1917)
- U mbështetën në klasën punëtore dhe fshatarësinë, këshillat e sovjetëve.

• <i>Pjesa e dytë:</i> Cilat janë tiparet e sistemeve totalitare?/Shpjegoni disa veçori të qeverisjes së Leninit?(nxënësi duhet të përgjigjet si më poshtë) Tiparet e sistemeve totalitare 1-Ekzistenca e një ideologjie të vetme. 2-Sistem monopartiak. 3-Krijimi i kultit të individit. 4-Përdorimi i dhunës dhe terrorit. 5-Ngritja e nacionalizmit dhe rritja e madhësisë së kombit shtet. Qeverisja e Leninit (1917-1924) -Sapo erdhi në pushtet largoi Rusinë nga lufta. -Shtetëzoi disa prej industrive më të rëndësishme në vend. Ndau tokën për fshatarët. -Në vitet 1918-1920 u zhvillua lufta civile me kundërshtarët e bolshevikëve të mbështetur nga Antanta. -Në 1922 u krijua B.R.S.S -Në fushën ekonomike zbatoi Politikën e Re Ekonomike(NEP). Qeverisja e Stalinit -Erdhi në pushtet duke eliminuar kundërshtarët,vuri policinë sekrete nen kontrollin e tij. -Mbizotëronte frika në B.R.S.S.Krijoi kampet e punës (Gulag), shoqëria sovjetike ishte e izoluar e censuruar. -Ngriti kultin e udhëheqësit. -Zbatoi ekonominë shtetërore të centralizuar dhe të planifikuar. -Krijoi kooperativat bujqësore në fshat. -E vuri theksin në zhvillimin e Industrisë(B.R.S.S u shndërrua në vend të zhvilluar industrial) -Shoqëria sovjetike ishte një shoqëri e izoluar nga bota perëndimore.	
Pyetje për diskutim Situata quhet e realizuar nëse nxënësit: 1) Shpjegojnë se si u zhvillua revolucioni demokratik dhe shkaqet e ardhjes në pushtet të bolshevikëve. 2) Evidentojnë dhe analizojnë tiparet e regjimeve totalitare. 3) Shpjegojnë masat e marra gjatë qeverisjes së Leninit dhe Stalinit. 4) Krahasonjnë dhe gjejnë ndryshimet në qeverisjen e Leninit me Stalinin.	
Vlerësimi: <i>Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</i>	
Detyrat dhe puna e pavarur: • Nxënëseve u jepet detyrë rubrika “Hulumtoni dhe diskutoni”, si dhe të gjejnë dallimet në qeverisjen e Leninit dhe Stalinit.	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shkenca shoqërore	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Fashizmi në Itali.		Situata e të nxënit: a) Situata e krijuar në Itali pas Luftës së Parë Botërore. b) Forcat politike dhe ardhja në pushtet e fashistëve. c) Tiparet e qeverisjes fashiste në aspekte të ndryshme.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e të menduarit - Ndërtton dhe interpreton grafikë, diagrame, tabela për paraqitjen e të dhënave historike. Kompetenca e të nxënit • Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin • Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët për realizimin e një veprimtarie të përbashkët.		Fjalët kyçe <i>Traktati i fshetit i Londrës</i> <i>Fashizëm</i> <i>Këmbishëzinjë.</i> <i>Korporatizmi fashist.</i>	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore -shpjegon kushtet historike të ardhjes në pushtet të Musolinit; - analizon tiparet e sistemit politik në Italinë fashiste; - shpjegojë tiparet e politikës së jashtme dhe të brendshme të fashizmit në Itali; - analizon tiparet e sistemit ekonomik në Italinë fashiste; - analizon tiparet social-kulturore të shoqërisë në Itali		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: • Me temat e mëparshme: Bota në Luftën e Parë Botërore • Me letërsinë: Botime të periudhës në fjalë.	
Burimet: • Libri i nxënësit, interneti.			

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
Metodologjia: Pyetje përgjigje/parashikim me terma paraprake/ditar dypjesësh.	
Organizimi i orës së mësim: - Mësuesi /ja drejton pyetje me qëllim rikujtimin e njohurive të marra në temat e mëparshme dhe prezantimin e temës së re. Në cilin prej blloqeve ushtarake bënte pjesë Italia në Luftën e Parë Botërore? Ç’përmbante Traktati i Fshehtë i Londrës? Cilat ishin kërkesat e Italisë në Konferencën e Paqes?/ A doli e kënaqur Italia nga vendimet e Konferencës së Versajës? Ndërtimi i njohurive - Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve se si do të zhvillohet kjo orë mësimi.kërkon nga nxënësit që gjatë leximit të mësimt të përcaktojnë individualisht konceptet kryesore rreth të cilave do të ndërtohet mësimi dhe pasi diskutojnë rreth tyre të ndëtojnë një tabelë në formën e ditarit dypjesësh dhe ta plotësojnë atë (tabela ndërtohet në dërrasë nga një nxënës dhe pasi nxënësit kanë punuar në fletoret e tyre, bëhet plotësimi i saj në dërrasë nga nxënës të ndryshëm.)	
Koncepti	Komenti
Gjendja në Itali pas Luftës së Parë Botërore	-Zhgënjim i madh lidhur me vendimet e Konferencës së Versajës sidomos në radhët e nacionalistëve. -Pasoja të rënda nga lufta, si humbje njerëzore dhe dëme ekonomike. -Inflacion dhe papunësi masive të shoqëruara me trazira shoqërore. - Kërkesat e shtresave të ndryshme → Fshatarët kërkonin zbatimin e reformës agrare. → Borgjezët kërkonin poste dhe vende të rëndësishme në shoqëri → Punëtorët e Veriut kërkonin kushte dhe pagë më të mirë. -U krijua grupime ekstremiste të dy krahëve si: → Partia Komuniste drejtuar nga A.Gramshi → Partia Fashiste nga B.Musolini. -U krijua nga B.Musolini dhe një grup veteranësh të pakënaqur në Milano. -Kishin disiplinë të rreptë visheshin me uniforma të zeza. -Premtonin → Të rikthenin rregullin. → Të nxisnin zhvillimin ekonomik të vendit → Të luftonin komunizmin → Të rikthenin lavdinë e Romës antike. -U mbështetën nga shtresa të ndryshme të shoqërisë italiane. -Erdhën në pushtet (1922) nëpërmjet presionit dhe me kompromisin e monarkisë (Viktor Emanuelit)
Tipare te fashistëve	

Kushtet që sollën në pushtet fashistët	-Qeveria liberale në Itali ishte e dobët për të kontrolluar situatën në vend. -Konservatorët kërkonin rikthim të rregullit dhe ligjeve. -Partitë e tjera kërkonin ndryshime të mëdha shoqërore. -Në tetor 1922 u organizua një marshim në Romë. - Viktor Emanueli i III ngarkoi Musolinin të formonte një qeveri me pjesëmarrjen e partive të tjera. -Në vitin 1924 fashistët fituan shumicën në parlament dhe vendosën regjimin fashist në Itali.
Qeverisja fashiste 	Politika e brendshme -u shpërndanë partitë politike,u vendos sistem monopartiak. -u vendos censura në shtyp,u ndalua liria e fjalës, veprimt. -u krijuan gjykata speciale për të dalluar krimet ndaj shtetit -institutionet shtetërore u zëvendësuan me ato fashiste. -ndryshoi kushtetutën (parlamenti nuk mund të kontrollonte qeverinë) -si organ këshillues i qeverisë u krijua Këshilli i Lartë Fashist -Eliminoi votimin e përgjithshëm. -u krijua policia sekrete, u formua milicia vullnetare për sigurinë kombëtare -në shkollë u vendos edukimi fashist i rinisë. Ekonomia -u ruajt pronat private por u ndoq politika e planifikimit dhe ndërhyrjes shtetërore në ekonomi -u krijua modeli i korporatizmit fashist. -në fshat u rrit sipërfaqja e punësimeve e tokës, prodhimtaria e grurit, u bënë bonifikime. -u ul papunësia edhe nëpërmjet nisjes së punimeve publike Politika e jashtme -politikë agresive, zgjerim në koloni dhe pushtim të vendeve të tjera. -Musolini hartoi një plan pushtimesh që nisi me pushtimin e Etiopisë dhe Shqipërisë.
Pyetje për diskutim Situata quhet e realizuar nëse nxënësit: 1) Përcaktojnë gjendjen në Itali pas Luftës së I Botërore 2) Evidentojnë faktorët që sollën në pushtet fashistët. 3) Analizojnë reformat e ndërmarra në Itali gjatë qeverisjes fashiste.	
Vlerësimi: <i>Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënëtit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</i>	
Detyrat dhe puna e pavarur: • Nxënësve u jepet detyrë të hulumtojnë dhe të sjellin fakte rreth pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste.	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shkenca shoqërore	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Gjermania		Situata e të nxëniet: a) Gjendja në Gjermani pas Luftës së Parë Botërore. b) Qeverisja e nazistëve. c) Politika e jashtme e nazistëve.	
Rezultatet e të nxëniet sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e të menduarit Zhvillon të menduarit për realizimin e kërkitimit historik. Kompetenca e të nxëniet Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet për një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet Kompetenca qytetare Shqyrton burimet historike për të kuptuar ngjarjet dhe zhvillimet që kanë ndikuar në shoqëri dhe grupe të ndryshme kulturore në kohëra të ndryshme dhe shpjegon natyrën, shkaqet dhe pasojat e konflikteve dhe ndërvarësive kulturore		Fjalët kyçe <i>Republika e Vajmarit</i> <i>Nazistët,</i> <i>Antisemitizëm,</i> <i>Racë superiore.</i>	
Rezultatet e të nxëniet të kompetencave të fushës sipas temës mësimore - shpjegon kushtet historike të ardhjes në pushtet të Hitlerit; - analizon tiparet e politikës së jashtme dhe të brendshme të nazizmit në Gjermani; - gjykon antisemitizmin e Hitlerit, që solli holokaustin, duke gjykuar për rrjedhojat e tij; - analizon arsyet e militarizimit të ekonomisë si faktor për daljen nga kriza ekonomike			
Burimet: Libri i nxënësit, interneti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - Me temat e tjera: Bota pas Luftës së Parë Botërore. - Me letërsinë: Botime të periudhës në fjalë.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
Metodologjia: Punë kërkimore/kubimi Organizimi i orës së mësimit: • Mësuesi/ja ka udhëzuar që më parë nxënësit të hulumtojnë dhe grumbullojnë foto të ndryshme të Gjermanisë gjatë viteve të nazizmit, Hitlerit, ushtrisë naziste, përndjekjes së hebrenjve etj., të cilat vendosen në tabelë dhe komentohen nga nxënësit në bazë të kërkimit dhe hulumtimit që kanë bërë. • Për të ndërtuar një pamje më të qartë të antisemitizmit të ndjekur nga nazistët mësuesi/ja shfrytëzon projektorin dhe shfaq sekuenca të shkurtër nga filmat artistikë “Pianisti” “Lista e Shlidenit” “Djali me pizhama me vija”. Ndërtimi i njohurive Në këtë orë mësimi do të ndiqet e njëjta teknikë e ndjekur në temën “Reforma protestante” me specifikat të paraqitura më poshtë. (kujtojmë që mësuesi/ja duhet të ketë parapërgatitur kubin (kutinë) dhe gjashtë fletët me kërkesat). <i>Fleta e parë: (Përshkruaj) Përshkruaj gjendjen në Gjermani gjatë qeverisjes së Republikës së Vajmarit.</i>	-Institucioni kryesor ishte presidencia. -Në parlament përfaqësoheshin shumë parti gjë që çoi në paqëndrueshmëri politike -Situata politike ishte e trazuar (1919 pati një përpjekje të komunistëve dhe në 1923 të nacionalistëve për të marrë pushtetin. -Kishte probleme financiare (pagesat e dëshmëpërblimeve), inflacion, rritje të çmimeve. -Nga gjendja e vështirë ekonomike ishte tronditur besimi tek republika. <i>Fleta e dytë: (Argumento) Argumento faktorët që ndikuan në ardhjen në pushtet të nazistëve.</i> -Pakënaqësia nga qeverisja e republikës së Vajmarit -Kërkesa për një shtet të fortë. -Pakënaqësitë e shkaktuara nga kriza ekonomike. -Propaganda nacionaliste dhe premtimet e bëra nga nazistët si dhe demonstrimi i forcës. -U mbështetën nga konservatorët (në 1933 ku Hitleri u bë kancelar i Gjermanisë dhe në zgjedhjet e parakohshme ku nazistët bënë aleancë me konservatorët) <i>Fleta e tretë: (Analizo) Analizo masat e marra gjatë qeverisjes naziste.</i>

Politika e brendshme naziste

- Hitleri mori të drejtën e fuqive diktatoriale për 5 vjet (ndryshonte kushtetutën, shpallte ligje)
- Krijoi policinë sekrete Gestapon institucionin e dhunës në Gjermaninë naziste
- Miratoi një ligj që lejonte arrestimin e kundërshtarëve politikë, krijoi kampet e përqendrimit.
- Pushteti lokal dhoma e lartë e parlamentit, presidenti, të drejtat e njeriut dolën jashtë ligjit.
- Doktrina naziste ishte antisemitike, antikomuniste, antiliberale dhe diskriminuese ndaj racave të tjera.
- Miratuan ligjet e Nurembergut nëpërmjet të cilave rritën numrin e të përndjekurve.
- Ekonomi e kontrolluar nga shteti, pa prekur pronën private e lidhur me militarizimin në shërbim të luftës.
- U investua nga shteti në punët publike u ul papunësia.


Politika e jashtme

- Në politikën e jashtme riarmatosi Gjermaninë dhe nxitoi nacionalizmin e skajshëm (Rajhu i III)
- Objektivi i parë ishte bashkimi i vendeve me kulturë Gjermane. (në Austri, Çekoslovaki, Poloni)
- Objektivi tjetër ishte pushtimi i territoreve sllave ndërmjet Polonisë dhe Rusisë.
- Hodhi poshtë vendimet e Versajës duke ndaluar pagesat e dëmshpërblimeve.

Fleta e katërt: (Shoqëro)ku tjetër kemi hasur tipare të ngjashme me atë nazist. (pra sisteme totalitare)

Sistemet totalitare

Fleta e pestë: (Krahaso) Krahasoni duke evidentuar të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet regjimeve të djathta dhe majta totalitare.



<i>Fleta e gjashtë (Zbato) shkruaj një ese me temë “Holokausti mbi hebrenjtë ngjarje që edhe sot trondisin njerëzimin”</i> Pika përfundimtare mund të jepet si detyrë shtëpie dhe të ngjitet në kub orën e ardhshme.) Pyetje për diskutim Situata quhet e realizuar nëse nxënësit: 1) Identifikojnë kushtet historike që ndikuan në ardhjen në pushtet të nazistëve. 2) Analizon tipare të politikës së jashtme dhe të brendshme të nazistëve. 3) Gjykon mbi antisemitizmin dhe holokaustin ndaj hebrenjve.
Vlerësimi: <i>Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</i>
Detyrat dhe puna e pavarur: • Nxënëset u jepet detyrë të shkruajnë një ese me temë “Holokausti mbi hebrenjtë ngjarje që edhe sot trondisin njerëzimin..

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shkenca shoqërore	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: ShBA modeli i një shteti liberal		Situata e të nxënit: a) Tiparet e zhvillimit të SHBA gjatë viteve të Luftës. b) Shkaqet e “Depresionit të madh” c) Kursi i Ri i Ruzveltit.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit • Shqyrton, ndërton analizën dhe parashtrohet pyetje, për të argumentuar, informacionin, konceptet historike Kompetenca e të nxënit Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet për një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet Kompetenca qytetare Shqyrton burimet historike për të kuptuar çështjet shoqërore dhe se si parime të ndryshme kanë ndikuar në çështjet njëzëre.		Fjalët kyçe <i>Sistem demokratik,</i> <i>“E Marta e Zezë”,</i> <i>Ekonomi e konsumit,</i> <i>Liberalizmi ekonomik,</i> <i>Teoria ekonomike e Kejnosit,</i> <i>Kursi i ri.</i>	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: -analizon tiparet e sistemit politik në SHBA; - analizon shkaqet dhe tiparet e krizës në SHBA; - gjykon mbi “Kursin e Ri të Rusveltit si model për të dalë nga kriza ekonomike; - analizon strukturën e shoqërisë amerikane. - analizon shkaqet dhe arritjet e lëvizjeve feministe në SHBA			
Burimet: • Libri i nxënësit, interneti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: • Me temat e mëparshme: Bota në Luftën e Parë Botërore • Me letërsinë: Botime të periudhës në fjalë. • Me ekonominë: Konceptet ekonomike, teoritë ekonomike.	


Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Metodologjia:

Stuhi mendimesh/ të menduarit kritik përmes leximit

Organizimi i orës së mësimit:

- Mësuesi/ja shkruan në tabelë SHBA dhe kërkon nga nxënësit të rikujtojnë njohuritë që kanë mësuar rreth këtij shteti për t'i orientuar mësuesi/ja drejton pyetje të ndryshme.
- Përgjigjet e nxënësve mund të shënohen në dërrasë si më poshtë:



Ndërtimi i njohurive

- Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë pjesën e parë të mësimit dhe të përshkruajnë gjendjen në ShBA pas Luftës së Parë.
- -Pasi pyet disa nxënës mësuesja shënon në dërrasë të zezë:

→ Shtet i fuqishëm, me ndikim në politikën botërore (14 pikat e Uillsonit)

→ Regjim demokratik i përparuar.

→ Zhvillim i vullshëm ekonomik (ekonomia e konsumit)

→ Shtim të eksporteve, zhvillim të tregtisë së brendshme.

→ Zhvillimi kulturës, radios, sporteve, muzikës.

→ Përdorim i teknologjisë së avancuar.

- Mësuesi/ja pyet: Cilët ishin shkaqet që çuan në “Depresionin e Madh”? Pas përgjigjeve mësuesi/ja shënon në dërrasë.

→ 1-Dhënia e kredive pa kriter për bizneset dhe individët, për të investuar në bursë

→ 2-Politika e mosndërhyrjes së shtetit në ekonomi (vetërregullimi sipas kërkesë ofertës)

→ 3-Shtimi i prodhimit në ShBA dhe dëmi që i solli tregut amerikan rikthimi i shteteve të Evropës si prodhuese krizës ekonomike


→ 4-Spekulimet në bursë.

• Pasi lexojnë pjesën e dytë të mësuesi/ja pyet nxënësit: Cilët ishin treguesit e krizës ekonomike në ShBA dhe Evropë? Treguesit e krizës në ShBA dhe Evropë → Ra kërkesa për mallrat bujqësore dhe industriale. (kërkesa dhe oferta në proporcion të zhdrejtë) → Falimentim të ndërmarrjeve ,fabrikave dhe bankave. → Rënia drastike në bursën e Nju Jorkut. → Miliona amerikanë humbën kursimet dhe pasuritë e tyre. → Zhvlerësim të monedhës, varfëri. → Humbjen e besimit tek amerikanët në zhvillimin e madh të dhjetë viteve të fundit. → Në Evropë zhvillimi ekonomik ra për arsye të pakësimit të kredive amerikane dhe të faktit se tregu Evropian ishte lidhur ngushtë me atë amerikan. • Cilat ishin masat kryesore të ndërmarrja nga presidenti F.Ruzvelt për të nxjerrë vendin nga kriza. → Kursi i Ri i Ruzveltit u zbatua nëpërmjet masave lehtësuese dhe ripërtëritëse. → U afërua ndihmë për të lehtësuar papunësinë, U hapën agjenci kombëtare që siguronin punë → U zgjeruan shpenzimet shtetërore për të rritur punësimin sidomos nëpërmjet ndërtimeve publike. → Bankat u mbyllën dhe ju nënshtuan kontrollleve. → Qeveria zhvlerësoi dollarin dhe rriti kontrollin në bursë. → Shteti ndihmoi fermerët financiarisht dhe i orientoj drejt kulturave që duhet të mbillnin. • Për të nxitur mendimin kritik por edhe për të kuptuar se mësimi është përfitësuar nga nxënësit mësuesi/ja pyet: Si ndryshoi roli i shtetit në ShBA para dhe pas krizës ekonomike? Cilat ishin teoritë ekonomike që u përballën me njëra –tjetrën? • Nxënësit tregojnë si u rrit roli i shtetit në ekonomi dhe se ai do të luante rolin e drejtuesit dhe kontrolluesit pa prekur bazat e ekonomisë të tregut dhe sistemit kapitalist. Dy teoritë ekonomike më të njohura ishin ajo e liberalizmit ekonomik e A .Smithit (laissez faire) dhe keinsianizmi, i cili mbështeste rritjen e rolit të shtetit në ekonomi me funksion nxitës dhe kontrollues. Pyetje për diskutim Situata quhet e realizuar nëse nxënësit: 1) Përkrahujnë gjendjen në ShBA pas luftës së Parë botërore. 2) Analizojnë shkaqet dhe treguesit e “Depresionit të Madh” 3) Shpjegojnë masat që mori F.Ruzvelt për të nxjerrë vendin nga kriza ekonomike. Vlerësimi: <i>Vlerësimi i nxënësit mbështetet në rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</i> Detyrat dhe pavarur: • Nxënësve u jepet detyrë të rubrika “Hulumtoni dhe diskutoni” në tekst.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shkenca shoqërore	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: ShBA modeli i një shteti liberal.		Situata e të nxënësve: a) Gjendja në Francë pas Luftës së Parë Botërore. b) Kriza ekonomike në Francë. c) Qeverisja e Leon Blumit.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e të menduarit - Zhvillon të menduarit për realizimin e kërimit historik. Kompetenca e të nxënësve - Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin - Diskuton individualisht ose në grup për rëndësinë që ka e shkuara në kuptimin e të tashmes dhe perspektivat në të ardhmen. Kompetenca qytetare - Shqyrton burimet historike për të kuptuar ndikimin e tyre në çështjet shoqërore dhe njerëzore.		Fjalët kyçe <i>Konservatorët,</i> <i>Ekstremi i majtë,</i> <i>Kriza ekonomike,</i> <i>Kursi i ri francez,</i>	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - analizon tiparet e sistemit politik në Francë; - analizon tiparet e sistemit ekonomik në Francë; - analizon shkaqet, tiparet e krizës së viteve 1929 – 1933 në Francë dhe rrugët e daljes nga kriza; - analizon tiparet social-kulturore të shoqërisë në Francë.			
Burimet: Libri i nxënësit, interneti, biblioteka e shkollës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - Me temat e mëparshme: Bota në Luftën e Parë Botërore - Me letërsinë: Botime të periudhës në fjalë.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
Metodologjia: Pyetje –përgjigje/ punë në grupe/hartë e mendjes Organizimi i orës së mësimit: - Mësuesi/ja rikujton njohuri të nxënësve që kanë lidhje me temën e re, duke drejtuar pyetje të ndryshme. P.sh: - Në cilin prej blloqeve kundërshtare bënte pjesë Franca në Luftën e Parë Botërore? - Cilat ishin kërkesat e Francës pas luftës? Pse? - Si mendoni ju pati pasoja të rënda Lufta në Francë? Pse? - Pasi dëgjon mendimet e nxënësve mësuesi/ja udhëzon të lexohet mësimi. Ndërtimi i njohurive - Mësuesi/ja pasi nxënësit lexojnë mësimin e ndan klasën në tre grupe dhe shkruan në tabelë tre konceptet kryesore rreth të cilave do të ndërtohet mësimi dhe kërkon nga nxënësit të ndërtojnë hartën e secilit prej koncepteve sipas grupeve. - Pasi nxënësit punojnë në grupe mësuesi/ja cakton dy anëtarë të grupit për të prezantuar informacionin në dërrasë njeri prej tyre dhe nëpërmjet shpjegimit nxënësi tjetër. harta e koncepteve mund të paraqiten si më poshtë:	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve



PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shkenca shoqërore	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Turqia: krijimi i një shteti laik kombëtar		Situata e të nxënës: a) Roli i Ataturkut në Luftën Çlirimtare b) Paqja e Sevres dhe organizimi i nacionalistëve turq c) Masat e marra për krijimin e shtetit kombëtar laik Turk.	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe Kompetenca e të nxënës • Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet për një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet. Kompetenca personale • Përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj. për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij; Kompetenca qytetare • Kupton perspektivat, besimet dhe qëndrimet e njerëzve në të shkuarën e në të tashmen dhe rëndësinë së historisë së tyre dhe të tjerëve; Kompetencat digjitale Akseson një sërë burimesh digjitale të informacionit dhe analizon në mënyrë kritike këto burime.		Fjalët kyçe <i>Asambleja e Madhe,</i> <i>Paqja e Sevres,</i> <i>Shteti kombëtar laik,</i> <i>"Babai i Turqisë"</i>	
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Vlerëson rolin e Qemal Ataturkut në krijimin e shtetit laik kombëtar turk; - Analizon reformat e Ataturkut në evropianizimin e Turqisë; - Analizon strukturën e shoqërisë turke në periudhën midis dy luftërave dhe ndryshimet që ajo pësoi.			
Burimet: • Libri i nxënësit, interneti, harta, foto, Video-projektor		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: • Me temat e mëparshme: Bota pas Luftës së Parë Botërore. • Me Gjeografinë: Ndryshimet territoriale të shtetit turk.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
Metodologjia: Punë kërkimore/ditari dypjesësh. Organizimi i orës së mësimit: - Mësuesi/ja ka informuar më parë nxënësit rreth kësaj teme duke i kërkuar të sjellin informacion mbi jetën dhe veprimtarinë e M. Qemalit. - Pasi nxënësit prezantojnë informacionin që kanë përgatitur mësuesi/ja udhëzon të lexohet mësimi. Ndërtimi i njohurive - Mësuesi/ja ndërton në dërrasë një tabelë në formën e ditarit dypjesësh dhe e plotëson atë nëpërmjet përgjigjeve të nxënësve. - Për të konkretizuar mësimin mësuesi/ja përdor hartën dhe tregon territoret që humbi Turqia pas Luftës së Dytë Botërore.	
Koncepti	Komenti
Turqia pas luftës së Parë Botërore	-Më 30 tetor 1918 Turqia kapitulloi, kjo ngjarje shkaktoi pakënaqësi në radhët e nacionalistëve . -Nacionalistët krijuan në Ankara “Asamblenë e Madhe të Turqisë”, akuzuan për tradhti qeverinë dhe kryetarin e fesë islame. -Pushtimi grek i Bursës dhe Thrakës Lindore. -Paqja e Sevres vendosi: (10 gusht 1920) { Shteti turk u kufizua në Stamboll dhe në një rrip në Anadoll. Greqia merite Izmirin dhe një pjesë e Trakisë. Në Anadollin Lindor do të krijoheshin dy shtete. Italianë do të kishin nën ndikim Antalian. Francezët do të kishin në ndikimin e tyre Malatjan, Sivasin dhe Adanën. Asambleja në Ankara hodhi poshtë marrëveshjen e Sevres dhe nisi Luftën Çlirimtare.
Lufta çlirimtare në Turqi	-M.Qemali organizoi një ushtri të rregullt. -Ushtria u rezistoi francezëve dhe detyroi italianët të largohen nga Antalia. -U thyen forcat greke në frontim perëndimor. -U nënshkrua paqja e Lozanës ku u njoh shteti i pavarur Turk me kufijtë që ka edhe sot Turqia. -Më 29 tetor 1922 u shpall Republika e Turqisë. -Më 1 nëntor 1922 u suprimua monarkia.

Organizimi i shtetit	-U krijuan institucione të zgjedhura nga populli.(regjim parlamentar) -Forma e regjimit Republikë kombëtare. -Sistem demokratik dhe laik. -Organizim bashkëkohor i ligjeve dhe rregullave të shtetit të ri Turk.
Reformat për modernizimin e Turqisë	Në ekonomi 1-U morën masa për krijimin e industrisë kombëtare. 2-U zhvilluan ato degë të industrisë që siguronin lëndën e parë në vend. 3-U adoptua politika e kapitalit shtetëror 4-U krijuan banka dhe institucionet e kreditimit. 5-U kufizuan monopolet e huaja. 6-U morën masa për përmirësimin e infrastrukturës. 7-U shtuan sipërfaqet e mbjella. 8-U dhanë kredi nga bankat bujqësore për mekanizimin e bujqësisë. Në arsimit 1-Ideja ishte zhvillimi i arsimit larg besëtytmive por edhe larg ideve të huaja. 2-Shkollat u vunë nën varësinë e ministrit të arsimit. 3-Ndarja e institucioneve fetare nga shteti. 4-U zëvendësua alfabeti arab me atë turk. Në fushën sociale 1-U njohën të drejtat e gruas turke në familje dhe në shoqëri. 2-U njoh e drejta e zgjedhjes në organizmat shtetërorë.
Pyetje për diskutim	Situata quhet e realizuar nëse nxënësit: 1) Përcaktojnë situatën në Turqi pas Luftës së Parë Botërore. 2) Vlerësojnë rolin e M.Qemalit në modernizimin e shtetit Turk. 3) Analizojnë reformat e ndërmara në fusha të ndryshme për modernizimin e shtetit turk.
Vlerësimi:	<i>Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</i>
Detyrat dhe puna e pavarur:	• Nxënësve u jepet detyrë rubrika “Hulumtoni dhe diskutoni”

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shkenca shoqërore	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Veprimtari praktike: Ballkani në periudhën midis dy luftërave		Situata e të nxënësve a) Rrethanat historike në Ballkan pas Luftës së Parë Botërore b) Zhvillimet politike në Ballkan dhe roli i Fuqive të Mëdha. c) Problemet ekonomike dhe sociale në Ballkan.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e të nxënësve - Parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumente dhe burime. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin - Zhvillon një kërkim individual ose në grup për kryerjen e një veprimtarie në histori. Kompetenca digjitale - Akceson një sërë burimesh digjitale të informacionit dhe analizon në mënyrë kritike këto burime.		Fjalët kyçe -pakica kombëtare, -probleme etnike, -lufta Greko-Turke. -“Internacionalja e gjelbër” -reformë agrare, -diktaturë mbretërore, -diktaturë ushtarake,	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore - Diskutojnë mbi tiparet e jetës politike në Ballkan në periudhën midis dy luftërave, duke evidencuar të përbashkëtat dhe veçantitë; - Krahason zhvillimet ekonomike, politike, shoqërore ndërmjet Ballkanit dhe Evropës Perëndimore.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - Me gjeografinë: harta e Ballkanit. - Me temat e mëparshme: “Bota pas Luftës së Parë Botërore” “Turqia, krijimi i një shteti laik kombëtar”	
Burimet: Libri i nxënësve, interneti, foto, video, P. Point, literaturë historike “Historia e Ballkanit” ZH.Castellan, videoprojektor.			

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
Metodologjia: Punë kërkimore në grupe/diskutim Organizimi i orës së mësimit: Mësuesi/ja ka njoftuar më parë nxënësit për zhvillimin e veprimtarisë praktike dhe i ka organizuar për punën kërkimore që do të realizojnë si më poshtë: Nxënësit ndahen në dy grupe me qëllim trajtimin e tematikave të ndryshme lidhur me situatën politike, ekonomike dhe sociale në vendet e Ballkanit. <i>Grupi I</i> ka si objekt trajtimin e çështjeve që lidhen me një grup vendesh të Ballkanit Lindor <i>Grupi II</i> do të përqendrohet në çështjet e zhvillimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor Ndërtimi i njohurive: • Ora e mësimit fillon me një prezantim dhe diskutim të nxënësve sipas grupeve. <i>Grupi I:</i> • Analiza e situatës politike në Rumani, Turqi dhe Bullgari. • Evidentimi i problemeve të shoqërive të këtyre vendeve. • Format e autoritarizmit të personifikuara nga udhëheqës të veçantë. • Problemet ekonomike të këtyre vendeve. <i>Grupi II:</i> • Evidentimi i zhvillimeve kryesore politike në Shqipëri, Jugosllavi dhe Greqi. • Analizë e problemeve të shoqërive të këtyre vendeve, duke pasur parasysh edhe elementet e veçanta të secilit shtet. • Trajtimi i zhvillimit ekonomik dhe rritja e varësisë nga vendet e tjera. • Pas prezantimit në klasë mund të zhvillohet një diskutim i nxitur nga mësuesi/ja nëpërmjet pyetjeve të mëposhtme ose nëse është e mundur të ftohet një historian për të zhvilluar një bisedë mbi periudhën në fjalë. -Si mendoni ju pse problemet etnike dhe fetare ishin ato që shoqëronin historinë e Ballkanit? Lidhjeni këtë fakt me zhvillimet në ditët e sotme. -Pse Ballkani ishte i prirur drejt qeverisjeve autoritare? Pyetje për diskutim Situata quhet e realizuar nëse <i>nxënësit</i>: 1)Analizon rrethanat historike dhe situatën ndërkombëtare në të cilën gjendej Ballkani pas Luftës së Parë Botërore; 2)Analizon ndikimin e ideve perëndimore në politikat ballkanike dhe rolin e Fuqive të Mëdha; 3)Përcakton zhvillimin e jetës politike në vendet e Ballkanit, duke i krahasuar dhe evidentuar të përbashkëtat e të veçantat; Vlerësimi: <i>Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënëtit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</i>	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shkenca shoqërore	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Veprimtari praktike: Kontributi i shqiptarëve në mbrojtjen e hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore		Situata e të nxënësve: -Politikat antisemitike të nazistëve gjermanë. -Rrethanat historike në të cilat vepruan shqiptarët. -Roli i shqiptarëve në grupin e popujve që shpëtuan hebrenjtë.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Përdor funksionet gjuhësore të teksteve historike, fjali komplekse për shpjegimin e marrëdhënieve shkak-pasojë. Kompetenca e të nxënësve - Parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumente dhe burime. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin - Zhvillon një kërkim individual ose në grup për kryerjen e një veprimtarie në histori. Kompetenca digjitale - Akceson një sërë burimesh digjitale të informacionit dhe analizon në mënyrë kritike këto burime.		Fjalët kyçe <i>Hebrenj,</i> <i>Antisemitizëm,</i> <i>Tradita e besës, mikpritjes,</i> <i>Holokausti,</i> <i>Nazizmi,</i>	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore -Vlerëson kontributin e shqiptarëve në mbrojtjen e popullsisë hebraike gjatë Luftës së Dytë Botërore -Analizon arsyet e mbrojtjes së hebrenjve në Shqipëri duke evidentuar besën, tolerancën dhe mikpritjen		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Me letërsinë, qytetarinë.	
Burimet: Libri i nxënësit, interneti, foto, dëshmi të familjarëve që strehuan hebrenjtë, literaturë historike etj.			

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
Metodologjia: Punë kërkimore në grupe/bisedë.	
Organizimi i orës së mësimt: • Për organizimin e kësaj veprimtarie praktike mësuesi ka udhëzuar dhe ka ndarë grupet dhe detyrat për secilin prej tyre që më parë. -Grupi I ka si objektiv trajtimin e çështjeve që lidhen me historinë e hebrenjve dhe antisemitizmin në periudhën naziste. -Grupi II do të shqyrtojë çështjen e reagimit të shqiptarëve në mbrojtje të hebrenjve. Ndërtimi i njohurive: • Nxënësit prezantojnë dhe diskutojnë sipas grupeve dhe tematikave rreth të cilave kanë hulumtuar. -Grupi I: Përqendrohet në: -evidentimin e momenteve kryesore në historinë e hebrenjve; -situatën e krijuar në Gjermani gjatë qeverisjes naziste në vitet 1933-1939; -përkeqësimin e situatës së hebrenjve pas fillimit të Luftës së Dytë Botërore; -analizën e projektit nazist të “zgjidhjes finale” dhe hapat konkretë të ndjekur për realizimin e tij. -Grupi II: Përqendrohet në: -marrëdhëniet historike mes hebrenjve dhe shqiptarëve; -rolin e individëve dhe familjeve shqiptare në mbrojtjen e hebrenjve; shqiptarëve në mbrojtjen e Hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore. -rolin e institucioneve shqiptare gjatë pushtimit fashist dhe nazist në mbrojtjen e hebrenjve; -evidentimin e arsyeve të sjelljes së shqiptarëve ndaj hebrenjve dhe rolin e traditës si besa, mikpritja, toleranca fetare etj. -Pas prezantimit të nxënësve organizohet në klasë një bisedë rreth fakteve dhe dëshmive të sjella rreth kontributit të shqiptarëve . Pyetje për diskutim Situata quhet e realizuar nëse nxënësit: 1) Evidentojnë rrethanat historike në të cilat vepruan shqiptarët; 2) Analizojnë politikat antisemitike të nazistëve gjermanë dhe në mënyrë specifike, përshkallëzimin e këtyre politikave nga ardhja e nazistëve në pushtet deri në fundin e Luftës së Dytë Botërore; 3) Vlerëson rolin e shqiptarëve në grupin e popujve që shpëtuan hebrenjtë.	
Vlerësimi: <i>Vlerësimi i nxënësit mbështet në rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</i>	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Bota menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore (1945-1946).			
Situata e të nxënës: a) Procesi i përcaktimit të kuadrit ndërkombëtar dhe fatit të vendeve humbëse. b) Krijimi dhe roli i OKB-së në infrastrukturën e marrëdhënieve ndërkombëtare. c) Lufta e ftohtë dhe ndarja në dy kampe kundërshtarë.			
Fjalët kyçe: <i>Luftë e ftohtë,</i> <i>konferencë ndërkombëtare,</i> <i>denazifikim,</i> <i>OKB,</i> <i>NATO,</i> <i>Traktati i Varshavës</i>			
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe Kompetenca e të nxënës - Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet për një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet. Kompetenca e të mësuarit - Zhvillon kompetencën e të mësuarit për realizimin e kërkimit historik. Kompetenca qytetare - Zhvillon kompetencën qytetare për të shqyrtuar në mënyrë kritike sjelljet, motivet dhe veprimet e njerëzve në të shkuarën që mund të jenë rezultat i ndryshimit të qëndrimeve shoqërore.			
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - Evidenton konferencat ndërkombëtare gjatë Luftës II Botërore dhe shpjegon vendimet e tyre. - Vë në dukje procesin e krijimit të OKB-së dhe organizmat përbërës të saj, si dhe ndikimin e saj në politikën ndërkombëtare. - Analizon konceptin “Luftë e Ftohtë” dhe rolin e organizatave ushtarako-politike si: NATO dhe Traktati i			


Varshavës.	
Burimet: • Libri i nxënësit • Interneti - www.zeriamerikes.com/a/lufta-e-ftohte-dhe-marredheniet-midis-dv.../518867.html - www.history.com/topics/cold-war/cold-war-history	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: • Me letërsinë: veprat letrare që trajtojnë tematikat historike të periudhës në fjalë. • Me gjeografinë: ndryshimet territoriale të pasluftës.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
Metodologjia: Shpjegim/stuhi mendimesh	
Organizimi i orës së mësim: • Mësuesi/ja paraqet një hartë të Evropës dhe fton nxënësit të përcaktojnë ndryshimet territoriale gjatë Luftës II Botërore dhe më pas ato të ndodhura pas përfundimit të Luftës. • Tregon një foto nga gjyqi i Nurembergut dhe nxit nxënësit që të komentojnë konceptin e denazifikimit. • Mësuesi/ja shkruan në tabelë emrat e organizatave të mëposhtme dhe kërkon nga nxënësit të thonë se çfarë dinë për to.	KNER Tregu i Përbashkët NATO Traktati i Varshavës ↑ • Mësuesi/ja shkruan në tabelë çështjet kryesore ku do të përqendrohet gjatë shpjegimit.
Ndërtimi i njohurive: • Gjatë shpjegimit aktivizohen nxënësit nëpërmjet pyetjeve të ndryshme, duke i nxitur ata në diskutim. Mësuesi e paraqet mësimin të përmbledhur në tabelë p.sh.:	
<i>Konferencat ndërkombëtare</i>	- Datat e zhvillimit të tyre. - Pjesëmarrësit në to. - Vendimet e tyre

Trajtimi i vendeve humbëse

- Pozita ndërkombëtare e vendeve humbëse të luftës.
- Ndryshimet territoriale (territoret që ndërrojnë sovranitet).
- Proceset e brendshme (denazifikim, defashistizim, dënim i krimeve të luftës).

Përpjekjet për vendosjen e një paqjeje të qëndrueshme - organizmat e OKB-së

- konferencat ndërkombëtare (Jaltë, Potsdam, vendimet).
- krijimi i OKB-së (Karta e Atlantikut, konferenca e San Franciskos, rregullat e funksionimit).



Lufta e Ftohtë

- Baza ideologjike dhe përplasja e interesave të superfuqive.
- Blloqet kundërshtare dhe organizmat e tyre.
- Konfliktet ndërkombëtare ku manifestohet Lufta e Ftohtë.

Pyetje për diskutim Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja: 1) Identifikon përpiqjet për krijimin e një rendi të ri ndërkombëtar. 2) Njeh ndryshimet territoriale të bëra pas Luftës II Botërore. 3) Interpretton konceptin “Luftë e Ftohtë” dhe evidenton blloqet kundërshtare dhe organizmat e tyre.	Vlerësimi: <i>Vlerësimi i nxënësit mbështetet në rezultatet e të nxënëti të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</i>	Detyrat dhe puna e pavarur: • Nxënësve u jepet si detyrë të shpjegojnë përse paqja e arritur në Konferencën e Parisit quhet edhe “paqe e papërfunduar”.	
--	---	---	--

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE


Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Bashkimi Sovjetik (1945-1990)		Situata e të nxënës: a) Roli i Bashkimit Sovjetik në botën e pasluftës. b) Ndryshimi i klimës së brendshme dhe të jashtme në Bashkimin Sovjetik nën Hrushovin. c) Kriza e sistemit sovjetik dhe përpjekja për reformimin e Gorbaçovit.	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Shqyrton, ndërton analizën dhe parashtron pyetje, për të argumentuar, për të diskutuar informacionin historik. Kompetenca e të nxënës - Parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet duke u bazuar në argumente dhe burime. Kompetenca qytetare • Shqyrton burimet historike për të kuptuar çështjet shoqërore dhe se si parime të ndryshme kanë ndikuar në çështjet njerëzore.		Fjalët kyçe <i>Punë vullnetare,</i> <i>Kampi socialist,</i> <i>bashkekzistencë paqësore,</i> <i>burokraci,</i> <i>nomenklaturë,</i> <i>glasnost dhe perestrojka.</i>	
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore - shpjegon rolin e BRSS në vitet e para të pasluftës. - vë në dukje rolin e Hrushovit në procesin e destalinizimit dhe reformave liberalizuese dhe reagimin e pjesës konservatore në udhëheqjen sovjetike; - analizon rolin e BRSS kundrejt vendeve të kampit komunist; - gjykon mbi reformat e Gorbaçovit në drejtim të politikës dhe ekonomisë për reformimin e sistemit socialist sovjetik.			

Burimet: • Libri i nxënësit, • Interneti - https://www.ushmm.org/wlc/en/article.php?ModuleId=10005506 - www.shsu.edu/~his_ncp/Soviet2.html - www.history.com/topics/cold-war/berestroika-and-glasnost	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: • Me temat e tjera: Blloku Lindor gjatë viteve 1945-1989.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
Metodologjia: Diskutim/stuhi mendimi Organizimi i orës së mësim: • Mësuesi/ja drejton pyetje për të hapur diskutim në klasë duke nxitur të gjithë nxënësit të marrin pjesë në të. - Cila ishte baza ideologjike e ekzistencës së BRSS? - Cilat ishin tiparet politike dhe ekonomike të BRSS? - Në çfarë pozitash të brendshme dhe të jashtme doli BRSS nga Lufta II Botërore? - A mendoni se sistemi sovjetik kishte nevojë për reforma dhe në ç' drejtime? Ndërtimi i njohurive: • Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë mësimin. • Për secilën prej pjesëve të mësimi cakton një grup nxënësish. Një pjesë e grupit përgatit pyetjet që do t'ia drejtojnë pjesës tjetër me qëllim zbërthimin e pjesës. • Më pas, mësuesi vazhdon me shpjegimin duke u përqendruar në drejtimit e mëposhtme: • <i>Rëndimi i situatës ekonomike dhe politike në vitet e fundit të sundimit të Stalinit:</i> - Gjendja ekonomike e pasluftës. - Rritja e terrorit të shtetit totalitar. - Shtrirja e influencës sovjetike në Evropën Lindore. • <i>Nevoja për reformim e shtetit dhe e ekonomisë sovjetike.</i> - Kongresi 20 dhe denoncimi i "kultit të Stalinit" nga ana e Nikita Hrushovit. - Klima liberalizuese dhe lirimi masiv i të burgosurve politikë. - Politika e jashtme e bashkekzistencës paqësore • <i>Reaksioni i brendshëm ndaj reformave të Hrushovit.</i>	

- Cili ishte kuptimi i termit “Restaurimi brezhnjevian”? - Stanjacioni ekonomik dhe politik që thellon krizën ekonomike sovjetike. • <i>Reformat e Gorbaçovit.</i> - Situata ekonomike në BRSS - Mungesa e stabilitetit në udhëheqjen sovjetike. - Hapat e ndërmarra nga Gorbaçovi për reformimin e sistemit sovjetik { në planin politiko-shoqëror (glasnost); në planin ekonomik (perestrojka); në fushën e politikës së jashtme.	
Pyetje për diskutim Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja: 1) Evidenton gjendjen ekonomike, shoqërore dhe politike në BRSS pas Luftës II Botërore. 2) Shpjegon procesin e destalinizimit dhe liberalizimit në periudhën e Hrushovit. 3) Vë në dukje hapat prapa të ndërmarra pas rrëzimit të Hrushovit dhe ardhjes në pushtet të Brezhnjev. 4) Analizon reformat liberalizuese të Gorbaçovit dhe efektet e tyre mbi shoqërinë, politikën dhe ekonominë sovjetike. 4) Krahason reformat e Hrushovit dhe Gorbaçovit, duke vënë në dukje të përbashkëtat dhe dallimet mes tyre.	
Vlerësimi: <i>Vlerësimi i nxënësit mbështetet në rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</i>	
Detyrat dhe puna e pavarur: • Nxënëseve u jepet detyrë të identifikojnë disa ngjarje ndërkombëtare që erdhën si pasojë e Kongresit XX dhe procesit të destalinizimit nga ana e Hrushovit. •	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: SHBA (1945-2000)		Situata e të nxënimit: a) SHBA pas Luftës II Botërore dhe rritja e rolit politik dhe ekonomik të saj në marrëdhëniet ndërkombëtare. b) Kursi i "Kufirit të Ri", periudha e tensioneve sociale dhe raciale, lufta e Vietnamit. c) Reformat neokonservatore të Reganit, përfundimi i "Luftës së Ftohtë". d) Rritja ekonomike dhe reformat progresiste të Klintonit.	
Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Shqyrton, ndërtton, analizon dhe parashtron pyetje për të argumentuar, informacionin, konceptet historike. Kompetenca e të nxënimit Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet për një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet Kompetenca qytetare Shqyrton burimet historike për të kuptuar çështjet shoqërore dhe se si parime të ndryshme kanë ndikuar në qështjet mjerrëzore.		Fjalët kyçe <i>Kursi i "Kufirit të Ri",</i> <i>neokonservatorizëm,</i> <i>lëvizje feministe,</i> <i>hippie,</i> <i>"Lufta e yjeve"</i>	
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - evidenton situatën e SHBA-së pas Luftës II Botërore; - analizon rolin e ri politik të SHBA-së si pengesë për përhapjen e ndikimit sovjetik. - shpjegon politikat reformiste të Kenedit dhe Xhonsanit dhe ndikimin e luftës së Vietnamit në gjendjen e brendshme të SHBA-së; - gjykon mbi tensionet dhe përplasjet sociale dhe raciale në			

SHBA. - krahason kursin neokonservator të Reganit dhe kursin reformist progresist të Klintonit.	Burimet: • Libri i nxënësit, interneti.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: • Me temat e mëparshme: Bota menjëherë pas Luftës II Botërore (1945-1946). • Me letërsinë: Botime të periudhës në fjalë. • Me ekonominë: Konceptet ekonomike, teoritë ekonomike.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve		
Metodologjia: Stuhi mendimesh/ të menduarit kritik përmes leximit	Organizimi i orës së mësimt: - Mësuesi/ja shkruan në tabelë SHBA dhe kërkon nga nxënësit të rikujtojnë njohuritë që kanë mësuar rreth këtij shteti. Për t'i orientuar mësuesi/ja drejton pyetje të ndryshme. - Përgjigjet e nxënësve mund të shënohen në dërrasë si më poshtë:  <pre> graph TD SHBA((SHBA)) <--> EMZ["E Marta e Zezë"] SHBA <--> DEK[Depresioni ekonomik] SHBA <--> KR[Kursi i Ri] SHBA <--> BNJ[Bursa e Nju-Jorkut] SHBA <--> KE[kejsianizëm] SHBA --> IP[Investime publike] </pre>	
Ndërtimi i njohurive	• Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë pjesën e parë të mësimt dhe të përshkruajnë gjendjen në ShBA pas Luftës II Botërore. • Pasi pyet disa nxënës, mësuesja shënon në dërrasë të zezë:	
ShBA pas luftës	→ Kritje e ndikimit në arenën ndërkombëtare, kthimi në “superfuqi” . → Kundërvënje ndaj përhapjes së komunizmit dhe ndikimit sovjetik, “doktrina Truman”, “plani Marshall” . → Zhvillim i vrullshëm ekonomik.	

Vitet '60- '70	→ reforma liberale të presidentit Kenedi (“Kursi i Kufirit të Ri”) → Përpjekjet për zgjidhjen e problemeve shoqërore dhe raciale, lëvizjet studentore dhe feministe. → ndikimi i luftës së Vietnamit në politikën dhe shoqërinë amerikane.
Vitet '80- '2000	→ Politikat neokonservatore të Reganit. → Përpjasja me BRSS, kundërvënja aktive, “Lufta e yjeve”. → Presidenca Klinton, reformat progresive, rritje ekonomike e qëndrueshme. → Roli i SHBA-së në pavarësinë e Kosovës.
	• Mësuesi/ja pyet në mënyrë specifike: Cilat ishin shkaqet e problemeve raciale në SHBA dhe përpjekjet për tejkalimin e tyre? Pas përgjigjeve mësuesi/ja shënon në dërrasë. → 1-Rrënjët historike të diskriminimit. → 2-Ndarja Veri-Jug lidhur me problemin racial ende e pranishme në shek. XX. → 3-Përpjekjet e popullsisë me ngjyrë për përparim dhe emancipim (Martin Luther King). → 4-Politikat publike për zhdukjen e segregacionit dhe diskriminimit racial.
	Pyetje për diskutim Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja: 1) Përkrauan gjendjen në ShBA pas Luftës II Botërore. 2) Evidenton rolin e SHBA vs. BRSS dhe përhapjes së doktrinës komuniste në botë. 3) Shpjegon synimet e programit “Kufiri i Ri” dhe reformat e presidentit Xhonsn si vazhdim i këtij programi. 4) Analizon politikat neokonservatore të Reganit. 5) Gjykon mbi politikat liberale progresive të presidentit Klinton.
	Vlerësimi: <i>Vlerësimi i nxënësit mbështetet në rezultatet e të nxënëtit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</i>
	Detyrat dhe puna e pavarur: • Nxënësve u jepet detyrë rubrika “Proveni veten duke shkruar”, në tekst.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedis	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Dekolonizimi		Situata e të nxënës: a) Situata koloniale pas Luftës II Botërore. b) Faktorët që ndikojnë në ngritjen e frymës antikoloniale në botë. c) Rrugët e ndryshme për fitimin e pavarësisë nga vendet koloniale.	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e të menduarit - Zhvillon të menduarit për realizimin e kërkitimit historik. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin - Harton hapat që duhet të ndjekë për realizimin e një kërkitimi historik për një ngjarje të dhënë. Kompetenca personale - Kupton nëpërmjet kërkitimit historik përvojën e njeriut, ndryshimet që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave.		Fjalët kyçe: <i>sistem kolonial</i> <i>metropol</i> <i>dekolonizim</i> <i>rezistencë paqësore</i> <i>sovranitet</i> <i>referendum</i>	
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - vë në dukje situatën e vendeve koloniale pas përfundimit të Luftës II Botërore; - vlerëson rolin e elitave kombëtare në lëvizjen për dekolonizim; - analizon krijimin e kushteve për lindjen dhe rritjen e lëvizjeve antikoloniale në botë; - krahason rrugët e ndryshme të ndjekura për fitimin e pavarësisë nga ana e vendeve të ndryshme koloniale.			

Burimet: • Libri i nxënësit, interneti.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: • Me gjeografinë: Shtrirja territoriale e kolonive dhe krijimi i vendeve të reja gjatë progresit të procesit të kolonizimit.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
Metodologjia: Të menduarit logjik/hap pas hapi/punë në grupe Organizimi i orës së mësim: • Mësuesi/ja tërheq vëmendjen e nxënësve, duke i futur ata në brendësi të temës. - Cili ishte procesi i formimit dhe roli i perandorive koloniale? - A ishte kolonizimi një proces pozitiv apo negativ për popullsitë e vendeve të kolonizuara? - Cila ishte rëndësia e kolonive për ekonominë e metropoleve? - Cilat ishin politikat e ndjekura nga kolonizatorët në drejtim të popullsisë të vendeve të kolonizuara? Ndërtimi i njohurive: Mësuesi/ja ndan klasën në grupe duke caktuar për secilin grup kërkesat që duhet të plotësojë pas leximit të mësim. <i>Grupi parë:</i> - Cilat ishin kushtet që nxitën rritjen e lëvizjeve anti-kolonialiste? - Rënia e ndikimit të vendeve kryesore kolonizatore pas Luftës II Botërore. - Rritja e ndërgjegjësimit në radhët e popullsisë të kolonizuara. - Roli i superfuqive (SHBA dhe BRSS) <i>Grupi i dytë:</i> - Evidentoni vendet që arritën pavarësinë në rrugë paqësore dhe analizoni hapat kryesorë të këtij procesi. - Cilat ishin kushtet që bënë të mundur suksesin e rrugës paqësore për pavarësi? - Çfarë kuptohet me termin “gandizëm”? - Cili ishte raporti mes ish-kolonive dhe metropoleve të tyre në periudhën post-koloniale? - Flisni për figurën e Nelson Mandelës dhe rolin e tij si simbol i luftës kundër diskriminimit racial. <i>Grupi i tretë :</i> - Analizoni tiparet e lëvizjeve të armatosura për pavarësi.	

- Cilat ishin disa prej lëvizjeve kryesore të armatosura anti-koloniale? - Cili ishte qëndrimi i shteteve kolonizatore ndaj aspiratave të popullsisive vendase? - Krahasoni lëvizjet çlirimtare në Algjeri dhe Vietnam duke vënë në dukje të përbashkëtat dhe dallimet mes tyre? Pyetje për diskutim Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja: 1) Shpjegon situatën e vendeve koloniale pas Luftës II Botërore. 2) Analizon kushtet dhe rrethanat që nxitën lëvizjet anti-kolonialiste. 3) Argumenton rrugët e ndjekura nga vende të ndryshme për fitoren e pavarësisë.	Vlerësimi: <i>Vlerësimi i nxënësit mbështetet në rezultatet e të nxënëtit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</i>
Detyrat dhe puna e pavarur: • Nxënësve u jepet detyrë rubrika “Mendo si historian” në tekst.	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Italia (1945-2000)		Situata e të nxënit: a) Rivendosja e regjimit demokratik dhe ndryshimi i formës së regjimit në Itali pas Luftës II Botërore. b) Veçoritë e zhvillimit ekonomik italian. c) Jeta politike në Itali dhe tiparet e saj.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe Kompetenca për jetën sipërmarrjen dhe mjedisin Diskuton individualisht ose në grup për rëndësinë që ka e shkuara në kuptimin e të tashmes dhe perspektivën e të ardhmes. Kompetenca e të menduarit Zhvillon të menduarit për realizimin e kërimit historik. Kompetenca e të nxënit Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve historike dhe shoqërore.		Fjalët kyçe: <i>republikë,</i> <i>plani Marshall,</i> <i>Traktati i Romës</i> <i>“mrekullia ekonomike italiane”,</i> <i>privatizim,</i> <i>qeverisje me koalicion</i>	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore - përcakton hapat e tranzicionit politik dhe institucional në Itali në vitet e para të pasluftës; - shpjegon ecurinë e zhvillimit ekonomik të vullshëm në Itali; - analizon faktorët që e mundësuan “mrekullinë ekonomike italiane”; - shpjegon veçoritë e skenës politike italiane; - gjykon mbi ndryshimet politike në Itali në vitet '90 të shek. XX.			


Burimet: • Libri i nxënësit, interneti.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: • Me temat e mëparshme: Bota menjëherë pas Luftës II Botërore (1945-1946). • Me ekonominë: Konceptet ekonomike, teoritë ekonomike. Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Metodologjia: Parashikim me terma paraprakë /të kuptuarit përmes leximit Organizimi i orës së mësimit: • - Mësuesi/ja shkruan në tabelë (ose vendos figura): <pre> graph LR A[Referendum] --> B[Republikë] B --> C[Koalicion politik] C --> D[Mrekulli ekonomike italiane] D --> E[korrupsion] </pre> • Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të thonë se çfarë dinë për këto fjalë dhe pasi nxit një diskutim të shkurtër, udhëzon nxënësit të lexojnë mësimin. Ndërtimi i njohurive: • <i>Hapi i parë: Pasi nxënësit lexojnë pjesën e parë të mësimit mësuesi/ja drejton pyetjet:</i> - Cila ishte gjendja në Itali pas përfundimit të Luftës II Botërore? Si u administrua kalimi nga diktatura në demokraci? - Cilat ishin rrymat politike në Italinë e pasluftës? Italia menjëherë pas Luftës II Botërore { Vend humbës, humbi territore, paguan dëmshpërblime, nën kontrollin aleat. Ndryshimi i formës së qeverisjes nga monarki në republikë. Partia Komuniste Italiane kishte influencë të madhe në vend. Italia rreshtohet në kuadrin e aleancave perëndimore. • <i>Hapi i dytë: Pasi nxënësit lexojnë pjesën e dytë të mësimit, mësuesi/ja pyet:</i> - Cilat janë veçoritë e zhvillimit të ekonomisë italiane në vitet '50 – '70 të shek. XX? - Përse kjo periudhë quhet “mrekullia ekonomike italiane”? - Cilat janë politikat ekonomike të ndjekura nga autoritetet italiane pas Luftës II Botërore?
--	--

Ekonomia italiane	- rimëkëmbja në vitet e pasluftës, ndihma nëpërmjet planit Marshall. - orientim drejt nxihtjes së iniciativës private dhe ekonomisë së tregut. - rritje të larta të rritjes ekonomike. - modernizim i bazës ekonomike. - sektorët kryesorë: industria, turizmi, infrastruktura. - anëtarësimi në Tregun e Përbashkët Evropian.
	• <i>Hapi i tretë: Pasi nxënësit lexojnë pjesën e dytë të mësimin, mësuësia pyet:</i> - Cili është konfigurimi i skenës politike italiane pas Luftës II Botërore? - Cili është modeli i qeverisjes në Italinë e pasluftës II Botërore? - Sipas mendimit tuaj, cilat janë shkaqet e mungesës së stabilitetit në qeverisje? - Si ndryshoi politika italiane në fillim të viteve '90 të shek. XX? Cilët ishin faktorët që ndikuan në këto ndryshime?
Politika italiane	- Një numër relativisht i madh partish politike. - Dominim i Partisë Demokratike (për shkak edhe të mbështetjes nga Kisha Katolike). - Sistem elektoral proporcional i pastër. - Mbajtja e Partisë Komuniste jashtë pushtetit. - Qeverisja me koalicion të gjera politike, qeveri përgjithësisht me jetë të shkurtër. - Skandale korupsioni që përfshinë një pjesë të madhe të klasës politike italiane. - Ndryshime politike me parti historike që zhduken dhe parti të reja që hyjnë në skenën politike.
	Pyetje për diskutim Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja: 1) Përcakton hapat e procesit të tranzicionit të Italisë nga diktatura në demokraci. 2) Identifikon forcat kryesore politike në Italinë e pasluftës II Botërore. 3) Analizon ecurinë e ekonomisë italiane, duke u përqendruar në faktorët e saj të suksesit, në rimëkëmbjen nga lufta dhe rritmet e saj të zhvillimit. 4) Gjykon mbi zhvillimet në skenën politike italiane në periudhën e pasluftës.
Vlerësimi: <i>Vlerësimi i nxënësit mbështetet në rezultatet e të nxënësit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</i>	
Detyrat dhe puna e pavarur: • Nxënëset u jepet si detyrë rubrika “Hulumtoni dhe diskutoni”.	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Franca 1945-2000			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e të menduarit - Zhvillon të menduarit për realizimin e kërimit historik. Kompetenca e të nxënit - Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake. Kompetenca qytetare - Shqyrton burimet historike për të kuptuar ndikimin e tyre në çështjet shoqërore dhe njerëzore.		Situata e të nxënit: a) Gjendja në Francë pas Luftës II Botërore. b) Ndryshimet politike dhe institucionale në Francë. c) Tensionet sociale dhe kriza e kolonive franceze. d) Zhvillimi ekonomik i Francës.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe: Kompetenca e të menduarit - Zhvillon të menduarit për realizimin e kërimit historik. Kompetenca e të nxënit - Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake. Kompetenca qytetare - Shqyrton burimet historike për të kuptuar ndikimin e tyre në çështjet shoqërore dhe njerëzore.		Fjalët kyçe <i>republikë parlamentare,</i> <i>republikë presidenciale,</i> <i>demonstrata studentore,</i> <i>pragmatizëm,</i> <i>integrim evropian.</i>	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - evidenton tiparet e sistemit politik në Francën e pasluftës; - shpjegon situatën e Francës me kolonitë e saj; - grykon mbi tensionet sociale dhe protestat studentore në Francë; - argumenton nevojën për ndryshime politike dhe institucionale si përgjigje ndaj tensioneve sociale dhe ekonomike; - analizon tiparet e sistemit ekonomik francez.			
Burimet: Libri i nxënësit, interneti, biblioteka e shkollës.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Me temat e mëparshme: Bota menjëherë pas Luftës II Botërore.	

	• Me letërsinë: Botime të periudhës në fjalë.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
Metodologjia: Pyetje –përgjigje/ punë në grupe/hartë e koncepteve	
Organizimi i orës së mësimit: • Mësuesi/ja rikujton njohuri të nxënësve që kanë lidhje me temën e re, duke drejtuar pyetje të ndryshme si p.sh. : - Cila ishte situata në Francë pas përfundimit të Luftës II Botërore? - Cilat ishin problemet e Francës me kolonitë e saj? Si reflektohet kjo në zhvillimet e politikës së saj të brendshme? - A mendoni se lufta në Francë pati pasoja të rënda? • Pasi dëgjon mendimet e nxënësve, mësuesi/ja udhëzon të lexohet mësimi.	
Ndërtimi i njohurive • Mësuesi/ja pasi nxënësit lexojnë mësimin, e ndan klasën në tre grupe dhe shkruan në tabelë tri konceptet kryesore rreth të cilave do të ndërtohet mësimi, si dhe u kërkon nxënësve të ndërtojnë hartën e secilit prej koncepteve sipas grupeve. • Pasi nxënësit punojnë në grupe, mësuesi/ja cakton dy anëtarë të grupit për të prezantuar informacionin në dërrasë, nëpërmjet hartave të konceptit, të cilat mund të paraqiten si më poshtë:	
-Situata politike dhe sociale në Francë ⇓ - gjenerali De Gol ishte personaliteti kryesor; - republikë parlamentare; - probleme të stabilitetit të politikës së brendshme; - protesta studentore dhe të punëtorëve.	Problemet me kolonitë ⇓ - kriza me kolonitë; - lufta e Indokinës; - lëvizja çlirimtare në Algjeri; - qëndrimi politik kundër pavarësisë të kolonive; - ndikimi në politikën e brendshme.

Ndryshimet institucionale  Zhvillimi ekonomik i Francës - Politika dirizhiste në ekonomi - planifikim në fëmën e bashkëpunimit mes aktorëve ekonomikë - Plani Marshall - integrimi evropian - luhajtje mes shtetëzimeve dhe privatizimeve në ekonomi Pyetje për diskutim Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja: 1) Përshkruan gjendjen e Francës pas Luftës së II Botërore. 2) Identifikon problematikat e politikës së brendshme në vitet e pasluftës dhe më pas. 3) Analizon përpjekjet për rritjen e stabilitetit politik dhe social. 4) Argumenton tiparet e veçanta të ekonomisë franceze, sidomos në lidhje me rolin e shtetit në ekonomi. Vlerësimi: <i>Vlerësimi i nxënësit mbështetet në rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</i> Detyrat dhe puna e pavarur: • Nxënëseve u jepet detyrë të argumentojnë politikat ekonomike të qeverive franceze pas Luftës II Botërore.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Britania e Madhe (1945-2000)		Situata e të nxënësve: a) Tronditja e rolit të Britanisë së Madhe si fuqi e madhe botërore në vitet e pasluftës. b) Reformat me karakter social-ekonomik në vitet e para pasluftës. c) Dinamikat e politikave britanike dhe ndikimi i tyre në jetën shoqërore dhe ekonomike të vendit.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kryesë: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurisë - Përdor funksionet gjuhësore, fjali komplekse për shpjegimin e marrëdhënieve shkak-pasojë. Kompetenca e të nxënësve - Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme, i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën. Kompetenca personale - Kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njeriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, rëndësinë historike, ndryshimet dhe vazhdimësinë që ka pësuar shoqëria përgjatë kohërave.		Fjalët kyçe: <i>welfare state,</i> <i>Komonuelth,</i> <i>roli i shtetit në ekonomi,</i> <i>ekonomi mikse,</i> <i>trade unions.</i>	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore - Shpjegon përpjekjet e shoqërisë angleze për reformimin e sistemit elektoral. - Analizon tiparet e lëvizjeve politike dhe sociale në Angli. - Evidenton kërkesat e lëvizjes feministe në Angli.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - Me temat e mëparshme: Britania e madhe nga konservatorizmi drejt liberalizmit. - Me ekonominë: Konceptet ekonomike, teoritë ekonomike.	
Burimet: Libri i nxënësit, interneti.			

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Metodologjia:

Stuhi mendimesh /Ditar dypjesësh

Organizimi i orës së mësimit:

- Mësuesi/ja tërheq vëmendjen e nxënësve, duke i futur ata në brendësi të temës:
- Cilat janë forcat kryesore politike në Britaninë e Madhe?
- Cili ishte roli i Britanisë në marrëdhëniet ndërkombëtare para Luftës II Botërore?
- Cili ishte modeli ekonomik tradicional i Britanisë së Madhe?
- Në cilin bllok ndërluftues ishte e rreshtuar Britania gjatë Luftës II Botërore?

Ndërtimi i njohurive

- Mësuesi/ja ndërton një tabelë në formën e ditarit dypjesësh dhe udhëzon nxënësit ta plotësojnë në fletore.
- Pas përfundimit të punës nga nxënësit, mësuesja drejton pyetje dhe plotëson tabelën.

Koncepti	Komenti
Forcat politike në fillim të shek. XX	1- Partia konservatore 2- Partia laburiste
Reformat e qeverisë Atli	Sociale } - sistemi shëndetësor publik. - sistemi i sigurimeve shoqërore dhe në rast papunësie. - ndërtim banesash sociale. Ekonomike } - forcim i rolit të shtetit në ekonomi, - rritje taksash dhe bllokim i rritjes së pensioneve dhe pagave, - financime ndërkombëtare sidomos nga SHBA-ja.
Britania dhe procesi i dekolonizimit	- dobësi e Britanisë për shkak të pasojave të luftës, - politikë paqësore e qeverisë laburiste, - tërheqje përgjithësisht paqësore nga kolonitë britanike, - marrëdhënie e re me ish-kolonitë nëpërmjet Komonuelthit.

Zhvillimi i ekonomisë britanike	- rritje e konsumit dhe dyfishim i pagave, - ndryshime sektoriale në ekonomi me rritjen e sektorëve të rinj kundrejt atyre më tradicionale, - qëndrim i ftohtë kundrejt integritimit evropian.
Kursi neokonservator i Theçerit	- reduktim i rolit të shtetit në ekonomi, privatizime, - reduktim i borxhit publik, - nxitje e iniciativës private dhe sipërmarrjes, - konflikte të forta me sindikatat, - efekte pozitive në ekonomi, por e shoqëruar me rritje të nivelit të papunësisë.
“Rruga e Tretë” e kryeministrit Bler	- një alternativë e ndryshme nga kursi konservator dhe ai tradicional laburist, - politika social-demokrate me një sens modernizimi nëpërmjet: • nxitjes e iniciativës private, • vëmendje më e madhe në lidhje me problemet sociale.
Pyetje për diskutim Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja: 1) Identifikon sfidat e Britanisë së Madhe në periudhën e pasluftës dhe rrugët për kapërcimin e tyre. 2) Analizon tiparet kryesore të “Shtetit të Mirëqenies Sociale”. 3) Gjykon mbi masat e programit konservator të Theçerit. 4) Interpreton thelbin e “Rrugës së Tretë” të Blerit.	
Vlerësimi: <i>Vlerësimi i nxënësit mbështetet në rezultatet e të nxënëtit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</i>	
Detyrat dhe puna e pavarur: • Nxënësve u jepet detyrë të hulumtojnë lidhur me marrëdhëniet mes Britanisë së Madhe dhe Bashkimit Evropian sidomos nën dritën e referendumit për daljen nga kjo organizatë.	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Gjermania (1945-2000)		Situata e të nxënit: a) Gjermania si shtet humbës i Luftës II Botërore. b) Ndarja e Gjermanisë në dy shtete kundërshtarë ideologjike. c) Roli i RFGJ-së në ekonominë dhe politikën evropiane. d) Bashkimi i Gjermanisë pas shpërbërjes së Bllokut Komunist.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Zhvillon komunikimin për të kuptuar informacionin dhe ndërtuar njohuritë historike. Kompetenca e të menduarit - Zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të analizuar të shkuarën nëpërmjet informacionit. Kompetenca e të nxënit - Zbaton në mënyrë të pavarur ose në grup udhëzimet për një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.		Fjalët kyçe: <i>dëmshtëpërblime lufte,</i> <i>denazifikim,</i> <i>Muri i Berlinit,</i> <i>Ostpolitik,</i> <i>Gjermania e bashkuar.</i>	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore - evidenton pozitën e Gjermanisë në përfundim të Luftës II Botërore; - shpjegon drejtimit e ndryshme që morën dy shtetet gjermane me sisteme politiko-ekonomike të ndryshme; - analizon politikat e brendshme dhe të jashtme të RFGJ-së; - paraqet procesin e bashkimit të Gjermanisë dhe argumenton rolin udhëheqës të Gjermanisë së Bashkuar në kuadrin evropian.			

Burimet: Libri i nxënësit, interneti.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Me gjeografinë: kufijtë e RFGJ-së dhe RDGJ-së, si dhe të Gjermanisë së Bashkuar.
	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
Metodologjia: Pyetje - përgjigje/punë në grupe/ të menduarit kritik. Organizimi i orës së mësimt: Mësuesi/ja e fillon mësimin duke rikujtuar njohuri të nxënësve nëpërmjet pyetjeve: 1- Në cilin bllok ishte e rreshtuar Gjermania gjatë Luftës II Botërore? 2- Cili ishte trajtimi që iu rezervua Gjermanisë pas Luftës I Botërore? 3- Cilat ishin pasojat e këtij trajtimi? 4- A mendoni se pati ndryshim në konsiderimin e Gjermanisë në përfundim të Luftës II Botërore? Ndërtimi i njohurive: - Për zhvillimin e kësaj ore mësimi nevojitet punë përgatitore nga mësuesi/ja, ku ai/ajo ndan mësimin në tri pjesë kryesore dhe përgatit po aq fletë të bardha, ku të jetë shkruar pyetja ose çështja që do të trajtojë secili grup. - Pasi ndan klasën në katër grupe, mësuesi/ja kërkon të lexohet mësimi dhe secili grup të shkruajë në fletë përgjigjen e kërkesës përkatëse dhe të përgatiten për ta prezantuar përpara klasës. <i>Grupi I: Evidentoni dhe shpjegoni qëndrimin e Fuqive fituese të luftës kundrejt Gjermanisë.</i> Mësuesi /ja bën kujdes që nxënësit të radhitin në fletën e dhënë paraprakisht hapat dhe më pas aktivizon gjithë nxënësit e grupit për të shpjeguar secilin prej tyre. - Gjermania vend humbës (nën administrimin e fuqive aleate, dëmshtëpërblime, humbje terriroresh, denazifikim); - Gjermania – vend i ndarë si pasojë e përplasjeve mes Fuqive të Mëdha. - RFGJ – shtet demokratik (pjesë e Evropës së Bashkuar); RDGJ – vend komunist diktatorial (pjesë e Bllokut Komunist) - Berlini – vend ku materializohet konflikti mes SHB-së dhe BRSS-së.	

Grupi II: Shpjegon tiparet e zhvillimit politik-ekonomik të RFGJ-së dhe drejtimet e politikës së saj të jashtme.

- RFGJ tejkalon pasojat e luftës dhe hyn në rrugën e rritjes së shpejtë ekonomike (Plani Marshall);
- Konsolidim i shtetit demokratik të së drejtës dhe ekonomisë së tregut;
- Modeli i bashkëpunimit shtet-punëdhënës-punëmarrës, çelës i suksesit ekonomik gjerman;
- Orientim nga perëndimi, vend protagonist i proceseve integruese evropiane;
- Vëmendje ndaj marrëdhënieve me vendet e Bllokut Komunist (BRSS, RDGJ) - “Ostpolitik”

Grupi III: Shpjegon procesin e ribashkimit të Gjermanisë dhe rritjen e rolit të Gjermanisë së Bashkuar në Evropë dhe botë

- Revolucionet demokratike në Evropën lindore, specifiktisht në RDGJ.
- Shpërbërja e Bllokut Lindor.
- Shembja e Murit të Berlinit dhe ribashkimi i Gjermanisë.
- Gjermania e bashkuar – lokomotiva politike dhe ekonomike e Evropës së Bashkuar.

Pyetje për diskutim

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

- 1) Evidenton pozitën e Gjermanisë në përfundim të Luftës II Botërore dhe trajtimin e saj nga Aleatët fitues.
- 2) Analizon shkaqet dhe pasojat e ndarjes së Gjermanisë.
- 3) Shpjegon tiparet e zhvillimit ekonomik të RFGJ-së dhe pjesëmarrjen e saj në proceset integruese evropiane.
- 4) Analizon kushtet dhe procesin e ribashkimit të Gjermanisë, si dhe rolin e saj udhëheqës në kuadrin evropian dhe më gjerë.

Vlerësimi:

Vlerësimi i nxënësit mbështetet në rezultatet e të nxënëtit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.

Detyrat dhe puna e pavarur:

- Nxënëseve u jepet si detyrë një kërkim lidhur me mënyrat e përdorura prej shtetasve të Republikës Demokratike Gjermane (komuniste) për t’u arratisur nga vendi drejt lirisë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Jugosllavia gjatë viteve 1945-1990		Situata e të nxënësve: a) Themelimi dhe parimet bazë të ndërtimit të Federatës Jugosllave. b) Tiparet e politikës së jashtme të Jugosllavisë komuniste. c) Veçoritë e sistemit ekonomik jugosllav. d) Kriza ekonomike dhe politike jugosllave.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e të menduarit • Zhvillon të menduarit për realizimin e kërimit historik. Kompetenca digjitale • Komunikon, prezanton dhe parashtron njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet. Kompetenca personale • Kupton nëpërmjet kërkimit historik përvojën e njëriut, marrëdhëniet shkak-pasojë, rëndësinë historike dhe ndryshimet e shoqërisë përgjatë kohërave.		Fjalët kyçe: <i>shtet federativ,</i> <i>komintern,</i> <i>vetadministrim,</i> <i>vendet e paangazhuara,</i> <i>nacionalizëm.</i>	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - shpjegon krijimin dhe organizimin shtetëror të Federatës Jugosllave; - analizon shkaqet e konfliktit Jugosllavi-BRSS dhe pozicionin e veçantë në marrëdhëniet ndërkombëtare; - analizon karakteristikat e sistemit ekonomik jugosllav; - shpjegon shkaqet e krizës së sistemit ekonomik dhe politik jugosllav.			
Burimet: • Libri i nxënësit, interneti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: • Me temat e mëparshme: -Bota menjëherë pas Luftës II Botërore (1945-1946)	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Metodologjia:


Punë kërkimore /hartë e koncepteve


Organizimi i orës së mësimit:

- Mësuësi/ja ka udhëzuar që më parë nxënësit të hulumtojnë dhe grumbullojnë fakte, informacion rreth ndërtimit të shtetit jugosllav pas përfundimit të Luftës I Botërore dhe ngjarjeve të tij kryesore historike, deri në fillimin e Luftës II Botërore (materiali mund të prezantohet në *Powerpoint* nga nxënësit).

Ndërtimi i njohurive:

Mësuësi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë mësimin dhe ndërton skemën e mëposhtme, duke sqaruar nxënësit si ta plotësojnë atë.





- Kriza ekonomike dhe politike pati ndikim të drejtpërdrejtë në shpërbërjen e Jugosllavisë Federative në fillim të viteve '90 të shek. XX.

Pyetje për diskutim

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

- 1) Përshkruan organizimin e brendshëm të Federatës Jugosllave.
- 2) Analizon shkaqet e shpërbërjes së Jugosllavisë nga Blloku Komunist.
- 3) Shpjegon tiparet e sistemit të “vetadministrimit socialist”.
- 4) Analizon shkaqet e krizës së sistemit jugosllav dhe pasojat e saj afatgjata.

Vlerësimi:

Vlerësimi i nxënësit mbështetet në rezultatet e të nxënëtit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Nxënësve u jepet detyrë rubrika në librin e nxënësit “Provoni veten duke shkruar”.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Bllokut Lindor gjatë viteve 1945 - 1989		Situata e të nxënës: a) Ngjarjet e pasluftës në vendet e Evropës Lindore dhe vendosja e regjimeve komuniste. b) Karakteristikat e regjimeve komuniste dhe organizmat e Bllokut Komunist. c) Lëvizjet (shkaqet, ecuria) kundër regjimeve komuniste diktatoriale në vendet e Bllokut Lindor.	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e të nxënës - Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin - Diskuton individualisht ose në grup për rëndësinë që ka e shkua në të tashmen dhe perspektivat në të ardhmen. Kompetenca qytetare - Zhvillon mirëkuptimin ndërkulturor, duke vlerësuar kulturat, gjuhët dhe besimet e ndryshme.		Fjalët kyçe: <i>zgjedhje,</i> <i>ekonomi e planifikuar,</i> <i>KNER,</i> <i>"Solidarnost",</i> <i>demonstrata,</i> <i>revoltë e armatosur.</i>	
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - evidenton hapat e ndjekura në procesin e vendosjes së regjimeve komuniste në vendet e Evropës Lindore; - demonstroi në hartë shtrirjen e Bllokut Komunist; - shpjegon tiparet e politikës, ekonomisë dhe shoqërisë në vendet komuniste; - analizon situatat që çuan në nxitjen e lëvizjeve antikomuniste në vendet e Bllokut Komunist; - krahason të përbashkëtat dhe dallimet mes lëvizjeve antikomuniste në vende të ndryshme.			

Burimet: • Libri i nxënësit	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: • Me letërsinë: veprat letrare që trajtojnë tematikat historike të periudhës në fjalë. • Me gjeografinë: shtrirja e Bllokut Komunist • Me temat e mëparshme: Bota menjëherë pas Luftës II Botërore (1945-1946) Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Metodologjia: Parashikim me terma paraprakë/stuhi mendimesh/shpjegim. Organizimi i orës së mësim: • Mësuesi vendos në tabelë pamje nga krimet e regjimeve komuniste, si dhe nga revoltat dhe demonstratat kundër këtyre regjimeve. • Duke treguar fotot, i nxit ata të zbulojnë se për çfarë flet tema e re. • Mësuesi/ja shkruan në tabelë “Solidarnost” dhe u kërkon nxënësve të thonë se çfarë dinë për të, mendimet e tyre i paraqit në tabelë. <pre>graph TD; Solidarnost([Solidarnost]) --> Poloni[Poloni]; Solidarnost --> Rezistencë[Rezistencë paqësore]; Solidarnost --> Gjendje[Gjendje e jashtëzakonshme]; Solidarnost --> Përkrahje[Përkrahje popullore]; Solidarnost --> Kisha[Kisha Katolike]; Solidarnost --> Lëvizje[Lëvizje sindikale];</pre> • Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë mësimin dhe ndërkohë shkruan në tabelë çështjet kryesore ku do të përqendrohet gjatë shpjegimit.
---	---

Ndërtimi i njohurive:

- Gjatë shpjegimit aktivizohen nxënësit nëpërmjet pyetjeve të ndryshme, duke i nxitur ata në diskutim, mësimin e paraqet mësimin të përmbledhur në tabelë, p.sh.:

- proces gradual
- në fillim koalicion me partitë jokomuniste
- roli i Ushtrisë së Kuqe
- marrje e pushtetit pjesë-pjesë

Vendosja e regjimeve komuniste

në planin politik:

- roli sundues i partive komuniste në të gjitha fushat e jetës, private dhe publike;
- terrori dhe përndjekja e kundërshtarëve politikë, në çdo aspekt jetësor;
- mosrespektimi i të drejtave bazë të njeriut si: liria e shprehjes, e organizimit etj.;

në planin ekonomik:

- centralizim dhe planifikim shtetëror që kufizonte iniciativën private ekonomike;
- shtetëzizim dhe shoqërizim i ekonomisë (prona shtetërore dhe ajo e grupit u bë thuajse forma e vetme e pronësisë, duke e lënë pronën private në një rol të papërfillshëm)

Tiparet e regjimeve komuniste

- Informbyroja
- Traktati i Varshavës
- KNER

Organet e Bllokut Komunist

- Roli i liberalizimit hrushovian
- Protesta të punëtorëve (Poloni)
- Kryengritje e armatosur (Hungari)
- Opozita intelektuale (Çekosllovakia)



Disa lëshime nga ana e regjimeve komuniste

Revolta popullore kundër regjimeve komuniste

Pyetje për diskutim Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja: 1) Identifikon kushtet historike në të cilat u vendosën regjimet komuniste në vendet e Evropës Lindore. 2) Njeh shtrirjen gjeografike të Bllokut Komunist. 3) Analizon lëvizjet me karakter antikomunist në vendet e Bllokut Komunist.
Vlerësimi: <i>Vlerësimi i nxënësit mbështetet në rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</i>
Detyrat dhe puna e pavarur: • Nxënësve u jepet si detyrë të përgatisin një vështrim krahasues mes lëvizjeve antikomuniste në disa prej vendeve të Evropës Lindore dhe Qendrore, pjesë e Bllokut Komunist.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Fillimet e krizave të shek. XX. Lufta e Parë Botërore			
Situata e të nxënës: a) Proceset e përmbysjes së regjimeve komuniste në vendet e Evropës Lindore dhe Qendrore. b) Figurat dhe ngjarjet historike të këtyre proceseve. c) Fenomenet e periudhës postkomuniste.			
Fjalët kyçe <i>demokratizim i shoqërisë,</i> <i>reforma,</i> <i>sindikata të lira,</i> <i>pluralizëm politik,</i> <i>rënia e Murit të Berlinit.</i>			
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e të menduarit - Zhvillon mendimin kritik për të përzgjedhur burimet, për të analizuar të shkuarën nëpërmjet informacionit, për të dhënë argumente bazuar në burime. Kompetenca e të nxënës - Parashtron pyetje kërkimore dhe përgjigjet, duke u bazuar në argumente dhe burime. Kompetenca personale - Përdor aftësitë e komunikimit, punës në grup etj., për të prezantuar dhe argumentuar idetë e tij.			
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - analizon shkaqet që çuan në fillimin e Luftës së Parë Botërore; - përcakton në hartë frontet kryesore në të cilat u zhvillua Lufta e Parë Botërore; - analizon faktorët që çuan në fitoren e Antantës në Luftën e Parë Botërore.			

Burimet: Libri i nxënësit, interneti.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - Me temat e mëparshme: - Bota menjëherë pas Luftës II Botërore; - Blloku Lindor gjatë viteve 1945-1989.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
Metodologjia: Stuhi mendimesh/reportazh Organizimi i orës së mësimit: Mësuesi/ja shkruan në tabelë “revolucion demokratik” dhe kërkon nga nxënësit të rikujtojnë se ç’dinë për të, pra nxitet një diskutim paraprak lidhur me temën e re që do të zhvillohet, nëpërmjet njohurive që kanë nxënësit për këtë ngjarje nga klasat e mëparshme: <pre>graph TD; A([Evropa Lindore dhe Qendrore]) --> B([Revolucion demokratik]); C([Opozitë demokratike]) --> B; D([1989-1990]) --> B; E([Rezistencë paqësore]) --> B; F([Liberalizim]) --> B; B --> G([Pluralizëm politik]);</pre>	
Ndërtimi i njohurive - Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë mësimin dhe secili të mbajë shënime dhe të përgatitet ta paraqesë mësimin para klasës në mënyrë individuale (me qëllim që nxënësit të lexojnë mësimin, mësuesi i cakton pas leximit ata që do paraqesin informacionin në formën e një reportazhi në tabelë). - Mësuesi/ja drejton pyetjen dhe aktivizon disa nxënës të prezantojnë mësimin, duke shkruar në tabelë pikat kyçe të mësimit. <i>Si paraqitet situata në vendet komuniste të Evropës Lindore dhe Qendrore në fund të viteve ‘80?</i>	

Nxënësi paraqet në tabelë situatën e krijuar dhe faktorët që kushtëzojnë suksesin e lëvizjeve antikomuniste.

Evropa komuniste në fund të viteve '80 të shek. XX { - rënie ekonomike dhe e nivelit të jetesës.
- shtypje politike dhe mungesë lirie.
- klimë revolte në gjirin e shoqërisë së vendeve komuniste.
- grupe reformatore në gjirin e partive komuniste në pushtet.
- rënie e ndikimit sovjetik mbi vendet e Bllokut Komunist

• *Proceset demokratike*

- Polonia në pararojë për shkak të traditës së protestës dhe masivitetit të saj. Qeveria e parë jokomuniste.
- Hungaria, një miks mes reformatorëve në gjirin e partisë komuniste dhe sindikatave të lira jokomuniste.
- Çekosllovakia, frymë më represive nga ana e regjimit. Protesta masive çuan në rënien e regjimit komunist dhe lejinin e pluralizmit politik.
- Rumania, i vetmi vend ku pati gjakderdhje. Udhëheqësit komunistë u ekzekutuan.
- RDGJ, rënia e Murit të Berlinit ishte hapi përfundimtar i proceseve të demokratizimit në vendet e ish-Bllokut Komunist.
- *Tiparet e periudhës së tranzicionit në shoqëritë postkomuniste*
- Reforma në të gjitha fushat e jetës;
- Drejtimit kryesorë: liberalizimi i ekonomisë, transformimi i ekonomisë nga planifikimi i centralizuar drejt ekonomisë së tregut.
- Faza fillestare shënoi disa pasoja negative sidomos në fushën ekonomike (inflacion, papunësi, mbyllje fabrikash joeficiente).
- Më pas, pati një periudhë rritjeje të shpejtë ekonomike.
- Në këto vende u forcua shteti i së drejtës, zgjedhjet e lira, pluralizmi politik.
- Shtetet e ish-Bllokut Komunist u bënë pjesë e proceseve integruese evropiane.

Pyetje për diskutim

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

- 1) Përcakton shkaqet që çuan në pjekjen e klimës së protestës që solli përfundimisht rrëzimin e regjimeve komuniste.
- 2) Analizon faktorët e ndryshëm që kontribuan në fitoren e lëvizjeve antikomuniste.
- 3) Krahason të përbashkëtat dhe dallimet e proceseve demokratike në vende të ndryshme ish-komuniste.

Vlerësimi:

Vlerësimi i nxënësit mbështetet në rezultatet e të nxënëtit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.

Detyrat dhe puna e pavarur:

- Nxënësve u jepet detyrë rubrika “Mendoni në mënyrë kritike” në librin e historisë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Shpërbërja e BRSS-së dhe e Jugosllavisë			
Situata e të nxënësve: a) Tensionet me origjinë nacionaliste në Evropën postkomuniste. b) Efektet e padëshirueshme të reformave gorbaçoviane-shpërbërja e BRSS-së. c) Kriza e sistemit jugosllav çon në shpërbërjen mbi baza etnike të këtij shteti.			
Fjalët kyçe: <i>nacionalizëm,</i> <i>konflikte etnike,</i> <i>grusht shteti,</i> <i>shpërbërje,</i> <i>spastrim etnik.</i>			
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit - Përdor funksionet gjuhësore të teksteve historike, fjali komplekse për shpjegimin e marrëdhënieve shkak-pasojë, përdorimin e emrave, ndajfoljeve dhe mbiemrave për të përshkruar vendet, njerëzit. Kompetenca e të nxënësve - Ndërlidh temën me njohuritë dhe përvojat paraprahe. Kompetenca personale - Përdor aftësitë e komunikimit për të argumentuar idetë e tij.			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - evidenton pikat e nxehta të tensioneve etnike në Evropën postkomuniste. - shpjegon dinamikën e proceseve të shpërbërjes së shteteve shumëetnike; - përcakton konceptin “spastrim etnik”; - analizon pasojat e shpërbërjes së BRSS-së dhe Jugosllavisë.			


Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Metodologjia:

Stuhi mendimesh/ditari dypjesësh

Organizimi i orës së mësimi:

- Mësuesi/ja shkruan në tabelë “BRSS dhe Jugosllavia” dhe kërkon nga nxënësit të shprehin lirshëm se ç’dinë për të.



Ndërtimi i njohurive:

- Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të lexojnë mësimin dhe ndërkohë ndërton tabelën duke vendosur në të edhe konceptet kryesore mbi të cilat do të ndërtohet mësimi i ri. Duke u drejtuar pyetje nxënësve, mësuesi/ja plotëson tabelën:

Koncepti	Komenti
Rritja e frymës nacionaliste	-Rënia e regjimeve komuniste solli mungesë stabiliteti. -Pjesë të elitave politike u transformuan në nacionalistë, kryesisht për mbajtjen e pushtetit. -Shpërbërja herë në mënyrë paqësore e herë në mënyrë të dhunshme
Shpërbërja e BRSS	-reformat liberalizuese të Gorbaçovit. -probleme të shumta ekonomike. -tensione etnike. -dalje e kombeve të ndryshme nga orbita e qeverisë qendrore. -grusht shteti për të frenuar proceset reformuese dhe dezintegruese.

	-25 dhjetori 1991 shënon fundin e BRSS-së.
Shpërbërja e Jugosllavisë	-në vitet '80, kriza ekonomike dhe politike shënoi një kulm. -pas vdekjes së Titos dolën në pah probleme të shumta. -kontradikta të forta mes republikave për arsye ekonomike dhe ndikimi në shtetin federal. -Konflikt mes: a) vizionit për një federatë të dobët dhe më shumë kompetenca për republika (Sllovenia, Kroacia); b) vizionit për një shtet federal të centralizuar (Serbia). -shpërbërja e shtetit federal solli konflikte të përgjakshme. -luftëra etnike me shumë humbje njerëzore dhe materiale (Bosnjë, Kroaci, Kosovë) -pavarësia e Kosovës
Pyetje për diskutim Situata quhet e realizuar nëse nxënësit: 1) Përshkruajnë tensionet etnike në ritje në Evropën postkomuniste. 2) Analizojnë shkaqet e procesit të shpërbërjes së BRSS-së. 3) Analizojnë dinamikën e shpërbërjes së Jugosllavisë dhe konfliktet etnike që e shoqëruan këtë proces. 4) Vlerëson përpjekjet e popullsisë shqiptare të Kosovës dhe luftën çlirimtare që çoi në pavarësimin e saj nga Serbia.	
Vlerësimi: <i>Vlerësimi i nxënësit mbështetet në rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</i>	
Detyrat dhe puna e pavarur: • Nxënësve u jepet si detyrë të sqarojnë termin “spastrim etnik” dhe të japin shembuj të përdorimit të këtij instrumenti dhune.	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Bashkimi Evropian			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit • Përdor funksionet gjuhësore të teksteve historike, fjali komplekse për shpjegimin e marrëdhënieve shkak-pasojë. Kompetenca e të nxënit • Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme, i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën. Kompetenca personale • Përdor aftësitë e komunikimit, për të prezantuar idetë e tij.		Situata e të nxënit: - Procesi i integritimit evropian si një projekt shumëplanësh. - Bashkimi Evropian si një aktor i rëndësishëm i politikës botërore. - Elemente të ndërtimit të Bashkimit Evropian dhe roli i tij si model për vendet e afërta më të.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - evidenton hapat e ndjekur për intensifikimin e proceseve të integritimit evropian; - shpjegon organet kryesore dhe mënyrën e funksionimit të Bashkimit Evropian; - analizon shtyllat mbi të cilat mbështetet themelimi dhe veprimtaria e Bashkimit Evropian; - vlerëson rolin e Bashkimit Evropian për vendet evropiane dhe në politikën dhe ekonominë botërore.		Fjalët kyçe: <i>Bashkimi Evropian,</i> <i>Akti Unik Evropian,</i> <i>Traktati i Maastrichtit,</i> <i>Euro</i>	

Burimet:

- Libri i nxënësit, interneti.

Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:

- Gjeografi: Njohja e dinamikës së shtrirjes së Bashkimit Evropian në vite.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Metodologjia:

Parashikim me terma paraprakë/pyetje përgjigje

Organizimi i orës së mësimit:

- Mësuesi/ja shkruan në tabelë:

Bashkimi Evropian (BE)


Legjislacioni i BE

euro

Zgjerimi i BE-së
- Mësuesi/ja kërkon nga nxënësit të thonë se ç'dinë për këto fjalë dhe pasi nxit një diskutim të shkurtër, udhëzon nxënësit të lexojnë mësimin.

Ndërtimi i njohurive:

- Duke u bazuar në termat kryesorë të mësimit, mësuesi/ja e ndërton orën e mësimit në formën e pyetje-përgjigjeve dhe shënimeve të skicuara në tabelë si më poshtë.
- Mësuesi/ja bën pyetjen: A mund të tregoni si është zhvilluar procesi i krijimit dhe zgjerimit të Bashkimit Evropian?




Mësuesi/ja sqaron si funksionon Bashkimi Evropian. - Mësuesi/ja drejton pyetjet: 1 - Cilat janë organet legjislative të Bashkimit Evropian? • Parlamenti Evropian • Këshilli i Bashkimit Evropian 2 - Cilat janë organet ekzekutive të Bashkimit Evropian? • Këshilli Evropian • Komisioni Evropian • Komisionerët 3 - Cilat janë organet që përbëjnë pushtetin gjyqësor të Bashkimit Evropian? • Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian 4 - Cili është funksioni i Bankës Qendrore Evropiane? 5 – Shpjegoni procesin e zgjerimit të Bashkimit Evropian. Pyetje për diskutim Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja: 1) Përshkruan hapat e procesit të integritetit evropian. 2) Analizon shtyllat kryesore mbi të cilat mbështetet funksionimi i Bashkimit Evropian. 3) Shpjegon rolin dhe vendin që zë Bashkimi Evropian në skenën politike dhe ekonomike botërore. Vlerësimi: <i>Vlerësimi i nxënësit mbështetet në rezultatet e të nxënëtit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.</i> Detyrat dhe puna e pavarur: • Nxënëseve u jepet detyrë rubrika e librit “Mendo si historian” .
--

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Shoqëria dhe mjedisi	Lënda: Histori	Shkolla:	Klasa: 10
Tema mësimore: Prirjet e reja të zhvillimit		Situata e të nxënit: a) Zhvillimet dhe ndryshimet e mëdha të ndodhura në shek. XX në ekonomi dhe shoqëri. b) Ecuria e zhvillimit të teknologjisë dhe shkencës në botën moderne. c) Tendencat e artit dhe të kulturës.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin - Diskutojnë në grup për rëndësinë që ka e shkuara në kuptimin e të tashmes dhe perspektivat në të ardhmen. Kompetenca qytetare - Shqyrtojnë në mënyrë kritike sjelljet, motivet dhe veprimet e njerëzve në të shkuarën që mund të jenë rezultat i ndryshimit në shoqëri dhe standardeve të ndryshme. Kompetenca digjitale - Komunikojnë, prezantojnë dhe parashtron njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet.		Fjalët kyçe: <i>emancipim,</i> <i>globalizim,</i> <i>ndotje e mjedisit,</i> <i>kozmos,</i> <i>ekzistencializëm,</i> <i>lëvizje studentore</i>	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - identifikojnë disa prej ndryshimeve kryesore në fushën ekonomike dhe shoqërore pas vitit 1945; - shpjegojnë procesin e globalizimit dhe analizojnë aspektet pozitive dhe negative të këtij procesi; - vlerësojnë ndikimin e ndryshimeve teknologjike mbi jetën e përditshme të njerëzve. - identifikojnë disa prej tendencave më kryesore në fushën e artit dhe kulturës.			

Burimet: • Libri i nxënësit, interneti.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: • Me letërsinë: veprat letrare që trajtojnë tematikat në fjalë. • Historia e artit: analiza e tendencave artistike të pasluftës II Botërore. • TIK: njohuri lidhur me teknologjinë e informacionit.
	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
Metodologjia: Punë kërkimore në grup Organizimi i orës së mësimit: në grup - Mësuesi/ja ka udhëzuar që më parë nxënësit të hulumtojnë dhe grumbullojnë fakte, informacion rreth zhvillimeve teknologjike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore (materiali mund të prezantohet në <i>Powerpoint</i> nga nxënësit). Ndërtimi i njohurive: • Pasi nxënësit lexojnë në grupe sipas çështjeve të mësimit, mësuesi /ja diskuton me ta konceptet kryesore dhe shkruan në tabelë një përmbledhje të mësimit p.sh.: - Rritje e fortë ekonomike; - Zhvillim i vullshëm teknologjik; - Përmirësim i statusit shoqëror të masave punonjëse - o Sigurime shoqërore, - o Shkurtim i kohës së punës, - o Përmirësim i të ardhurave. - Procesi i emancipimit të gruas mori një hov të konsiderueshëm (në planin politik dhe ekonomik). - Procesi i globalizimit	



Pyetje për diskutim

Situata quhet e realizuar nëse nxënësi/ja:

- 1) Identifikon disa nga arritjet në fushën ekonomike dhe shoqërore pas vitit 1945.
- 2) Analizon lëvizjet për emancipimin e gruas, duke vënë në dukje disa prej arritjeve në këtë proces.
- 3) Evidenton tendencat e reja në fushën e artit dhe kulturës.

Vlerësimi:

Vlerësimi i nxënësit mbështetet në rezultatet e të nxënëtit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Analizë e fenomenit të globalizimit, duke vlerësuar opinionin në favor dhe kundër këtij procesi.

